

NJERËZIT DHE PUNA NË SHQIPËRI

Krahu i punës, Punësimi dhe
Papunësia



Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi i tij në cilëndo formë, pa autorizimin paraprak me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit.

Copyright © INSTAT 2004



Instituti i Statistikës
Rr. Lek Dukagjini, Nr.5, Tiranë
Tel: +355 4 222411/230484
Fax: +355 4 228300
E-mail: botim_difuzion@instat.gov.al
www.instat.gov.al

ISBN 99927-973-6-3

Nxjerrja e kësaj serie studimesh me karakter social përbën një moment i rëndësishëm në jetën profesionale të INSTAT.

Informacioni i mbledhur gjatë Regjistrimit të Popullsisë dhe Banesave 2001 si dhe të dhënat e Anketës së Matjes së Nivelit të Jetesës 2002, u përdorën si burime kryesore të dhënash për të analizuar fenomene të tilla si migracioni i dekadës së fundit, lëvizja e brendshme e popullsisë, gjendja e tregut të punës, impakti që kanë keto çështje në jetën e grave dhe burrave, në problemet e pabarazisë dhe të situatës së nivelit të jetesës, si dhe u përdor në projeksionet e popullsisë për periudhën 2001-2021.

Këto studime kanë rëndësi të veçantë për hartuesit e politikave dhe për hulumtues të disiplinave të ndryshme. Ato mund të përdoren për të kuptuar se si duhet të punohet për zbutjen e pabarazisë, si mund të investohet në infrastrukturën e shërbimeve, se si mund të ndihmohen autoritetet lokale për të hartuar politika të veçanta për grupet në nevojë.

Studimet gjithashtu hedhin dritë edhe në situatën e objektivave të mileniumit në Shqipëri dhe japin më shumë elemente për monitorimin e tyre të vazhdueshëm.

Këto studime janë fryt i bashkëpunimit disamujor të ekspertëve ndërkombëtarë dhe ekspertëve lokale. Gjithashtu ato janë edhe dëshmi e një rrjeti lokal studiuesish që fillon të bashkëpunojë me INSTAT, në analizimin e fenomeneve sociale.

INSTAT përfiton nga ky rast për të falenderuar Programin e Shpërndarjes së Shërbimeve Sociale financiar nga Banka Botërore dhe Qeveria Shqiptare. INSTAT gjithashtu falenderon Institutin e Kërkimeve të Popullsisë dhe Politikave Sociale të Komisionit Kombëtar të Kërkimeve Itali dhe Qëndres Ndërkombëtare për Statistikat, Romë.

Milva Ekonomi

Drejtor i Përgjithshëm



1	HYRJE	11
<hr/>		
2	BURIMET E TË DHËNAVE DHE PËRKUFIZIMEVE	15
<hr/>		
1	Rekomandime ndërkombëtare në statistikat e punës	15
2	Burimet e afërta të të dhënave të krahut të punës në Shqipëri	16
3	Mbulimi, përkufizime dhe ndryshimet metodologjike mes burimeve	17
3.1	Mbulimi	17
3.2	Kufizimet moshore	17
3.3	Metodat në matjen e aktivitetit ekonomik	18
4	Punësimi dhe papunësia e përcaktuar në regjistrimet e popullsisë së viteve 1989 dhe 2001 dhe Vëzhgimin e Matjes së Standartit të Jetesës për vitin 2002(VMSJ)	18
	Aneksi 1. – Fokusimi i Regjistrimit të popullsisë së vitit 2001 dhe VMSJ për vitin 2002 : çështjet kryesore të krahut të punës	20
	Aneksi 1.1 – Konceptet e ILO-s dhe përkufizime në lidhje me tregun e punës	21
	Aneksi 1.2 – Citime nga Kodi i Kodit Shqiptar të Punës	24
3	PAMJE E PËRGJITHSHME DHE NDRYSHIMET RAJONALE	27
<hr/>		
1	Hyrje	27
2	Popullsia në moshë pune dhe vartësia demografike	28
3	Pjesmarrja e krahut të punës	31
4	Punësimi dhe papunësia : vartësia ekonomike	32
4.1	Punësimi dhe papunësia që prej regjistrimeve të popullsisë së 1989 dhe 2001	32
4.2	Punësimi dhe papunësia që prej regjistrimit të popullsisë të VMSJ të 2002	35
5	Komponentët e papunësisë dhe sjellja	36
6	Popullsia jo aktive e rritur	38
7	Punësimi sipas dëgës së aktivitetit ekonomik	38
8	Punësimi sipas statusit	42
9	Punësimi sipas kushteve të punës	43
9.1	Lloji i kontratës së punës	43
9.2	Lloji i vendit të punës	43
9.3	Orët e zakonshme të punës	44
10	Punësimi sekondar	46
11	Konkluzione	47
	Aneksi 3.1 – Krahu i punës, Punësimi dhe papunësimi në zonat shqiptare	49
	Gjetjet kryesore	55

4.	FAKTORËT DEMOGRAFIKË DHE SOCIAL – EKONOMIKË TË PJESMARRJES SË KRAHUT TË PUNËS, PUNËSIMI DHE PAPUNËSIA	57
1.	Hyrje	57
2.	Puna dhe jo – puna në dy perspektiva në ndryshme	57
2.1	Perspektiva ndër-sektoriale	58
2.2	Perspektiva e cilklit të jetës	60
3.	Tiparet individuale demografike	62
3.1	Statusi civil	63
3.2	Lidhjet me kreun e familjes	65
3.3	Numri i fëmijëve	67
4.	Tiparet individuale social – ekonomike	67
4.1	Arsimimi	68
4.2	Eksperiencia migratore	72
5.	Tiparet e banesave	74
6.	Konkluzioneve	82
	Aneksi 4.1 – Veçantia e vlerave në grup moshën specifike	84
	Gjetjet kryesore	87
5	KOMENTE PËRMBYLLËSE DHE POLITIKAT SUGJERUESE	89
1.	Hyrje	89
2.	Popullsia e re kundrejt punëtorëve më të rritur	89
3.	Kapital njerëzor i humbur dhe i përkeqësuar	91
4.	Një strukturë produktive që duhet të modernizohet	92
5.	Frika dhe hspresa për të ardhmen	93
	Përkufizime	95
	Bibliografi	97



LISTA E TABELAVE

Tabela 3.1:	Popullsia në moshë pune sipas gjinës dhe përkufizimit : Shqipëria, 1989 dhe 2001	29
Tabela 3.2:	Popullsia në moshë pune (15-64 vjeç_ sipas gjinisë dhe rezidencës : 1989 dhe 2001(përqindjet e nxjerra nga totali i popullsisë)	29
Tabela 3.3:	Raporti i vartësisë demografike sipas rezidencës dhe komponentët : 1989 dhe 2001	30
Tabela 3.4:	Struktura e moshës së popullsisë në moshë pune sipas gjinisë dhe rezidencës :1989 dhe 2001	31
Tabela 3.5:	Popullsia mbi 15 vjeç dhe statusi i punës : Shqipëria, 1989 dhe 2001	32
Tabela 3.6:	Shifrat e pjesmarrjes së krahut të punës dhe shifra bruto e punësimit sipas gjinisë dhe rezidencës” 1989 dhe 2001	33
Tabela 3.7:	Raporti i vartësisë ekonomike dhe raporti i punësimit periferik/qendror siaps rezidencës”1989 dhe 2001	33
Tabela 3.8:	Shifra e papunësisë sipas gjinisë dhe rezidencës:1989 dhe 2001 (% e popullsisë në kërkim të punës/popullsia aktive)	34
Tabela 3.9:	Popullsia sipas gjinisë dhe kushteve: Shqipëria 2001	35
Tabela 3.10:	Papunësia sipas gjinisë, rezidencës dhe satusit: Shqipëria 2001	37
Tabela 3.11:	Popullsia adulte inaktive sipas gjinisë dhe kushteve: Shqipëria 2001	38
Tabela 3.12:	Të punësuarit sipas gjinisë, rezidencës dhe sektorit ekonomik të aktivitetit:2001	41
Tabela 3.13:	Të punësuarit sipas gjinisë, rezidencës dhe sektorit kryesor ekonomik të aktivitetit:2001	41
Tabela 3.14:	Të punësuarit sipas gjinisë, rezidencës dhe statusit:2001 (%sipas statusit në punësim)	42
Tabela 3.15:	Të punësuarit sipas gjinisë, rezidencës dhe llojit të kontratës së punës:2001 (%sipas kontratës së punës)	43
Tabela 3.16:	Të punësuarit sipas gjinisë, rezidencës dhe llojit të vendit të punës:2001 (% sipas vendit të punës)	44
Tabela 3.17:	Të punësuarit sipas gjinisë, rezidencës orëve të zakonshme të punës:2001 (% sipas orëve të punës)	45
Tabela 4.1:	Popullsia në moshë pune sipas madhësisë së banesave: Shqipëria, 2001	78
Tabela 4.2:	Pjesmarrja e krahut të punës, shifrat e punësimit dhe papunësimit bruto sipas madhësisë së familjeve: Shqipëria, 2001	79
Tabela 4.3:	Familjet sipas numrit dhe kushteve të punës: Shqipëria, 2001	81
Tabela 4A.1:	Ndryshimet e një grup moshe në shifra specifike nga 18 në 22 vjeç, sipas gjinisë dhe kushteve: Shqipëria, 2001 (ndryshimet në% dalin nga numri i popullsisë sipas gjinisë)	84
Tabela 4A.2:	Disa karakteristika kryesore të popullsisë së re të punësuar sipas gjinisë dhe kushteve: Shqipëria, 2001 (% nga numri i popullsisë përkatëse të punësuar)	85
Tabela 4A.3:	Ndryshimet e shifrave të një grup moshe nga 18 në 22 vjeç, sipas gjiniës dhe kushteve:Shqipëria, 2001(ndryshimet në % dalë nga numri i popullsisë përkatëse sipas gjinisë)	85

Tabela 4A.4: Disa karakteristika të femrave të punësuar nga 40-49 vjeç, sipas grup moshës: Shqipëria, 2001 (% e dalë nga numri përkatës i femrave të punësuar)	86
Tabela 5.1: Moshë mesatare e popullsisë adulte sipas kushteve të punës: Shqipëria, 2001	90
Tabela 5.2: Diplomat universitare dhe ato të arsimit të mesëm sipas gjinisë, rezidencës dhe grup moshave: Shqipëria, 2001 (% e dalë nga numri i popullsisë përkatëse)	91
Tabela 5.3: Popullsia e punësuar sipas gjinisë, grup moshës dhe sektorit të aktivitetit: Shqipëria, 2001 (% e popullsisë sipas gjinisë dhe grup moshës)	92
Figura 3.1: Shkurajimi i shifrave të papunësisë sipas gjinisë dhe grup moshës: Shqipëria, 2002 (% e personave të papunë të shkurajuar, shifër e dalë nga krahi u punës- përkufizim i qetë)	36
Figura 3.2: Të papunët sipas rezidencës dhe mënyrës sesi kërkojnë punë:2002	37
Figura 3.3: Të punësuarit sipas gjinisë, sektorit ekonomik të aktivitetit dhe statusit të punës: Shqipëria 2001	42
Figura 3.4: Të punësuarit sipas gjinisë, sektorit ekonomik të aktivitetit dhe llojit të kontratës së punës: Shqipëria 2001	44
Figura 3.5: Të punësuarit sipas gjinisë, sektorit ekonomik të aktivitetit dhe llojit të vendit të punës: Shqipëria 2001	45
Figura 3.6: Të punësuarit sipas gjinisë, sektorit ekonomik të aktivitetit dhe orëve të zakonshme të punës: Shqipëria 2001	46
Figura 3.7: Të punësuarit me një punë të dytë sipas degës së aktivitetit ekonomik të aktivitetit në këtë punë: Shqipëria 2002	47
Figura 3A.1: Struktura e brendshme dhe të ardhurat e popullsisë në moshë pune, sipas rretheve : 1989 dhe 2001	49
Figura 3A.2: Shifra e pjesmarrjes së krahut të punës sipas gjinisë dhe rrethit: 1989 dhe 2001	50
Figura 3A.3: Shifra bruto e punësimit sipas gjinisë dhe rrethit: 1989 dhe 2001	51
Figura 3A.4: Shifra e papunësisë sipas gjinisë dhe rrethit: 1989 dhe 2001	52
Figura 3A.5: Shifra e papunësisë sipas gjinisë, rrethit dhe përbërjes: 2001	52
Figura 3A.6: Të punësuarit sipas gjinisë, rrethit dhe llojit të punës: 2001	53
Figura 3A.7: Të punësuarit sipas gjinisë, rrethit dhe tipit të vendit të punës:2001	54
Figura 3A.8: Të punësuarit sipas gjinisë, rrethit dhe orëve të punës: 2001	55
Figura 4.1: Pjesmarrja e krahut të punës së një grup moshe specifike dhe shifra e punësimit sipas gjinisë: Shqipëria, 2001 (% e dalë nga numri i popullsisë përkatëse)	58
Figura 4.2: Shkalla e punësimit sipas rezidencës, gjinisë dhe grup moshës: 1989 dhe 2001 (% e dalë nga numri i popullsisë përkatëse)	60
Figura 4.3: Shkalla e papunësisë sipas gjinisë, rezidencës dhe grup moshës: 1989 dhe 2001 (% e dalë nga numri i popullsisë përkatëse aktive)	61
Figura 4.4: Vitet imagjinare të moshës së punës (15 – 54 vjeç) sipas gjinisë dhe statusit ekonomik: Shqipëria, 2001	62



Figura 4.5: Shkalla e punësimit sipas gjinisë, gjendjes civile dhe grup moshës: Shqipëria, 2001 (% e dalën nga popullsia përkatëse)	63
Figura 4.6: Shkalla e papunësisë sipas gjinisë, gjendjes civile dhe grup moshës: Shqipëria, 2001 (% e dalë nga popullsia përkatëse)	64
Figura 4.7: Shkalla e punësimit sipas gjinisë, lidhjes me personin e referencës dhe grup moshën: Shqipëria, 2001 (% e dalë nga popullsia përkatëse)	65
Figura 4.8: Shkalla e papunësisë sipas gjinisë, lidhjes me personin e referencës dhe grup moshën: Shqipëria, 2001 (% e dala nga popullsia përkatëse aktive)	66
Figura 4.9: Shkalla e pjesmarrjes së një grup moshe si krah pune dhe shkalla e punësimit bruto të femrave sipas numrit të fëmijëve që kanë: Shqipëria, 2001 (% e dalë nga popullsia përkatëse)	66
Figura 4.10: Shkalla e punësimit sipas gjinisë, nivelit arsimor dhe grup moshës: Shqipëria, 2001 (% e dala nga popullsia përkatëse)	68
Figura 4.11: Shkalla e papunësisë sipas gjinisë, nivelit arsimor dhe grup moshës: Shqipëria, 2001 (% e dala nga popullsia përkatëse)	69
Figura 4.12: Të papunët sipas gjinisë, nivelit arsimor dhe komponentit: Shqipëria, 2001 (% e dala nga popullsia përkatëse)	70
Figura 4.13: Popullsia jo aktive adulte siaps gjinisë dhe nivelit arsimor: Shqipëria, 2001 (% e dala nga popullsia përkatëse)	70
Figura 4.14: Të punësuarit sipas gjinisë, nivelit arsimor dhe llojit të punës: Shqipëria, 2001 (pjesa në %)	71
Figura 4.15: Të punësuarit sipas gjinisë, nivelit arsimor dhe statusit të punës: Shqipëria, 2001 (pjesa në %)	72
Figura 4.16: Të punësuarit sipas gjinisë, nivelit arsimor dhe orëve të punës (a): Shqipëria, 2001 (pjesa në %)	73
Figura 4.17: Të punësuarit sipas gjinisë, nivelit arsimor dhe industrisë: Shqipëria, 2001 (pjesa në %)	74
Figura 4.18: Të punësuarit sipas gjinisë, degës kryesore të industrisë dhe nivelit arsimor: Shqipëria, 2001 (pjesa në %)	75
Figura 4.19: Shkalla e pjesmarrjes së krahut të punës dhe papunësisë sipas gjinisë, grup moshës dhe eksperiencës së migrimit: Shqipëria, 2002	76
Figura 4.20: Shkalla e pjesmarrjes së krahut të punës sipas gjinisë, grup moshës dhe eksperiencës së migrimit: zonat urbane, femrat, 2002	76
Figura 4.21: Të punësuarit sipas gjinisë, degës kryesore të industrisë dhe eksperiencës së migrimit: Shqipëria, 2002 (pjesa në %)	77
Figura 4.22: Popullsia sipas madhësisë së familjes dhe grup moshës: Shqipëria, 2001	77
Figura 4.23: Familjet sipas numrit të anëtarëve në moshë punës (15-64 vjeç): Shqipëria, 2001	78
Figura 4.24: Familjet sipas numrit të anëtarëve në punë : Shqipëria, 2001	79
Figura 4.25: Familjet sipas numrit të anëtarëve të punësuar: Shqipëria, 2001	80
Figura 4.26: Familjet sipas numrit të anëtarëve të papunë: Shqipëria, 2001	80



Hyrje

Që prej 1990, Shqipëria ka përjetuar një revolucion autentik sa i takon regjimit politik, institucioneve administrative dhe marrëdhënieve me vendet e tjera dhe institucionet ndërkombëtare. Ekonomia e saj ka ndryshuar nga një ekonomi e centralizuar dhe e planifikuar në një ekonomi e tregut të lirë që prej disa vitesh. (Hashi, Xhillari 1997) Ndërkohë sistemi i saj prodhues u shkatërrua. Ta quash këtë proces “tranzicion” është si të përdorësh një eufemizëm, kur marrim në konsideratë trazirat e 90’ dhe ndryshimet e mëdha, jo të gjitha pozitive, që pasuan Gerxhani-Schram, 2002).

Një nga aspektet që u përfshinë më shumë në këto lëvizje ishte tregu i punës. Ne as që mund ta përmendim këtë element gjatë regjimit komunist, kur punësimi i plotë bëhej i programuar dhe shteti ishte thujse i vetmi punëdhënës. Kështu, tregu i vërtetë i punës u formua pas ndryshimeve të sistemit politik dhe është edhe rrugës pak nga pak, në vijim të të transformimit të degëve të ndryshme të aktivitetit ekonomik. Në fakt, sistemi shqiptar prodhues ishte i prapambetur edhe krahasuar me atë të sistemeve të tjera socialiste të vendeve të Evropës Lindore dhe Ballkanit. Bujqësia ishte sektori që mbizotëronte dhe

mbahej nga kooperativat. Ndërmarrjet shtetërore drejtoheshin në atë mënyrë që të kënaqnin tregun autarkik të prodhimeve dhe kërkesës së ushtrisë. Megjithë që disa shërbime nuk ishin kushedi se çfarë në cilësi, ato ishin të lidhura me burokracinë shtetërore. Të gjitha u tronditën me ndryshimin e sistemit politik. Kooperativat rurale u prishën dhe toka u shpërnda mes fshatarëve të mëparshëm, secili duke zotëruar kështu nga një fermë të vogël, ferma që shpesh ishin të shpërndara nëpër territorin e vendit. Ndërmarrjet shtetërore thujse u mbyllën të gjitha. Burokracia dhe shërbimet shtetërore u ribalancuan sipas kufizimeve të vendosura.

Pasojat tek krahu i punës dhe mënyra e jetesës së popullsisë ishin jashtëzakonisht serioze. Mungesa e vendeve të punës dhe të ardhurat e pakta që mblidheshin nga fermat çuan në migrimin masiv jashtë vendit, teksa ndodhte edhe procesi i urbanizimit të brendshëm, me shpresën e gjetjes së më shumë shanseve të punësimit në qytete sesa në pjesën tjetër të vendit.

Me këto ndryshime të rëndësishme, kapaciteti i ekonomisë shqiptare në thithjen e krahut potencial të punës duhet të monitorohet rregullisht dhe në vijimësi duhen ndjekur politika punësimi që kanë për qëllim

manaxhimin e duhur dhe përdorimin efikas të krahut të saj të punës.

Niveli i papunësisë përdoret gjerësisht si treguesi i përgjithshëm për të vlerësuar performancën e ekonomisë së një vendi. Problemi i papunësisë është një çështje globale që çdo komb pëpiqet ta kontrollojë, e ta mbajë në nivele minimale. Megjithatë, në vende në tranzicion ai po përkeqësohet për shkak të ndryshimeve të thella në sistemin e tyre prodhues dhe të mirëqenies. (Faggio dhe Konings 2000) ndërsa urbanizimi përkeqëson problemin, sepse migrimi i njerëzve në zonat urbane pa asnjë perspektivë punësimi, duke u bërë pre e punësimit të zhvlerësuar, apo jo aktivë për punë prodhuese.

Analizat e statusit të punës dhe papunësisë është kryesore për të trajtuar vështirësitë aktuale dhe parashikuar ndryshimet e ardhshme. Për të parën, trajtimi i familjeve është i rëndësishëm për të nxjerrë kushtet e familjeve sa i takon atyre që fitojnë bukën dhe praninë së anëtarëve të saj të papunë. Lidhja me variablat e zakonshëm demografikë (gjinia, grup moshat, gjendja civile etj), me nivelin arsimor të arritur, etj, mund të shërbejë për sugjerimni e politikave përkatëse.

Ky studim bazohet kryesisht mbi rezultatet e Regjistrimit të Popullsisë dhe Banesave të vitit 2001, i cili ia kushtonte më shumë se gjysmën e pyetësorit të tij kushteve të punës së njerëzve nga 15 vjeç e lart, si edhe aspekteve të ndryshme të aktivitetit të tyre ekonomik.

Duhet ta kuptojmë se regjistrimi i popullsisë nuk është bërë për të studiuar plotësisht tregun e punës, sepse ai vetëm jep një fotografim të realitetit që ndryshon shumë shpejt sa i takon tregut të punës dhe kërkesës. Për më tepër, shumë njerëz tentojnë t'i përgjigjen pyetjeve të formularit mbi statusin ekonomik normal, në vend të atij që mbajnë aktualisht. Së fundi, përgjigjet e pyetësorëve të përgjithshëm, si ato mbi regjistrimin e

popullsisë, janë shpesh të pabesueshme sa i takon statusit social ekonomik, veçanërisht gjendjes së papunësisë së tyre të vetë deklaruar.

Megjithatë në vende më pak të zhvilluara dhe në vende në tranzicion si Shqipëria, rrallë ka burime të dhënash statistikore të plota e të besueshme mbi tregun e punës. Shumë njerëz, gjithashtu duke qenë më vete, kontributorë në familje, punëtorë në bujqësi, punojnë kështu jashtë tregut real të punës dhe aktiviteti i punës në bujqësi arrihet më lehtë nga statusi normal se nga ai aktual. Së fundi, papunësia dhe puna e paguar pak kapërcejnë aktivitetet tradicionale, veçanërisht në bujqësi, artizanat, shitjet me pakicë, si dhe shërbimet okazionale të nivelit të ulët.

Kështu, ishim të detyruar të mbështeteshim në të dhënat e regjistrimit të vitit 2001 për të studiuar fuqinë punëtore, punësimin dhe papunësinë në atë kohë. Ne do të përdorim gjithashtu edhe të dhënat e regjistrimit të vitit 1989 – regjistrimi i fundit i popullsisë së regjimit të kaluar – për të bërë krahasime dhe për të nxjerrë tendencat. Megjithatë, krahasimet dhe tendencat do të bëhen me kujdes për shkak të ndryshimeve trndësishme në modelin ekonomik dhe politik të shfaqur që prej 12 vjetëve që atëherë. Kurdo që të jetë e nevojshme për studim më në thellësi të termave specifike që nuk mbulohen nga regjistrimi, ne do të përdorim gjithashtu rezultatet e Vëzhgimit të Matjes së Standartit të Jetesës, një vrojtim statistikor përfaqësues kombëtar, të kryer në vitin 2002 nga INSTAT sipas Bankës Botërore.

Objektivat specifikë të këtij studimi janë:

- i) të përshkruajë gjendjen e fuqisë punëtore, punësimin dhe papunësinë në vend, në rrethe, zonat urbane e rurale dhe Tiranë;
- ii) Të përshkruajë tendencat dhe ndryshimet e ndodhura në vijim të ndryshimit ekonomik e politik;

iii) Të studiojë faktorët demografikë e social ekonomikë, që ndikojnë në pjesmarrjen e popullsisë në fuqinë puntore, si edhe ata që kontribuojnë në nivelin e lartë të papunësisë;

iv) Të nxjerrë konkluzione nga eksperiencia e kaluar dhe aktuale për të bërë rekomandime mbi programe që nxisin krijimin e vendeve të punës në vend;

Struktura e raportit ndjek këtë linjë. Ne së pari diskutojmë të dhënat dhe përkufizimet në Kapitullin II. Tendencat e popullsisë në moshë pune, fuqia punëtore dhe punësimi në Shqipëri analizohen në kapitullin III përmend të dhënave të regjistrimeve të viteve 1989 dhe 2001. Situata analizohet gjithashtu edhe në aspektet e saj shumë dimensionalë duke i shtuar studimet e thella nga VMSJ për 2002 dhe regjistrimi i vitit 2001. Në kapitullin IV përpqemi të idnetifikojmë faktorët demografikë social ekonomië që ndikojnë pjesmarrjen në punësim dhe papunësinë me referencë kryesore të dhënat e regjistrimit të vitit 2001. Kapitulli përmbyllës V, merr në shqyrtim dhe diskuton pasojat kryesore të gjetjeve tona dhe përpqet të japë disa sugjerime për rekomandimet e politikave.



2

**Burimet e të dhënave
dhe përkufizime**

Qëllimi i këtij kapitulli është t'i sigurojë lexuesit mjetet e nevojshme për të shqyrtuar çështjet lidhur me trajtimin statistikor të fuqisë puntore, punësimit dhe papunësisë.

Për shkak të pyetjeve të ngritura, diskutimi do të prekë aspekte të ndryshme problematike. Këtu do të trajtohen probleme praktike, lidhur me burimet e mundshme të të dhënave mbi fuqinë puntore. Përkufizimet e ndryshme të përdorura në të dhënat e fundit shqiptare do të krahasohen me njëra – tjetrën me rekomandimet ndërkombëtare mbi këtë çështje. Problemet që gjithashtu kanë lidhje me metodat e vëzhgimit dhe pyetësorët e përdorur do të diskutohen në lidhje me statusin e punës dhe individëve. Në fakt, megjithë që kryesisht i fokusuar në të dhënat e regjistrimit të 2001, analiza jonë do të përdorë gjithashtu të dhëna nga regjistrimi i vitit 1989 dhe Vëzhgimi i Matjeve të Standartit të Jetesës së vitit 2002, si edhe informacione nga burime të tjera statistikore dhe administrative.

1. Rekomandimet ndërkombëtare mbi statistikat e punës

Konferenca ndërkombëtare e Stacionëve të Punës, që mbahet në mënyrë periodike, është forumi mbarë botëror që vendos koncepte dhe jep rekomandime mbi çështjet kryesore të statistikave të punës që shërbejnë si standarte ndërkombëtare. Këto standarte ndërkombëtare janë baza që ofron rregullat në zhvillimin e metodologjive në hartimin, mbledhjen, tabulimin, analizimin dhe shpërndarjen e statistikave mbi fuqinë puntore.

Tashmë është çështje e njohur se konceptet dhe përkufizimet e çështjeve mbi statistikat e fuqisë punëtore, janë të vështira për t'u kuptuar dhe interpretuar nga intervistuesit dhe atyre që i përgjigjen gjatë procesit të regjistrimit si edhe nga vëzhgimet e fuqisë puntore. Për shembull, të klasifikosh një person në aktivitete prodhuese apo jo prodhuese, në vartësi të aktivitetit të kryer gjatë periudhës së referencës, është një detyrë e vështirë për intervistuesin. Kjo kërkon një kuptim të thellë të koncepteve të aktivitetit ekonomik, si edhe të trajtimit të aktiviteteve mesatare të individëve, që është shumë më i komplikuar vende me ekonomi kryesisht mbijetese si Shqipëria.



Sipas standarteve ndërkombëtare, kërkohet klasifikimi i aktiviteteve qartësisht në aktivitete ekonomike dhe jo ekonomike. Aktivitetet ekonomike ndahen më tej në prodhim tregu dhe jo i tillë. Në vitin 1990, Zyra e Ndërkombëtare e Punës përcaktoi konceptin e kufizimit të aktivitetit ekonomik në termat e prodhimit të mallrave dhe shërbimeve si ato të vendosura nga Sistemi i Llogarive Kombëtare të Kombeve të Bashkuara. Siç edhe bëhet e qartë edhe në manual « kuptimi i mirë i konceptit të kufirit të aktivitetit ekonomik, është themelor për zbatimin korrekt të përkufizimeve të punësimit, papunësisë dhe popullsisë ekonomike aktive gjatë vëzhgimeve të familjeve apo individëve » (ILO 1990 :4). Ai citon më tej se « kufiri i saktë mes aktiviteteve ekonomike dhe jo – ekonomike, është çështje marrëveshjeje, por për sa kohë që nuk është vënë një vijë ndarëse e qartë, trajtimi korrekt statistikor i shumë situatave të hasura në praktikë nuk mund të përcaktohen dhe, si pasojë, statistikat që vijojnë ka shumë mundësi të bëhen objekt kundërshtimesh dhe gabimeve më të mëdha në përgjigje ». (ILO, 1990 :14)

Vlerësimi sesi përdorshin konceptet dhe metodat e punësimit ose papunësisë në proceset e mbledhjes së të dhënave gjatë regjistrimeve të popullsisë apo vëzhgimeve, varet shumë nga zbatimi i duhur i përkufizimeve dhe koncepteve të aktivitetit ekonomik, siç u tregua më lart. Klasifikimi i personave në kategori të punësuarish apo të papunë, kërkon së pari të kuptojmë nëse ai/ ajo ishin përfshirë në aktivitete prodhuese apo jo gjatë periudhës së referencës. Megjithatë, kur shikojmë të gjitha kategoritë e ofruara nga standartet ndërkombëtare mbi prodhimin e të mallrave dhe shërbimeve të specifikuara në Sistemin Kombëtar të Llogarive, kuptojmë se do të ishte më e lehtë t'i ndiqnim ato në një ekonomi të zhvilluar, ku tregu i punës është shumë i organizuar, ndërsa është e vështirë të plotësojmë gjithë kërkesat e procesit të

mbledhjes së të dhënave në vende në tranzicion si Shqipëria. Kështu, cilësia e statistikave mbi punësimin dhe papunësinë, të mbledhura nga regjistrimet e popullsisë dhe vëzhgimet e familjeve, varet shumë nga dallimi preciz i aktiviteteve ekonomike apo jo – ekonomike.

Në përgjithësi, regjistrimet e popullsisë dhe vëzhgimet e familjeve të kryera në Shqipëri u bënë të tilla për të qenë në përputhje me rekomandimet e standarteve ndërkombëtare në lidhje me burimet përkatëse (UN-ECE, 1998). Megjithatë, siç edhe e diskutuam më lart, gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave, problemet e matjes së treguesve që janë të përbashkëta në vend me treg pune të paorganizuar dhe ekonomi mbizotëruese bujqësore u shfaqën plotësisht.

2. Burimet aktuale të të dhënave të fuqisë puntore në Shqipëri

Sipas manualit të 1990 të ILO-s, burimet e statistikave mbi popullsinë ekonomike aktive apo komponentët e saj grupohen në tre kategori kryesore: 1. regjistrimet e popullsisë dhe studim e mbi familjet; 2. regjistrimet dhe studimet pilo të vendosjeve ; 3. tipe të ndryshme të arkivave administrative, si regjistrat e punësimit, arkivat e sigurimit për papunësinë, skedarët e sigurimit social, pagat e sektorit publik dhe listat e personelit. » (ILO, 1990 :4)

Për sa i takon të dhënave të fuqisë punëtore nga regjistrimet e popullsisë në Shqipëri, ekzistojnë dy regjistrime të popullsisë të kryera në vitet 1989 dhe 2001, që dhanë të dhëna statistikore mbi fuqinë puntore.

Vrojtimet Statistike , si Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve, që kryhet çdo vit që prej 1997, japin informacion vetëm mbi punësimin dhe një numër aktiviteteve ekonomike.

Burime të tjera të dhënash statistikore mbi fuqinë punëtore janë regjistrat administrativë prej të cilëve ka një numër serie kohore. Të dhënat përkatëse publikohen çdo vit nga broshura Tregu i Punës së INSTAT.

Në Shqipëri, të dhënat mbi fuqinë puntore bazuar në studimet mbi familjet u përfatuan për herë të parë nga studimi i vitit 1993-1994 mbi kushtet e jetesës për qytetin e Tiranës. Një studim përfaqësues, shumëplanësh kombëtar u krye për herë të parë në 1998, që dha rezultate edhe mbi popullsinë ekonomikisht aktive (INSTAT 2001). Në vitin 2002, u krye vala e parë e Studimit të Matjes së Standarteve të Jetesës, që ishte gjithashtu një studim përfaqësues kombëtar mbi familjet. Objekti kryesor i tij ishte të mblidhte të dhëna mbi familjet për të matur kështu mirëqenien e familjeve dhe kushtet e jetesës së popullatës duke mbledhur të dhëna mbi konsumin, të ardhurat, kursimet, punësimin, shëndetin, arsimimin, fertilitetin, migrimin familjar etj. Nga ky studim u arritën të dhëna mbi fuqinë puntore në shkallë kombëtare dhe për katër zona kryesore : zona urbane e Tiranës, zona malore, zona qendore dhe ajo bregdetare.

Duke dhënë mundësinë e matjes së punësimit edhe në sektorin informal dhe përcaktimin e disa kategorive si punën e keq paguar apo papunësinë e afatgjatë, studimi i 2002, integron të dhënat e regjistrimit të vitit 2001, i cili nuk i kapi siç duhet këto aspekte. Kështu, Regjistrimi i popullsisë dhe Banesave të vitit 2002 së bashku me Studimin për Matjen e Standartit të Jetesës, japin të dhënat më të mira me aktuale mbi fuqinë puntore në shkallë kombëtare, rajonale dhe nivel më të ulët administrativ, si edhe zonat urbane e rurale.

3. Mbulimi, përkufizime dhe ndryshimet metodologjike ndërmjet burimeve

3.1 Mbulimi

Në vitin 1989 kur është kryer Regjistrimi i popullsisë dhe banesave, vendi ishte i ndarë administrativisht në 26 rrethe. Regjistrimi ishte një proces arkivimi që mbulonte gjithë zonat e vendit.

Struktura administrative e vendit ndryshoi para regjistrimit të popullsisë e banesave të vitit 2001. Që prej 1992, vendi ishte i ndarë administrativisht në 36 rrethe. Si në regjistrimin e vitit 1989, edhe në atë të 2001, procesi ishte listim i gjithë zonave të vendit.

Në krahun tjetër, SMSJ 2002, ishte një studim në shkallë kombëtare që mbulonte gjithë rrethet e vendit dhe të dhënat të perfaqësueshin në katër zona: zona urbane e Tiranës, zona malore, zona qendore dhe ajo bregdetare.

3.2 Kufijtë moshorë

Në mbledhjen e informacionit mbi aktivitetin ekonomik për të prodhuar të dhëna mbi statistikat e punës, është e nevojshme të përcaktojmë moshën minimale të popullsisë që studiohet. Në dy regjistrimet dhe SMSJ së 2002, mosha minimale e popullsisë ekonomikisht aktive dhe komponentëve të saj u vendos në 15 vjeç.

Në Shqipëri, ka një legjislacion kombëtar që e bën arsimin 8-vjeçar të detyrueshëm për t'u ndjekur duke ndaluar kështu pjesmarrjen e fëmijëve në aktivitete prodhuese apo shërbimi. Ekziston një legjislacion në fushën e punës që normalisht përjashton fëmijët nga futja në aktivitete ekonomike nën 16 vjeç.



Asnjë studim në shkallë kombëtare nuk është bërë për punën e fëmijëve para SMSJ 2002, ku ishin përfshirë pyetje për punën edhe tek fëmijët nga 6-14 vjeç. Rezultatet tregojnë se vetëm pak fëmijë në ato moshë janë të përfshirë në punë, kryesisht në zonat rurale, duke punuar në ferma bujqësore teksa ndjekin shkollën.

Kështu, minimumi i kufirit të moshës u vendos duke u bazuar mbi një vlerësim të përgjithshëm të masës ose intensitetit të pjesmarrjes së fëmijëve në aktivitetet ekonomike, si edhe legjislacionit të lartpërmendur.

Në krahun tjetër, në dy regjistrimet e popullsisë dhe SMJS. Nuk u vendos ndonjë kufi maksimal moshe për daljen e individëve nga tregu i punës. Kështu, aktiviteti ekonomik dhe informacioni mbi punësimin do të mbledhej nga gjithë individët e moshës nga 15 vjeç e lart.

3.3 Mënyrat e matjes së aktivitetit ekonomik

Standartet ndërkombëtare identifikojnë dy ndarje të popullsisë "ekonomikisht aktive": popullsia aktive "e zakonshme", e matur në lidhje me një periudhë të gjatë reference si viti, dhe popullsia aktive "aktuale" që matet në lidhje me një periudhë të shkurtër reference si një javë apo një ditë.

Në të dy regjistrimet si dhe në SMSJ së 2002, është përdorur mënyra "aktuale". Ekzistojnë disa ndryshime mes tre burimeve, megjithatë ato do të identifikohen në seksionin e ardhshëm.

4. Punësimi dhe papunësia të përcaktuara nga regjistrimet e viteve 1989 dhe 2001 dhe në Studimin e Matjes së Standartit të jetesës

Në regjistrimin e vitit 1989 nuk ishte caktuar ndonjë periudhë reference as në pyetësor, as edhe në librin e udhëzimeve. Personat nga 15 vjeç e lart u pyetën nëse punonin apo jo. Në atë kohë gjendja ishte e ndryshme duke e krahasuar me atë që është në ditët e sotme ; njerëzit në të shumtën e rasteve kishin një punë të sigurtë/të përhershme.

Mënyra si bëheshin pyetjet në regjistrimin e vitit 2001, ka ngjashmëri me atë të vitit 1989, por ndryshimi është se kishte përkufizime të sakta mbi periudhat e referencës në librin e udhëzimeve, jo në pyetësor: Meqë pyetësorët jepeshin nga intervistues të trajnuar në mënyrë specifike, mund të argumentojmë që në shumicën e rasteve u raportua gjendja për periudhën e referencës.

Në regjistrimin e vitit 2001, popullsia e punësuar, u përcaktua përgjithësisht si e përbër nga persona të angazhuar në aktivitete prodhuese gjatë periudhës së referencës, si edhe persona me punë të rregullt, por që nuk kishin qënë në punë gjatë periudhës së referencës për shkak të shëndetit jo të mirë, lejes vjetore, mbylljes së përkohshme të fabrikës (mungesës së mirëmbajtjes apo mungesës së lëndës së parë), lejes së lindjes etj. Periudha e referencës ishte një javë para datës së regjistrimit. Puntorët familjarë kontribues të papaguar u konsideruan si të punësuar. Studentët dhe pensionistët në të dy regjistrimet u konsideruan si jo në punë edhe nëse kryenin një punë. Klasifikimi u bazua kryesisht mbi deklarin e të regjistruarve, të cilët tregonin statusin e tyre kryesor si edhe të anëtarëve të tjerë të familjes.

SMSJ të 2002 ka të njëjtin përkufizim dhe periudhë reference si regjistrimi i 2001 për të përcaktuar personat e punësuar. Ndryshimi qendron në mënyrën sesi ishën bërë pyetjet : njerëzit pyeteshin në kishin punuar apo jo për një orë ose më shumë javën që i paraprinte datës së intervistës. Kështu, ishte përcaktuar gjithashtu në pyetësor dhe pensionistët ose studentët, nëse kishin punuar gjatë javës së referencës, u konsideruan si të punësuar.

Ushtarët gjatë shërbimit kombëtar nuk u konsideruan në punë as gjatë dy regjistrimeve, as gjatë SMSJ.

Megjithëse përkufizimet janë të njëjta në të tre regjistrimet, zbatimi i metodologjive të ndryshme dhe mënyra e vëzhgimit dë të siguronte më shumë persona në punë gjatë SMSJ sesa në dy regjistrimet e popullsisë.

Sa i takon popullsisë së papunë, krahasimet janë më të vështira.

Përkufizimi « standart » i ILO-s për papunësinë, i përcakton personat e papunë si persona që nuk punojnë gjatë periudhës së referencës dhe që janë duke kërkuar punë në mënyrë aktive, të gatshëm dhe me dëshirën për të filluar punë, nëse ajo do të ishte e mundur. Ka tre mënyra të matjes së popullsisë së papunë, që bazohen në shkallën e relaksimit të kërkimit e punës apo lehtësisë së përdorimit të kriterit të vendosur për matjen e papunësisë ; standart, pjesërisht i pa shqetësuar, i relaksuar.

Në regjistrimet e viteve 1989 dhe 2001, nuk ishte e mundur të inkorporoheshin çështjet që kishin të bënin me matjen e papunësisë gjatë periudhës së referencës dhe asaj që kërkonte punë në mënyrë aktive, nëse ajo ishte e mundur. Nëse nuk punonin, njerëzit pyeteshin nëse ishin të gatshëm dhe dëshironin të fillonin një punë nëse ishte e mundur. Kjo mund të çojë tek konkluzioni që në disa raste përgjigja bazohet mbi deklaratat

e personave dhe jo mbi përpjekjet reale për të gjetur një punë. Mund të thuhet se papunësia mori pak a shumë formën e relaksuar të përkufizimit të papunësisë.

Në matjen e papunësisë, SMSJ së 2002 ndoqi procedurat dhe teknikat alternative të matjes që paraqiten nga standartet ndërkombëtare (ILO 1990). Njerëzit u pyetën nëse ata kanë kërkuar punë katër javë para datës së studimit, çfarë hapash specifike kishin ndërmarrë dhe nëse ishin të gatshëm të fillonin një punë brenda dy javëve nëse ju ofrohej një punë. Sipas kësaj, studimi mund të maste popullsinë e papunë duke përdorur dy opsionet e matjes së papunësisë : atë standarte dhe përkufizimin e relaksuar të papunësisë. Sa i takon relaksimit të përkufizimit standart, disa grupe si “të larguarit”, “puntorët sezonalë”, “puntorët e dekurajuar” – që i atashohen marzhit të fuqisë puntore – mund të konsiderohen si të papunë. Supozimi është plotësisht i arsyeshëm në kontekstin shqiptar kakra karakterizuar nga një numër domëthënës i puntorëve të dekurajuar. Në krahun tjetër, siç edhe është vënë re në ekonominë në zhvillim e tranzicion kur përdoret përkufizimi standart, shifrat veçanërisht të ulta të papunësisë në zonat rurale, reflektojnë nivele të larta të punës së paguar keq në bujqësi. Siç edhe rekomandohet nga ILO, në këto rrethana gjendja e punësimit nuk mund të përshkruhet vetëm nga të dhënat mbi papunësinë, por duhet të plotësohet nga informacioni mbi punën e paguar keq. Gjithashtu, shumë vende nuk e zbatojnë « kriterin e një orëshit » standart, por përdorin një kufi të ndryshëm në vend të tij për të klasifikuar një person si të punësuar.

Së fundi, thellësia e kërkimit gjatë regjistrimeve të popullsisë dhe studimi ishin krejt të ndryshëm. Në SMSJ të vitit 2002 u përfshinë më shumë pyetje depërtuese dhe filtruese, të cilat patën ndikim mbi cilësinë e të dhënave



Aneks 1 Fokusimi mbi të dhënat
e Regjistrimeve të 2001 dhe
Studimit të MSJ 2002 :
Çështjet kryesore të fuqisë
punëtore

Çështjet kryesore të fuqisë punëtore të përfshira në pyetësorin e regjistrimit të 2001 ishin si vijon :

- i) Statusi aktual ekonomik (për të gjithë nga 15 vjeç e lart)
- ii) Numri i orëve të punës gjatë javë së fundit (idem)
- iii) Statusi i punës (vetëm për të punësuarit)
- iv) Dega e industrisë së vendit të punës klasifikuar sipas kodeve të NACE (idem)
- v) Lloji i vendit të punës (idem)
- vi) Profesionin, klasifikuar sipas kodeve ISCO (idem)
- vii) Lloji i punës, e përhershme, e përkohshme, sezonale apo sporadike (idem)
- viii) Numri i orëve të punës zakonisht në një javë (idem)
- ix) Ndoshta një punë e dytë e ndryshme nga ajo kryesore (idem)

Përveç çështjeve të përmendura më lart, studimi i MSJ së 2002 orfoi të dhëna mbi këto çështje të tjera:

- x) Sektorët: publikë/privat jo bujqësor/privat bujqësor
- xi) Punë dytësore
- xii) Nën punësimi në bujqësi
- xiii) Mjetet për gjetjen e një pune
- xiv) Koha për kërkimin e punës
- xv) Papunësi e dekurajuar

Regjistrimi i 2001 dhe Studimi i MSJ 2002 kanë inkorporuar varibala kryesore demografike që tregojnë karakteristika individuale të dobishme për shpjegimin e variablave në analizën e sjelljes së popullsisë në aktivitetet ekonomike. Ndërmjet variablave individualë janë përfshirë ato të gjinisë, moshës, statusit civil dhe arsimit. Për më tepër, çështje që zbulojnë madhësinë e familjes dhe përbërjen, karakteristikat e banesës dhe kushtet, mundësitë dhe shërbimet e familjes, u përfshinë gjithashtu.

Aneksi 1.1

Konceptet dhe përkufizimet e ILO-s në lidhje me Tregun e Punës

Konceptet dhe përkufizimet lidhur me tregun e punës siç raportohet edhe nga ILO – Zyra Ndërkombëtare e Punës, Burime dhe metoda; Statistikat e punës, Volumi 5, Popullsia e përgjithshme dhe ekonomikisht aktive, punësimi dhe papunësia (regjistrimet e popullsisë), botimi i dytë, Gjenevë, 1996, Aneksi, të mundshme pët t'u regjistruar nga adresa e internetit: <http://laborsta.ilo.org/apply8/data/ssm5/e/aneks.html>

Aneksi

Shkëputur nga:

Rezoluta në lidhje me statistikat e popullsisë ekonomikisht aktive, punësimin, papunësinë dhe nën punësimin

Konferenca e 13 Ndërkombëtare e Staticienëve të Punës

(Gjenevë, 18 – 29 Tetor 1982)

Koncepte dhe përkufizime

Popullsia ekonomikisht aktive

5. “Popullsia ekonomikisht aktive” përfshin të gjithë personat çfarëdo gjinie që përbushin kërkesën për punë për prodhimin e mallrave dhe shërbimeve ekonomike përcaktuar nga sistemet e Kombeve të Bashkuara të sistemeve kombëtare të llogarisë dhe balanceve, gjatë një periudhe specifike të referencës. Sipas këtre sistemeve, prodhimi i mallrave ekonomikë dhe shërbimeve përfshin gjithë prodhimin dhe përpunimin të prodhimeve parësore, për treg apo jo, për tregëti apo përdorim vetjak, prodhimin e gjithë mallrave të tjera dhe shërbimeve për tregun dhe, në rastin e familjeve që prodhojnë këto të mira e shërbime për tregun, prodhimin korrespondues për konsum vetjak.

6. Dy matës të dobishëm të të popullsisë aktive ekonomikisht janë “popullsia zakonisht aktive” e matur e lidhur me një periudhë reference të gjatë si një vit, dhe “popullsia aktuale prezente”, ose “fuqia puntore” e matur lidhur me një periudhë reference të shkurtër si një javë apo një ditë.

Popullsia zakonisht aktive

7. (1) “Popullsia zakonisht aktive” përfshin të gjithë personat mbi një moshë specifike statusi kryesor i aktivitetit të të cilëve, siç edhe është vendosur në termat e numrit të javëve apo ditëve gjatë një periudhe të gjatë të specifikuar (12 muajt paraprirës apo një vit kalendarik) ishte “të punësuar” apo “të papunësuar” siç edhe është përcaktuar në paragrafët 9 dhe 10.

(2) Aty ku ky koncept konsiderohet i dobishëm dhe i mundshëm, popullsia tipike aktive mund të nën ndahet si e punësuar dhe e papunë në përputhje me aktivitetin kryesor.

Fuqia puntore (popullsia aktualisht aktive)

8. “Fuqia puntore” apo “popullsia aktualisht aktive” përfshin të gjithë personat që përbushin kërkesat për përfshirje mes të punësuarve dhe të papunëve, përcaktuar në paragrafët 9 e 10.



Punësimi

9. (1) Të punësuarit” përfshijnë të gjithë personat mib një moshë specifike, të cilët gjatë një periudhe të shkurtër të specifikuar, një jaë apo një ditë, ishin në kategoritë e mëposhtme:

(a) “punësim i paguar”

(a1) “në punë”: persona të cilët gjatë periudhës së referencës kryen punë për pagesë, me para në dorë apo në natyrë;

(a2) “me një punë por jo në punë”: persona të cilët punonin në vendin e tyre të punës prej kohësh, por që nuk ishin përkohësisht aty gjatë periudhës së referencës dhe kishin një shtesë në punën e tyre.

Kjo shtesë formale pune duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave kombëtare, sipas një apo më shumë kriterëve të mëposhtme:

i. marrja e vazhueshme e pagës

ii. sigurimi për rikthimin në punë në fund të aksidenti, apo marrëveshje për datën e kthimit

iii. kapërcimi i gjatësisë së mungesës nga puna, kur është rasti, mund të jetë që zgjatja për të cilën puntorët mund të marrin përfitime kompensimi pa obligime për të pranuar punë të tjera

(b) “vetë punësimi”

(b1) “në punë”: personat të cilët gjatë periudhës së referencës kryen ndonjë punë për përfitime apo fitime familjare, në para apo në natyrë

(b2) “në një firmë por jo në punë”: personat në një firmë që mund të jetë një firmë biznesi, fermë apo shërbime, që nuk ishin në punë gjatë periudhës së referencës për ndonjë arsye specifike

(2) Për qëllime operacionale, nocioni “një lloj pune” mund të interpretohet si një punë për të paktën një orë

(3) Persona përkohësisht të pa punë për shkak të sëmundjes apo dëmtimit, pushimit apo lejes, grevës apo përjashtimit, arsimimit, lejes për trajnim, lejs prindërore apo të lindjes, rënies në aktivitetin ekonomik, çorganizim i përkohshëm apo ndalimi i punës për shkak të arsyeve të tilla si koha e keqe, mungesa e energjisë elektrike, mungesa në lendë të para apo gas, apo mungesa të tjera me apo pa leje dueht të konsiderohen si në punë të paguar me faktin që ata kishin një punë formale shtesë.

(4) Të punësuarit për llogari të tyre anëtarë të prodhuesve të kooperativave duhet të konsiderohen si të vetë punësuar dhe klasifikuar si “në punë” ose “jo në punë”, sipas rastit

(5) Puntorët e papaguar të familjes në punë duhet të konsiderohen si të vetë punësuar megjithë numrin e orëve të punës gjatë periudhës së referencës. Vendet të cilat preferojnë për arsye të ndryshme të vendosin një kriter minimal kohor për përfshirjen e puntorëve të papaguar të familjes mes të punësuarve duhen identifikuar dhe klasifikuar më vete ata që punonin më pak se koha e përshkruar.

(6) Personat e përfshirë në prodhimin e mallrave ekonomike dhe shërbimeve për konsum vetjak e familjar duhet të konsiderohen si të vetë punësuar nëse ky prodhim përshkruan një kontribut të rëndësishëm në konsumin e përgjithsëm të familjes.

(7) Ata që merrnin para në dorë apo në natyrë duhet të konsiderohen tek punësimi i paguar dhe klasifikuar si “në punë” ose jo në punë mbi të njëjtat baza si personat e tjerë në punësim të paguar.

(8) Studentët, shtëpiakët dhe të tjerë të përfshirë në aktivitete jo – ekonomike gjatë periudhës së referencës,

që në të njëjtën kohë ishin të përfshirë në vetë punësim apo punësim të paguar siç përshkruhet në paragrafin (1) duhet të konsiderohen si të punësuar mbi të njëjtën bazë si kategoritë e tjera të personave të punësuar dhe të identifikohen më vete, aty ku është e mundur.

(9) Anëtarët e forcave të armatosura duhet të përfshihen mes personave në punësim të paguar. Forcat e armatosura duhet të përfshijnë si anëtarët e rregullt e të përkohshëm specifikuar në rishikimin e fundit të Standarteve Ndërkombëtare të Klasifikimit të Profesioneve (ISCO).

Papunësia

10 (1) "Të papunët" përfshijnë gjithë personat mbi një moshë specifike të cilët gjatë periudhës së referencës ishin:

(a) "pa punë", dmth jo në punësim të paguar apo vetë punësim siç përshkruhet në paragrafin 9

(b) "aktualisht të gatshëm për punë", dmth ishin të gatshëm për punësim të paguar apo vetëpunësim gjatë periudhës së referencës, dhe

(c) "në kërkim të punës", dmth kishin ndërmarrë hapa specifike në një periudhë të afërt në kërkim të punës së paguar apo vetë punësimit. Hapat specifike mund të përfshijnë regjistrimin në një shkëmbim punësimi publik apo privat, aplikim tek punëmarrësit, kërkim pranë vendeve të punës, fermave, hyrjet e fabrikave, tregut apo vendeve të tjera ku mblidhen ata që kërkojnë punë, vendpsja apo përgjigja ndaj reklamave të gazetave, kërkimi i asistencës nga miqtë apo të afërmit, kërkimi i tokës, ndërtesës apo makinerive e pajisjeve për të ngritur ndërmarrjen e vet, përpjekja për burime financiare, aplikimi për leje e liçensa, etj."

2. Në situata ku mënyrat konvencionale të kërkimit të punës janë të kufizuara, ku tregu i punës është shumë i pa organizuar dhe me kapacitet të kufizuar, ku thithja e punës, është jo e përshtatshme, apo ku fuqia puntore është më shumë e vetë punësuar, përkufizimi standart i papunësisë dhënë në paragrafin (1) mund të zbatohet duke relaksuar kriterin e kërkimit të punës.

3. Në zbatimin e kriterit të mundësisë aktuale për punë, veçanërisht në situatat e mbuluara nga nën paragrafi (2), duhen zhvilluar testet e duhura për t'iu përshtatur rrethanave të vendit. Teste të tilla mund të zbatohen në nocione si dëshira aktuale për punë dhe eksperiencia e mëparshme e punësimit, gadishmëria për të filluar punë mbi terma lokalë të pagës, apo gadishmëria për të ndërmarrë aktivitetin e vetë punësimit duke u nisur nga burimet e nevojshme dhe lehtësirat.

4. Duke mos e ruajtur kriterin e kërkimit të punës të futur në përkufizimin e standartit të papunësisë, personat e papunë dhe aktualisht të mundshëm për punë që kishin bërë përgatitje për të filluar një punë të paguar, apo aktivitet të vetë punësimit në një datë që ndjek periudhën e referencës duhet të konsiderohen të papunë.

5. Personat që përkohësisht mungojnë në punë pa ndonjë shtesë formale pune që janë aktualisht të mundshëm për punësim dhe në kërkim të punës duhet të konsiderohen të papunë në përputhje me përkufizimin standart të papunësisë. Vendet mundet që, në vartësi të rrethanave dhe politikave kombëtare të preferojnë të zvogëlojnë kriterin e kërkimit të punës, në rastin e personave të larguar. Në raste të tilla, personat e larguar përkohësisht që nuk ishin në kërkim të punës, por të klasifikuar si të papunë, duhet të identifikohen si një nën kategori me vehte.

6. Studentët, shtëpiakët dhe të tjerë kryesisht të përfshirë në aktivitete jo – ekonomike gjatë periudhës së referencës që plotësojnë kriteret e vendosura në paragrafët (1) dhe (2) duhet të konsiderohen si të papunë mbi të njëjtat baza si kategoritë e tjera të personave të papunë dhe të identifikohen më vehte, aty ku është e mundur.



Aneksi 1.2

Citime nga Kodi Shqiptar i Punës

Kodi i punes

KREU II : Sipas përmbajtjes

Neni 5

Përjashtohen nga fusha e zbatimit të këtij Kodi:

C) punët familjare, d.m.th, punët që kryhen nga anëtarët e

Familjes: bashkëshorti, fëmijët, paraardhës të tyre ose të afërm të

Tjerë deri në shkallën e dytë, përfshirë të birësuarit për aq kohë

Sa jetojnë me punëdhënësin në një ekonomi të përbashkët, me

Përjashtim të rasteve kur tregohet që personat që i kryejnë ato

Janë punëmarrës.

KRIJIMI I RAPORTEVE INDIVIDUALE TË PUNËS

KREU V

PËRKUFIZIM

PUNA ME KOHË TË PJESSHME

Neni 14

(1) Me kontratën e punës me kohë të pjesshme, punëmarrësi

Pranon të punojë me orë, gjysmë dite pune ose ditë pune, për një

Kohëzgjatje normale javore ose mujore më të vogël se ajo e

Punëmarrësve që punojnë me kohë të plotë në të njëjtat kushte.

(2) Punëmarrësi me kohë pune të pjesshme gëzon të njëjtat të

Drejta, përpjesëtimisht si punëmarrësi me kohë të plotë pune.

PUNA NË SHTËPI

Neni 15

(1) Me kontratën e punës në shtëpi, punëmarrësi detyrohet të

Kryejë punën e tij vetëm ose me ndihmën e anëtarëve të familjes në

Shtëpinë e tij ose në një lokal tjetër të zgjedhur prej tij në bazë

Të varianteve të dhëna nga punëdhënësi.

(2) Punëmarrësi që punon në shtëpi gëzon të njëjtat të drejta

Si dhe punëmarrësi që punon në sipërmarrje. Kur punëmarrësi nuk

Punon në shtëpinë e tij, ai mund të kërkojë shtesë shpenzimesh për

Përdorimin e lokalit.

KOHËZGJATJA DITORE E PUNËS

PËRKUFIZIM

Neni 77

Me kohëzgjatje ditore të punës kuptohet koha e përditshme

Efektive e punës nga ora 0 deri në orën 2400 të së njëjtës ditë, pa përfshirë pushimet.

KOHËZGJATJA E PUNËS DHE PUSHIMI DITOR

Neni 78

- (1) Kohëzgjatja ditore e punës përcaktohet nga kontrata Kolektive ose nga kontrata individuale e punës.
- (2) Kohëzgjatja ditore normale e punës është 8 orë në ditë; Kohëzgjatja ditore e punës mund të jetë më e madhe ose më e vogël Vetëm brenda limiteve të kohës javore maksimale të punës.

PËRKUFIZIM

Neni 82

Me kohëzgjatje javore të punës kuptohet koha e punës e kryer Nga e hëna në mëngjes ora 0 deri të dielën e ardhshme ora 2400.

KOHËZGJATJA MAKSIMALE JAVORE E PUNËS

Neni 83

- (1) Kohëzgjatja normale javore e punës përcaktohet në Kontratën kolektive të punës ose në kontratën individuale.
- (2) Ajo është maksimumi 48 orë në javë.

KREU X**A. MBROJTJA E VEÇANTË PËR TË MITURIT****MOSHA MINIMALE**

Neni 98

- (1) Ndalohe marrja në punë e të miturve nën moshën 16 vjeç. Ky ndalim nuk zbatohet për të miturit jo më pak se 14 vjeç gjatë Pushimeve shkollore.
- (2) Të miturit nën moshën 14 vjeç mund të jenë subjekt i Këshillimit dhe formimit profesional që rregullohet me VKM.

PUNËT E LEHTA

Neni 99

- (1) Të miturit nga mosha 14-18 vjeç mund të punësohen në punë Të lehta që nuk dëmtojnë shëndetin dhe formimin e tyre, vetëm gjatë Pushimeve shkollore.
- (2) Këshilli i Ministrave përcakton punët e lehta dhe vendos Rregulla të veçanta për kohëzgjatjen maksimale dhe kushtet e Kryerjes së punës.



3

Një pamje e përgjithshme e ndryshimeve rajonale**1. Hyrje**

Qëllimi i këtij kapitulli është të japë një pamje të përgjithshme të fuqisë puntore, punësimit dhe papunësisë në Shqipëri siç rezultuan nga regjistrimi i vitit 2001. Aty ku është e mundur do të jepen krahasimet me regjistrimin e mëparshëm të kryer në 1989. Këto krahasime do të kryhen me kujdes për shkak të ndryshimeve të mëdha në modelet ekonomike dhe politike që kanë ndodhur ndërkohë. Të dhënat nga Studimi i MSJ i kryer në 2002, rreth një vit pas regjistrimit të 2001, do të bëhet kryesisht për analiza të thella mbi çështje specifike që nuk ishin vëzhguar në regjistrim.

Kuadri territorial i referencës do të përdoret shpesh në këtë studim, duke u krahasuar me kryeqytetin, Tiranën urbane, ose me zona të tjera urbane apo ruraleose duke përdorur 36 rrethet në të cilat është ndarë Shqipëria që në 1992 dhe për të cilat është bërë rregullimi i të dhënave të regjistrimit të vitit 1989. Ndarja urbane/rurale plotëson më shumë kërkesat e studimit që ka qëllim të kuptojë modelin e ndryshëm të punësnë mjedise të ndryshme. Ndërsa ndarja administrative, mund të jetë e

dobishme për bërësit e politikave kombëtare, si dhe të atyre lokale për të kuptuar ndryshmet ekzistuese rajonale dhe për të planifikuar ndërhyrjet e duhura. Përveç disa komenteve në tekstin e zhvilluar në nivel rajonal, ne preferuam të mbildhnim të gjithë materjalin statistikor në Aneksin 3.1 – Fuqia Puntore, Punësimi dhe Papunësia në rrethet shqiptare, ku raportohen edhe disa komente të shkurtra mbi ndryshimet rajonale.

Kapitulli ndjek një metodë që shkon nga e përgjithshmja tek specifika, duke nisur nga popullsia në moshë pune, nga e cila vjen edhe shumica e fuqisë puntore. Më pas, popullsia ekonomikisht aktive – dmth fuqia puntore – merret në konsideratë. Dy komponentët e saj – popullsia e punësuar dhe e papunë – analizohen, shqyrtohen, sipas pikëpamjeve të ndryshme, si komponentët e së dytës edhe përbërja e së parës. Për të plotësuar kuadrin, analizohet gjithashtu edhe kategoria e të rriturve inaktivë, pse aty gjejmë persona (kryesisht studentë) që përgatiten të hyjnë në tregun e punës, si edhe persona që tashmë janë larguar nga ky treg, duke qenë në pension.



2. Popullsia në moshë pune dhe vartësia demografike

Për të përcaktuar periudhën e kufijve moshorë nuk është e lehtë. Në ekonomitë rurale, kufijtë moshorë për të punuar mund të mos ekzistojnë fare, duke qenë se anëtarët e familjes janë të angazhuar në punët rurale dhe të shtëpisë pavarësisht moshës, punës që duhet të bëjnë, si dhe funksionet që duhet të kryejnë në vartësi kryesisht të mundësive të tyre fizike dhe aftësive që mund të kenë fituar. Në qytete situata është e ndryshme, duke patur një përzierje aktivitetesh dhe profesione – veçanërisht në shërbimin civil, ndërmarrje të përparuar dhe sektorit terciar shumë të zhvilluar – në të cilin moshat e hyrjes dhe daljes janë plotësisht të përcaktuara. Personat që bëjnë këto punë janë zakonisht jashtë tregut të punës para dhe pas kësaj moshe.

Siç edhe e përmendëm në kapitullin e mëparshëm ligji shqiptar e ndalon punën e pavarur para moshës 16 vjeç, ndërsa arsimimi i detyruar zgjat 8 vjet duke nisur që nga moshat 6 e 7 vjeç (Këshilli i Ministrave 2001 :71). Megjithatë të gjitha pyetjet në pyetësonin e regjistrimit të popullsisë ishin për personat nga 15 vjeç e lart. Kështu, lajmet në Shqipëri për punën e fëmijëve nuk mundësohen nga

Puna e fëmijëve në Shqipëri kohët e fundit.

Nuk janë kryer studime në shkallë kombëtare mbi punën e fëmijëve para studimit të MSJ, ku të ishin përfshirë pyetje rreth punës së fëmijëve nga 6-14-vjeç. Rezultatet treguan se 9.8% e fëmijëve në ato moshë ishin të përfshira në punë. Kishte shumë prej tyre nga zonat rurale, duke punuar në njësitë ekonomike bujqësore të drejtuar nga familjet e tyre. Në zonat urbane, vetëm, 0.3% të fëmijëve punonin, ndërsa në zonat rurale fëmijët në punë ishin 16 % e numrit të përgjithshëm nga 6-14 vjeç. Shumica e fëmijëve punojnë teksa vazhdojnë shkollën, ndërsa vetëm 8.9% e tyre deklarojnë se nuk e ndjekin shkollën. Të dhënat tregojnë se 2% e fëmijëve në punë ishin të përfshirë në aktivitete tregëtare, kurse pjesa më e madhe – 95.6 % – përfshiheshin në aktivitete bujqësore.

regjistrimi i popullsisë: disa sugjerime për këtë jepen nga studimi i MSJ për 2002.

Nuk është e përcaktuar me ligj moshat më të lartë, ndërsa ato të përmendurat janë të përcaktuara me aktin e vitit 1993 mbi Sigurimet Shoqërore në Shqipëri, që sidoqoftë nuk janë detyruese. Megjithatë, sjellja aktuale e puntorëve në daljen në pension duke ndjekur rregullat aktuale e bën moshën 55 vjeç, moshën mbizotëruese të dalsjes në pension të femrave dhe 60 vjeç për meshkujt, veçanërisht në zonat urbane.

Si rrjedhojë, ne zgjodhëm të përcaktojmë kohëzgjatjen e moshës së punës në dy mënyra të ndryshme:

i) Duke ndjekur standartet ndërkombëtare nga 15 në 64 vjeç, për qëllim krahasimi;

ii) Duke ndjekur sjelljen aktuale të meshkujve dhe femrave në vend nga 15 në 54 vjeç për meshkujt dhe nga 15 në 59 për femrat.

Në tabelën 3.1, sasia e dhe % e numrit të përgjithshëm të popullsisë raportohen të ndjekin dy përkufizime të ndryshme dhe duke krahasuar 2001 me 1989. Në të dy metodat, numri i popullsisë në moshë pune ka rënë, sidomos në përkufizimin më të ngushtë (-66 mijë, ose -3.6%). Por, ndërsa numri i femrave në moshë pune është rritur pak, popullsia e meshkujve në moshë pune ka humbur 56 ose 76 mijë persona, dmth. 5.6% në definicionin 15-64 apo 7.7% me metodën 15-59. Pasojat e 10 vjetëve të emigracionit të selektuar janë të qarta në popullsinë mashkullore dhe femërore.

Duke mos i rrëzuar këto tendenca, % e popullsisë në moshë pune e dalë nga numri i përgjithshëm i popullsisë është rritur apo ka mbetur afërsisht i njëjtë për meshkujt. Në fakt, Shqipëria ka një strukturë të re moshore sipas standarteve Evropiane. Më shumë se gjysma e popullsisë, është nën 29 vjeç (popullsia

Tabela 3.1 - Popullsia në moshë, sipas gjinisë dhe definicionit: 1989 dhe 2001

Definicioni i Grup moshes në vite	Regjistrimi 1989			Regjistrimi 2001		
	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Në mijë						
15-64	1,017	946	1,963	961	978	1,939
15-59 për meshkuj, 15-54 për femra	979	855	1,833	903	864	1,767
% ndaj popullsisë sipas gjinisë						
15-64	62.1	61.2	61.7	62.8	63.6	63.2
15-59 për meshkuj, 15-54 për femra	59.7	55.3	57.6	59	56.1	57.6

Burimi: përpunimi i të dhënave të regjistrimeve 1989 dhe 2001.

0-14-vjeç përbën 29.3% të popullsisë së përgjithshme, ndërsa popullsia 15-29-vjeç përbën 24.1%). Krahasimet sipas rezidencave urbane/rurale tregojnë se popullsia që jeton në zonat urbane është më e vjetër se ajo që jeton në zonat rurale. Kështu, popullsia 15 vjeç e lart është 73.6% e popullsisë urbane, ndërsa në zonat rurale % respektive është 68.6%. Popullsia më e madhe është më shumë e përqendruar në qytetet e urbanizuara dhe industrializuara, si edhe në qytetet me emigracion më të lartë (shiko hartat 6 dhe 7 në Atlas). Kështu, në qytete si Korça, Tirana, Delvina, Gjirokastra dhe Kucova popullsia 0-14 vjeç përbën 22.3-25.1% të numrit të përgjithshëm të popullsisë, ndërsa popullsia e grup moshës nga 15-29 vjeç përbën 20.4-22.4%. Por që prej 1960 Shqipëria ka kaluar gjithashtu përmes një fertiliteti konstant zvogëlues nga rreth 7 në 2 fëmijë për grua në moshë mesatare, kështu trashëgimtarët e porsalindur janë më pak të dendur se ata para tyre, dhe ndërkohë ka filluar procesi i plakjes.

Nëse shohim shpërndarjen e moshës së popullsisë shqiptare (Figura 3.3 dhe regjistrimi i vitit të 2001 INSTAT, Rezultatet kryesore. etj,fq.30) kuptojmë potencialin e konsiderueshëm të fuqisë puntore ku vendi mund të mbështetet në vitet e ardhshme. Numri i të rinjve që do të kalojnë nga një kufi moshor më i ulët 15 vjeç dhe/ose për të hyrë në tregun e punës në një moshë pak më të rritur. Raporti i vitit 1998 i UNFPA-së e quan këtë fenomen, që është i përbashkët për shumë vende në zhvillim, si një “bonus

demografik për15-20 vitet e ardhshme”. Problemi është si ta përdorim gjithë këyë potencial që të përfitojmë nga ekonomitë e tyre shpesh të pasigurta.

Popullsia nga 15-64 vjeç ishte rreth 1.9 milion sipas regjistrimit të 2001, dmth. 63.2% e numrit të përgjithshëm të popullsisë. Kjo kuotë ishte më e lartë në zonat urbane dhe veçanërisht në kryeqytet, ku 2/3 e popullsisë ishin në moshë pune. (Tabela 3.2). Mbi prania e fuqisë puntore në moshë të re në lëvizjet e drejtura nga qendrat urbane [Galanxhi et al., 2003] shpjegojnë ndryshimet urbane/rurale. Megjithatë, krahasimi me të dhënat e regjistrimit të 1989 tregon se ndikimi i popullsisë nga 15-64 u zvogëlua në zonat urbane, dhe veçanërisht qytetin e Tiranës

Tabela 3.2 - Popullsia në moshë pune (15-64 vjeç) sipa gjinisë dhe vendbanimit:1989 dhe 2001

(përqindja e grupit ndaj popullsisë përkatëse)

Gjinia/Zona	Regjistrimi 1989	Regjistrimi 2001
Meshkuj		
Tirana urbane	68.8	66.3
Të tjera urbane	65.3	64.3
Rurale	59.9	61.3
Vendi	62.1	62.8
Femra		
Tirana urbane	69.4	67.7
Të tjera urbane	65.2	65.7
Rurale	58.4	61.6
Vendi	61.2	63.6
Gjithsej		
Tirana urbane	69.1	67
Të tjera urbane	65.2	65
Rurale	59.2	61.5
Vendi	61.7	63.2

Burimi: përpunimi i të dhënave të regjistrimeve 1989 dhe 2001.



(megjithëse duke ruajtur nivelin e tij mëtë lartë), tekta u rrit në shkallë vendi.

Nga pikëpamje plotësisht demografike, raporti mes popullsisë më të re apo më të vjetër se kufijtë e moshës së punës – dmth. 14 vjeç apo më të re, apo 65 vjeç apo më të vjetër – dhe potenciali i fuqisë puntore nga 15-64 vjeç është tregues i fuqishëm, sintetik i strukturës së popullsisë. Ai jep ngarkesën “jo prodhuese” për një person “potencialisht produktiv”. Në tabelën 3.3 jepen raportet e të rinjve, të rriturve, dhe raportin e përgjithshëm të vartësisë demografike.

0.49 persona jo në moshë pune për person në moshë pune. Teksa komponenti e ka zvogëluar ngarkesën e vet kudo përveç Tiranës, (ku ai ishte dhe mbetet më i ulët se në gjithë vendin), komponenti më i rritur e ka rritur ngarkesën e vet, veçanërisht në Tiranë dhe zonat e tjera urbane.

Analiza sipas rretheve (shiko Hartën 8 në Atlas) tregon se rrethet me numër të lartë të popullsisë nga 15-64 vjeç më 2001 dhe, si pasojë, një raport të përgjithshëm vartësie demografike më të ulët ku Devoll, Korca, Skrapar dhe Tirana, kishin shifra e rreth një personi “jo produktiv” për dy në moshë pune, kurse në rrethe si Hasi, Kukes, Malsia e Madhe dhe Puka raporti i vartësisë ishte një për 1.5. Pamja ishte e ndryshme në 2001 gjithashtu mes qyteteve. Qytetet me numër të lartë të popullsisë 15-64 vjeç ishin Berati, Gjirokastra, Skrapari dhe Tirana, ku popullsia e atij grup moshe ishte mbi 67%, ndërsa në qytete të tjera si Bulqize, Has, Kukes dhe Pukë numri ishte 60%. Analiza të mëtejshme sipas komponentëve të vartësisë (shiko Hartën 9 dhe 10 në Atlas) tregojnë se në pjesën veriore ë vendit dhe respektivisht në rrethet e Bulqizës, Dibrës, Hasit, Kukësit, % e popullsisë 0-14 vjeç në raport me 15-64 vjeç është më e lartë, që shkon nga 5.9 në 7.2. Karakteristikë për këto rrethe është se raporti nuk është shumë i ndryshëm për zonat urbane/rurale. Ndërkohë, në rrethe të tjera si Delvine, Devoll, Gjirokaster, Korçë dhe Kolonjë, që ndodhen në jug ë Shqipërisë dhe veçanërisht në qytete të këtyre rretheve, raporti i vartësisë është mjaft më i ulët, duke shkuar nga 3.6 në 4.0. Në rrethe si Delvina, Devoll, Kolonjë, Përmet dhe Sarandë, veçanërisht në zonat e tyre rurale, raporti i vartësisë për më të rriturit është 1.3 deri në 2 herë më i lartë se mesatarja e vendit. Migrimi i lartë ndërkombëtar nga këto zona, kryer nga të rinj, justifikon këto nivele.

Prania e të rinjve në vend dhe sidomos në zonat rurale ndriçohet nga seksioni i parë i Tabelës 3.4, ku pjesa më e re e popullsisë në

Tabela 3.3 - Koeficienti i varësisë sipas venbanimit dhe përbërësve: 1989 dhe 2001

Gjinia / Zona	Regjistrimi 1989	Regjistrimi 2001
Koeficienti i varësisë së Të rinjve (a)		
Tirana urbane	0.36	0.36
Të tjera urbane	0.46	0.42
Rurale	0.6	0.51
Vendi	0.54	0.46
Koeficienti i varësisë së Të moshuarve (b)		
Tirana urbane	0.09	0.13
Të tjera urbane	0.07	0.12
Rurale	0.09	0.12
Vendi	0.09	0.12
Koeficienti i varësisë (c)		
Tirana urbane	0.45	0.49
Të tjera urbane	0.53	0.54
Rurale	0.69	0.63
Vendi	0.63	0.58

Burimi: përpunimi i të dhënave të regjistrimeve 1989 dhe 2001.

(a) Pop.0-14vj / Pop.15-64vj.

(b) Pop.65+vj / Pop.15-64vj.

(c) (Pop0-14vj + Pop.65+vj) / Pop.15-64vj.

Në vend kishte 0.58 persona në popullsinë në moshë pune për person, me një ulje nga regjistrimi i vitit 1989 (0.63). Rëniet kanë qënë më të mëdha në Shqipërinë rurale, ku tani kemi 0.63 persona të moshës jo puntore për çdo person më moshë pune, krahasuar me 0.69 në 1989. Rënia në zonën rurale mund të shpjegohet kryesisht me uljen relative të popullsisë nga 0-14 vjeç (-23 %) krahasuar me rritjen e popullsisë në moshë pune (+14 %). Në zonat urbane, sidomos në qytetin e Tiranës, kjo tendencë është rritur nga 0.45 në

moshë pune, nga 15-39 vjeç, lidhet me pjesën më të vjetër, 40-64 vjeç. Në regjistrimin e vitit 200, raporti në shkallë vendi është 1.5 persona më të rinj në moshë pune, për secilin puntor të mundshëm të rritur. Struktura e popullsisë së re të popullsisë shqiptare konfirmohet me këtë rast. Me ndryshimet e viteve 1989-2001, raportet u zvogëluan kudo, duke treguar një proces të shpejtë plakjeje që ndikonte tek fuqia potenciale puntore. Pjesë e këtij zvogëlimi mund të shpjegohet me migrimin ndërkombëtar që ndodhi në vitet '90, numrit të madh të personave që janë jashtë. Por plakja e fuqisë puntore potenciale është më e theksuar në zonat urbane dhe, për meshkujt, në qytetin e Tiranës, kundrejt një lëvizjeje më të ngadalshme në zonat rurale. Mund të argumentojmë se migrimi i jashtëm ka qenë më selektiv në zonat jo – bujqësore, të cilat për shkak të transformimit të tyre ekonomik dhe krizës industriale, knaë përjashtuar pjesën më të re dhe më produktive të potencialit të tyre të punës, që kanë gjithashtu migruar jashtë vendit në një numër të madh.

Të ardhurit e grupmoshës në popullsinë me moshë pune, që krahasohet me inputin e tregut të punës, - (nga 15-19 vjeç – tek outputi (nga 60-64 vjeç) përbëjnë një masë të shkëlqyer për tendencat e ardhme afat-shkurtra. Megjithëse ky nuk është rasti aktual në Shqipëri, të ardhurat tregojnë se në 1989 kishte 4 persona të grup moshës 15-19 për 1 person të grup moshës 60-64 (seksioni i dytë i tabelës 3.4). Në 2001, ky raport u zvogëlua në 2.6 për shkak të zvogëlimit të dimensionit të grupeve dhe personave me moshë mesatare që mbijetojnë. Ulja e viteve 1989-2001 ka qenë më e fortë në zonat rurale dhe mes meshkujve. Tendencat janë në kontrast sa i takon kryqytetit (thuajse i pandryshuar në vlerat e ulta), pjesës tjetër të Shqipërisë urbane (ulja e lehtë e vlerave mesatare) dhe zonat rurale (rënie më e fortë, megjithëse ruan vlerën më të lartë).

Megjithë "deficitin" e madh prodhuar nga një dekadë emigracioni selektiv dhe plakje konstante e fuqisë puntore potenciale,

Tabela 3.4 - Struktura moshore e popullsisë sipas gjinisë dhe vendbanimit: 1989 dhe 2001

Gjinia/ Zona	Struktura e brendshme: 15-39 vjeç / 40-64 vjeç		Kthimi i brezave: 15-19 vjeç / 60-64 vjeç	
	Regjistrimi 1989	Regjistrimi 2001	Regjistrimi 1989	Regjistrimi 2001
Meshkuj				
Tirana urbane	1.8	1.2	2	1.9
Të tjera urbane	2.1	1.2	3.4	2.2
Rurale	2.4	1.7	5.4	2.9
Vendi	2.3	1.5	4.3	2.5
Femra				
Tirana urbane	1.8	1.3	1.9	1.9
Të tjera urbane	2.3	1.4	3	2.4
Rurale	2.4	1.8	4.4	3.2
Vendi	2.3	1.6	3.7	2.7
Gjithsej				
Tirana urbane	1.8	1.3	2	1.9
Të tjera urbane	2.2	1.3	3.2	2.3
Rurale	2.4	1.8	4.8	3
Vendi	2.3	1.5	4	2.6

Burimi: përpunimi i të dhënave të regjistrimeve 1989 dhe 200.

Shqipëria ende ka një potencial të ri e të madh demografik që mund t'i besojë në vitet e ardhme për zhvillimin ekonomik, duke marrë të mirëqenë faktin se ka një kërkesë të mjaftueshme pune, në sasi e cilësi, që prodhohet brenda vendit për të shmangur emigrimin e mëtejshëm.

3. Pjesëmarrja e fuqisë punëtore

Kur trajtojmë fuqinë punëtore – dmth njerëzit që punojnë aktualisht dhe ata që po kërkojnë punë për herë të parë apo sespe e kanë humbur atë që kishin – duhet të jemi të qartë se ajo nuk është terërisht pjesë e popullsisë në moshë pune, meqë ka, duke përjashtuar punën e fëmijëve, punëtorë të ardhur që e kanë kaluar kufirin moshor 65-vjeç, sidomos në bujqësi, tregëti, profesione të lira – përgjithësisht – në aktivitete të vetë punësimit. Kështu, në Tabelën 3.5 të dhënat i referohen gjithë popullsisë nga 15 vjeç e lart sipas statusit të tyre ekonomik dhënë nga vetë ata ose nga personi i intervistuar në shtëpi, respektivisht në regjistrimet e viteve 1989 dhe 2001.



Tabela 3.5 - Popullsia 15 vjeç e lart sipas gjinisë dhe statusit të punësimit: Shqipëria, 1989 dhe 2001

Gjinia/ Zona	Regjistrimi 1989			Regjistrimi 2001		
	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Në mijë						
Të punësuar	779	664	1,443	650	392	1,042
Të papunë	62	94	157	150	155	306
Gjithsej aktivë	842	758	1,600	800	548	1,347
Jo aktivë	249	283	532	269	554	823
Gjithsej 15 vjeç +	1,090	1,041	2,132	1,069	1,101	2,170
% dalë nga popullsia 15+vj sipas gjinisë						
Të punësuar	71.5	63.8	67.7	60.8	35.6	48
Të papunë	5.7	9	7.3	14	14.1	14.1
Gjithsej aktivë	77.2	72.8	75	74.8	49.7	62.1
Jo aktivë	22.8	27.2	25	25.2	50.3	37.9
Gjithsej 15 vjeç +	100	100	100	100	100	100

Burimi: përpunimi i të dhënave të regjistrimeve 1989 dhe 2001.

Fuqia punëtore në Shqipëri ishte 1,347 mijë sipas regjistrimit të vitit 2001, 62% e popullsisë nga 15 vjeç e lart. Me ndryshimet në përkufizime dhe metodat e studimit, fuqia punëtore ra me më shumë se 15% në 1989, si mesatare, me një fuqi punëtore femërore që humbiste më shumë se $\frac{1}{4}$ dhe meshkujt vetëm 5%.

Ndërsa në regjistrimin e 1989 rreth $\frac{3}{4}$ e popullsisë 15 vjeç e lart përfshiheshin në fuqinë punëtore mes pak ndryshim mes meshkujve dhe femrave, në vitin 2001 kjo lloj barazie gjinore humbi sa kohë që vetëm gjysma e femrave adulte marrin pjesë në tregun e punës, duke punuar (36%) ose duke kërkuar punë (14%), ndërsa raporti dhe numri i femrave jo aktive u dyfishua. Meshkujt në të kundërt, gati e ndryshuan ndarjen e tyre mes të punësuarve (61% vs. 71 në 1989) dhe të papunës (14 vs. 6) vetëm, megjithë uljet në numrin absolut të personave të punësuar.

4. Punësimi dhe papunësia:

Vartësia ekonomike

4.1 Punësimi dhe papunësia nga të dhënat e regjistrimeve të viteve 1989 dhe 2001

Më pak se gjysma e popullsisë 15 vjeç e lart deklaruan të ishin të punësuar në regjistrimin e vitit 2001 (Tabela 3.6). Ky raport është më i lartë (51%) në Shqipërinë rurale se në qytetin e Tiranës (46%) dhe në zona të tjera urbane (43%). Është rreth 60% për meshkujt gati kudo, ndërsa për femrat shifra e punësimit bruto (numri i personave të punësuar si pjesë e popullsisë 15 vjeç e lart) është mes 30 dhe 40 %, me vlerat më të ulta në zonat urbane ndryshe nga Tirana.

Megjithëse jo tërësisht të krahasueshme për shkak të përkufizimeve të ndryshme, shifrat e punësimit bruto në 1989 ishin shumë më të larta, si për meshkujt edhe për femrat. Në atë kohë, kishte më shumë se $\frac{2}{3}$ e popullsisë adulte që punonte, me një shifër punësimi për femrat mbi 60 % kudo. Megjithë migrimin e madh të meshkujve të viteve '90 duket se nuk ka patur efekt zëvendësues të raportit femër-mashkull në ekonominë lokale, as në zonat rurale apo në aktivitetet bujqësore. Por punësimi femëror u zvogëluar më shumë në zonat urbane, dhe mund të argumentojmë se ai ndodhi për disa arsye:

- i) për shkak të mbylljes së aktiviteteve të mëparshme industriale;
- ii) për shkak të aktiviteteve të orientuara më shumë nga meshkujt, si tregëtia dhe ndërtimi, që edhe mbizotëruan më pas;
- iii) si pasojë e lëvizjeve rurale-urbane, që vështirë t'u japë mundësi femrave që kanë imigruar të hyjnë në tregun urban të punës (INSTAT 1996, 2002a).

Tabela 3.6 – Shkalla e pjesmarrjes se forcave të punës dhe shkalla bruto e punësimit sipas gjinisë dhe vendbanimit: 1989 dhe 2001

Gjinia / Zona	Shkalla e pjesmarrjes së forcave të punës(a)		Shkalla bruto e punësimit (b)	
	Regjistrimi 1989	Regjistrimi 2001	Regjistrimi 1989	Regjistrimi 2001
Meshkuj				
Tirana urbane	76.6	71	68.7	57
Të tjera urbane	78.9	73.3	70.5	56.6
Rurale	76.5	76.4	72.3	63.9
Vendi	77.2	74.8	71.2	60.8
Femra				
Tirana urbane	72.1	52.8	61.7	34.7
Të tjera urbane	74.7	56.6	62.5	30.9
Rurale	72	45.1	64.7	38.5
Vendi	72.8	49.7	64.9	35.6
Gjithsej				
Tirana urbane	74.4	61.7	65.2	45.6
Të tjera urbane	76.8	64.7	66.5	43.4
Rurale	74.3	60.7	68.6	51.1
Vendi	75	62.1	68.2	48

Burimi: përpunime të të dhënave të regjistrimeve 1989 dhe 2001.

(a) (Popullsia e punësuar + e papunë) / popullsinë 15vjeç e lart (%)

(b) Të punësuarit/Popullsinë 15 vjeç e lart (%)

Zbatimi i një tregu pune real i vendos shumë aktivitete ekonomike të kryera nga femrat në shtëpi apo në fusha jashtë funksionit të perceptuar si aktivitete pune. Në krahun tjetër, kushtet e shëpiakes mund të jenë të dëshirueshme nga çiftet e klasës së mesme që mund ta përballojnë të jetojnë me një rrogë të mashkullit që fiton “bukën e gojës”. Për më tepër, femrat që vijnë nga fshati në zonat urbane vështirë se e shtyjnë veten drejt tregut urban të punës, për shkak të arsimit të ulët dhe mungesës së specializimit modern (Komisioni Evropian 2003).

Raporti mes popullsisë në punë “jo aktive” është një mjet ekonomik i kufirit demokonomik që duhet të ndërmarrë çdo puntor, mesatarja, në nivel familjar dhe shoqëror. Në popullsi shumë të reja dhe shumë të vjetra, kjo pengesë ia kalon barazisë. Në të kundërt, pjesmarrja e qartë e femrave në aktivitete pune në moshat e mesme mund ta lehtësojnë atë. Në Tabelën 3.7, në shkallë vendi, rritja e shifrës së papunësisë ka shkaktuar një rritje të të konsiderueshme të raportit neto të vartësisë nga 1.2 në gati 2 prej vitit 1989 në 2001,

veçanërisht në zonat urbane. Kjo nënkupton se aktualisht, për çdo person të punësuar ka dy persona që nuk punojnë, duke shkaktuar një përgjegjësi të madhe, kryesisht në qytete, ku personi i punësuar mund të jetë i vetmi që paguhet në familje.

Tabela 3.7 - Shkalla e varësisë ekonomike dhe shkalla e punësimit periferik/qëndror sipas vendbanimit: 1989 dhe 2001

Gjinia/ Zona	Regjistrimi 1989	Regjistrimi 2001
Raporti i varësisë bruto(a)		
Tirana urbane	0.79	1.13
Të tjera urbane	0.86	1.12
Rurale	1.08	1.4
Vendi	0.99	1.28
Raporti i varësisë neto(b)		
Tirana urbane	1.04	1.89
Të tjera urbane	1.14	2.17
Rurale	1.26	1.85
Vendi	1.21	1.95
Shkalla e punësimit periferik/qëndror ©		
Tirana urbane	0.33	0.47
Të tjera urbane	0.34	0.48
Rurale	0.65	0.7
Vendi	0.52	0.6

Burimi: Përpunimi i të dhënave të regjistrimeve 1989 dhe 2001.

(a) Popullsia jo aktive/Popullsisë aktive

(b) Gjithsej të pa punësuar/Të punësuarve gjithsej

(c) (Të punësuar 15-24vjeç + Të punësuar 50vjeç+) / Të punësuar 25-49vjeç



Siç e tregon edhe raporti i punësimit periferik/ të qendrës, në zonat urbane punësimi është shumë i përqendruar mbi popullsinë e qendrës në moshë pune, dmth. popullsia e moshës 25-49 vjeç, kur angazhimet e familjes janë gjithashtu të vështira. Në zonat rurale, aktiviteti i punës është më i shpërndarë duke përfshirë edhe fuqinë puntore më të re dhe më të vjetër.

Punësimi i plotë, dmth tregjet e punës ku të qëndrueshëm janë 3-5 % të fuqisë punëtore – është qëllimi kryesor i çdo programi ekonomik. Suksesi i politikave ekonomike që kryhen nga qeveria shpesh maten përmes nivelit të punësimit që ai prodhon. Kjo ishte veçanërisht e vërtetë në regjimin socialist, meqë sigurimi i shanseve të barabarta për punë për të gjithë njerëzit, përbente një nga parimet kryesore të politikës së shtetit në parimet kryesore të tyre.

Tabela 3.8 - Shkalla e papunësisë sipas gjinisë dhe vendodhjes 1989 dhe 2001
(% e popullsisë në kërkim të punës/popullsia aktive)

Gjinia/ Zona	Regjistrimi 1989	Regjistrimi 2001
Meshkuj		
Tirana urbane	10.4	19.7
Të tjera urbane	10.7	22.8
Rurale	5.5	16.4
Vendi	7.4	18.8
Femra		
Tirana urbane	14.5	34.3
Të tjera urbane	16.3	45.5
Rurale	10.1	14.5
Vendi	12.4	28.4
Gjithsej		
Tirana urbane	12.4	26.1
Të tjera urbane	13.4	33
Rurale	7.7	15.7
Vendi	9.8	22.7

Burimi: përpunimi i të dhënave të regjistrimeve të 1989 dhe 2001.

Megjithëse nuk ishte përmendur më parë, të dhënat e regjistrimit të 1989 treguan një nivel papunësie prej 9.8% në Shqipëri, me një nivel më të lartë për femrat (12.4%) dhe më të ulët për meshkujt (7.4%). Siç edhe pritej, papunësia ishte më e lartë në zonat urbane se në ato rurale.

Duke krahasuar të dhënat e regjistrimit të 1989 me ato të vitit 2001, kuptojmë se njerezëit që kërkonin punë u dyfishuan në numër (Tabela 3.5) dhe në % të fuqisë punëtore (Tabela 3.8), por në duhet të kuptojmë ndryshimet në përkufime dhe të dhënat e trajtimit. Shkalla e papunësisë tek femrat shkoi në 45% në zonat urbane ndryshe nga Tirana, në të cilin ishte 34%. Vetëm se në zonat rurale rritja ishte e

Kriza ekonomike dhe politike e Shqipërisë ish komuniste

Në Shqipëri, gjatë regjimit komunist, u ndoq një politikë e gjerë e industrializimit të vendit. Kjo politikë u shoqërua me krijimin e vendeve të punës në mënyrë masive, kryesisht me pagë të ulët. Por gjatë viteve 80's, pati rënie të thellë të investimeve shkak i vështirësive financiare dhe mungesës së kapitalit. Duke kosnideruar gjithashtu hapin e shpejtë me të cilin rritej popullsia dhe rritjen e potencialit të fuqisë së re punëtore, ekonomia nuk kishte mundësi të siguronte punë për gjithkënd dhe papunësia filloi të rritej në ekonominë shqiptare, megjithë që nuk është përmendur asnjëherë zyrtarisht.

Në 1988, i ashtuquajtur "mekanizmi i ri ekonomik" u vu në praktikë, përmes të cilit u jepej një pavarësi relative ndërmarrjeve për të siguruar lëndën e parë vetë kur të ishin në kushte të varfëra ekonomike. Kjo nuk i zgjidhte problemet me të cilat përballej vendi dhe ekonomia e tij, por në të kundërtën, ai shkaktoi përsheptimin e falimentimit të plotë të ekonomisë socialiste shqiptare. Paga e të punësuarve ra për shkak të vështirësive në gjetjen e lëndës së parë: ndërmarrjet filluan të zbatojnë shlyerjen e 80% të pagave pa kërkuar pjesmarrjen në punë. Kjo pati pasoja katastrofike për ekonominë socialiste shqiptare. Gjithë ekonomia e vendit u shkatërrua dhe kjo përsheptoi fillimin e proceseve demokratike.

kufizuar meqë shkalla e papunësisë tek femrat u rrit vetëm nga 10.1 në 14.5. Këto shifra të larta të papunësisë për femrat në zonat urbane dëshmojnë vështirësitë që kanë femrat në gjetjen e një pune dhe, në të njëjtën kohë të nevojës së çifteve për të fituar të ardhura të dyfishta. Sidoqoftë, rënia serioze paralele që ka pësuar fuqia punëtore e femrave (-211 mijë krahasuar të dhënat e regjistrimit të 2001 me ato të 1989 në shkallë kombëtare) na bën të dyshojmë se se numri i femrave inaktive janë aktualisht “të papunë të dekurajuar” ose që kryejnë punë të përkohshme apo aktivitete në ekonominë informale që nuk janë deklaruar gjatë regjistrimit.

Papunësia në tranzicion

Ndryshimet drastike ekonomike dhe sociale të viteve 90-të shkaktuan një rritje të konsiderueshme të shkallës së papunësisë. Niveli i papunësisë ishte 26% në fund të vitit 1992, që do të thotë se ishte rritur me 3 herë që prej vitit 1991. Në fakt ka qenë vlera më e lartë e papunësisë e regjistruar ndonjëherë gjatë dekadës së fundit. Që prej 1992, dhe gjatë gjithë dekadës së fundit, treguesi i papunësisë ka qenë më i lartë për femrat duke e krahasuar me meshkujt. Kjo ka ndodhur sepse është veçanërisht e vështirë për femrat të përshtaten në tregjet e reja të punës. Në fund të vitit 1992 kishte rreth 200 mijë femra të papuna dhe rreth 190 mijë meshkuj të papunësuar.

4.2 Punësimi, papunësia dhe puna me kohë të pjesshme sipas të dhënave të Studimit të MSJ të vitit 2002

Vlera e punësimit e dhene nga studimi SMSJ është më e ulët në zonat urbane dhe më e lartë në mjediset rurale në krahasim me të dhënat e regjistrimit të vitit 2001, megjithë që aktivitetet rurale për më pak se 15 orë në javë nuk u morën në konsideratë. (Tabela 3.9). Veçanërisht për femrat, punësimi në Tiranë dhe zona të tjera urbane u vu re se ishte në

Tabela 3.9 - Popullsia sipas gjinisë, vendodhjes dhe statusit ekonomik: 2002 LSMS

Gjinia/Zona	Shkalla bruto e punësimit	Shkalla e papunësisë		Shkalla e aktivitetit	
		Definicioni standart	Definicioni i zgjeruar	Definicioni standart	Definicioni i zgjeruar
Meshkuj					
Tirana urbane	52.2	18.9	24	64.4	68.7
Të tjera urbane	48.3	19.8	26.8	60.6	66.4
Rurale	65.6	4.3	7.2	78.5	80.9
Vendi	58.5	10.1	14.5	71.2	74.9
Femra					
Tirana urbane	26.4	22.2	29.8	33.9	37.6
Të tjera urbane	26.1	28.3	40.7	37.2	45.1
Rurale	46.9	2	6.7	59.1	62
Vendi	38	9.9	17.5	49.3	53.8
Gjithsej					
Tirana urbane	38.8	20.1	26.2	48.5	52.5
Të tjera urbane	36.6	23.3	32.8	48.3	55.1
Rurale	55.7	3.3	6.9	68.2	70.9
Vendi	47.7	10	15.8	59.6	63.8

Burimi: përpunimi i të dhënave LSMS 2002.

(a) konsiderohen të papunë ata që punojnë në bujqësi për më pak se 15orë/javë


nivel më të ulët se i të dhënave të vitti 2001, teksa femrat në zonat rurale ishin në aktivitete produktive në sasi më të madhe. Studimi, ndoshta pati sukses në kufizimin e vetë deklarimit të papunësisë, veçanërisht në zonat rurale dhe femrat. Për to, sipas të dhënave të studimit të MSJ, vlera është më e ulët se regjistrimi i vitit 2001, edhe nëse marrim përkufizimin më të relaksuar. Shumë prej tyre deklaruan se ishin në kërkim të punës gjatë regjistrimit ndoshta, sepse familjet e tyre kanë nevojë për më shumë të ardhura se aktivitetet e kërkimit të punës.

SMSJ 2002 u përpoq të nxirrte në pah “personat e papunë e të dekurajuar”, ata persona jo aktivë në moshë pune, që megjithë dëshirën për punë, e abandonuan kërkimin e punës duke parë që gjendja e tregut të punës nuk e lejonte hyrjen e tyre të sukseshme. Në praktikë, persona të papunë të dekurajuar u konsideruan të gjithë ata persona të moshës 15 vjeç e lart, që nuk kishin kërkuar punë gjatë 4 javëve të mëparshme, sepse mendonin se nuk kishin asnjë shans për të gjetur një punë. Ata u konsideruan si pjesë e përkufizimit të



relaksuar të papunësisë dhe si rrjedhojë edhe e përkufizimit të relaksuar të fuqisë punëtore. Personat e papunë të dekurajuar u vlerësuan të ishin rreth 63 mijë (25 mijë meshkuj dhe 38 mijë femra) ose 4.5% të fuqisë punëtore (3.2 meshkuj, 6.0 femra). Prania e tyre ishte më e madhe në numër në zonat urbane. Ato zinin 9.3% të forcave të punës ndërsa në zonat jashtë Tiranës 5.4%. Personat më të dekurajuar, pa arsimin e duhur janë të papunët (8.4%), por kjo gjendje është e pranishme me 1.5% edhe mes personave me një diplomë universitare. Kur kryhet analiza sipas fuqisë punëtore (Graph 3.1), kuptojmë se papunësia e dekurajuar ishte e përhapur mes të rinjve të të dy gjinive dhe mes femrave të moshës mesatare, të cilat ndoshta do të donin të ri hynin në tregun e punës pas detyrimeve familjare, por e shikonin të pamundur të gjenin një punë për shkak të kualifikimit të ulët, apo edhe gjendjes së përgjithshme në tregun lokal të punës.

Grafiku 3.1 - Koefficienti i papunësisë të dekurajuar sipas seksit dhe grupmoshës: Shqipëria, 2002



Burimi: Llogaritje në bazë të të dhënave të LSMS 2002

5. Komponentët e papunësisë dhe sjellja

Dyshimi për numrin e madh të personave të dekurajuar mes femrave në Shqipëri dhe zonat e tjera urbane, vjen gjithashtu nga kuota e ulët e atyre që kërkojnë punë për herë të parë në pjesën që u takon femrave të papuna mes

i) atyre që kërkojnë një punë të re pasi e kanë humbur të parën dhe

ii) ndoshta të rinjtë që hyjnë në tregun e punës duke kërkuar për punën e tyre të parë (Tabela 3.10). Në kryeqytet dhe qytete të tjera, papunësia femërore duket se vjen kryesisht nga humbja e punës së parë, që sigurisht ndodhi për shkak të mbylljes së shumë ndërmarrjeve shtetërore dhe zvogëlimi i personelit të administratës shtetërore dhe shërbime.

Në zonat rurale, si meshkujt edhe femrat që kërkojnë punë për herë të parë, janë rreth 30% të totalit të personave të papunë, të cilët, janë të paktë në numër (rreth 15% të fuqisë punëtore). Siç edhe ndodh shpesh, në bujqësi dhe veçanërisht atë pjesë të shpërndarë në zonat rurale të Shqipërisë, vështirë se e gjen papunësinë mes personave që janë të angazhuar në këto punë në mënyrë permanente cilido qoftë angazhimi i tyre. Të rinjtë, në të kundërt, të cilët nuk janë ende të angazhuar në aktivitetet e fermës, kërkojnë, apo më mirë ëndërrojnë për një punë tjetër, duke e përcaktuar kështu veten si kërkues për herë të parë.

Por kur pyetet për gjendjen e tyre ekonomike – siç edhe bëri SMSJ – një pjesë prej tyre, sidomos femrat, shfaqen si të punësuar në bujqësi.


Përmes SMSJ së 2002, bëhet e mundur të dimë cilat janë rrugët që janë përdorur për të kërkuar punë (Grafiku 3.2). Kërkimi për punë me miqtë e të afërmit, mbizotëron si zonat urbane të Tiranës dhe në fshatra, duke ndriçuar lidhjet e punës bazuar kryesisht mbi prezantimet personale. Zyrat e Punës janë të besueshme vetëm në zonat urbane ndryshe nga kryeqyteti, ku ky besim është i vogël.

Tabela 3.10 - Të papunët sipas gjinisë, vendbanimit dhe statusit: 2001

Gjinia / Zona	Në mijë			Në përqindje		
	Në kërkim të punë së parë	Në kërkim të një punë re	Gjithsej	Në kërkim të punë së parë	Në kërkim të një punë re	Gjithsej
Meshkuj						
Tirana urbane	3	15	18	18.7	81.3	100
Të tjera urbane	13	42	56	24.1	75.9	100
Rurale	23	53	76	30.2	69.8	100
Vendi	40	110	150	26.5	73.5	100
Femra						
Tirana urbane	3	22	25	10.6	89.4	100
Të tjera urbane	12	78	91	13.5	86.5	100
Rurale	12	28	40	29.8	70.2	100
Vendi	27	129	155	17.2	82.8	100
Gjithsej						
Tirana urbane	6	37	43	14	86	100
Të tjera urbane	26	121	146	17.5	82.5	100
Rurale	35	81	116	30.1	69.9	100
Vendi	67	239	306	21.8	78.2	100

Burimi: Përpunime të të dhënave të regjistrimit të popullsisë dhe banesave 2001

Grafiku 3.2 - Të punësuarit sipas vendbanimit dhe mënyrës së kërkimit të punës: 2002



Burimi: Llogaritje në bazë të të dhënave të LSMS 2002



6. Popullsia inaktive adulte

Me qëllim plotësimin e këtij studimi, do të merret në konsideratë edhe popullsia inaktive adulte (15 vjeç e lart) (Tabela 3.11). Megjithatë, ky studim do të përfshijë si popullsinë e re që po pasuron kapitalin njerëzor para hyrjes në tregun e punës por edhe më të vjetrit që kanë dalë në pension duke lënë aktivitetin e tyre të mëparshëm të punës. Edhe feramat shtëpiake mund të konsiderohen si prodhues të sistemit riprodhues të jetës, si në jetën e përditshme ashtu edhe sa i takon trashëgimtarëve. Një pjesë e tyre mund të konsiderohet edhe si furnizim “i qetë” pune në rastin e zhvillimit ekonomik.

Duke i parë këto të dhëna në perspektivë, pa marrë në konsideratë personat e paaftë, mund të vlerësojmë një potencial punëtor prej rreth 400 mijë persona të rritur në vend, 1/3 e të cilëve ishin ende në studime.

Gjithashtu nga një pikëpamje cilësore, një numër i konsiderueshëm i adultëve jo aktivë janë studentë: kuota e tyre në popullsinë 15-24 vjeç është 21% për meshkujt dhe 22% për femrat.

Studentët që punojnë sipas studimit të vitit 2002

Të dhënat e studimit të MSJ të vitit 2002 tregojnë se nga numri i përgjithshëm i personave nga 15-24 vjeç që raportonin se ndiqnin shkollën, 9.2% kishin punuar gjatë javës së fundit para intervistës dhe një tjetër 8.2% deklaruan se kishin punuar për ca kohë gjatë 12 muajve të fundit.

Nga ata studentë që punojnë, 52.4% janë meshkuj dhe 47.6% janë femra. Duket se pjesa më e madhe e tyre jetojnë në zonat rurale të vendit – 82.7%. Kjo shpjegon se 81% kryejnë aktivitete bujqësore. Përmendet gjithashtu se 4.5% punonin në tregëti dhe 3.5% në hotele dhe restorante.

Në anën e kundërt të shkallës së moshës, gjejmë se rreth 90% e të rriturve (60 vjeç e më lart) meshkujt që u deklaruan si pensionistë në regjistrimin e 2001, ndërsa e njëjta gjendje u deklarua për 84% të femrave 55 vjeç e lart.

7. Punësimi sipas degës së aktivitetit ekonomik

Gjendja e tregut të punës në Shqipëri nuk mund të kuptohet nëse nuk kuptojmë se gjysma e fuqisë puntore, le të themi 530 mijë punëtorë, ende punojnë në bujqësi. Kjo vjen plotësisht nga e kaluara, ku në regjistrimin e 1989 rreth 800 mijë puntorë, 55% e popullsisë së përgjithshme të punësuar, u vëzhguan si të punësuar në bujqësi (shiko kutinë përkatëse). Rëniat e 1989-2001 ndikuan shumë më pak punëtorët meshkuj se ato femra, që ishin thuajse përgjysmuar.

Por rënia më e madhe ndodhi me fuqinë puntore të angazhuar në industri, që ishte ulur me 1/2 për meshkujt dhe 2/3 për femrat, kështu që sektori i industrisë punësonte vetëm 1/7 e fuqisë puntore të 2001 krahasuar me më shumë se 1/5 të 1989. Vetëm sektori i shërbimeve e rriti lehtë numrin e punonjësve

Tabela 3.11 - Popullsia^(a) jo aktive sipas gjinise dhe statusit: Shqipëria, 2001

Statusi i joaktivëve	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Në mijë			
Student	64	75	139
Ushtar	8	-	8
Shtëpiak		250	250
Jo në kërkim të një pune	15	18	33
Pensionistë	169	201	370
Të tjerë inaktivë	14	10	25
Gjithsej	269	554	823
Në përqindje			
Student	23.7	13.5	16.9
Ushtar	2.8	-	0.9
Shtëpiak	-	45.1	30.3
Jo në kërkim të një pune	5.5	3.3	4
Pensionistë	62.6	36.3	44.9
Të tjerë inaktivë	5.4	1.8	3
Gjithsej	100	100	100

Burimi: përpunimi i të dhënave të regjistrimit 2001.

^(a) Popullsia mbi 15 vjeç

Bujqësia në Shqipëri: Nga kolektivizmi në shpërndarjen e tokës

Para 1990, bazuar në fuqinë e legjislacionit, personat në moshë pune që jetonin në zonat rurale ishin pjestarë të kooperativave bujqësore. Ata ishin të detyruar të realizonin një numër ditësh pune, që ishte më shumë se $\frac{3}{4}$ e numrit të përgjithshëm të ditëve në vit. Lëvizja e njerëzve nga zonat rurale drejt atyre urbane ishte e centralizuar dhe thuajse e pamundur. Ishte e ndaluar me ligj të punoje në një punë të dytë. Kështu, në një mënyrë, personat që jetonin në zonat rurale ishin të detyruar të punonin në kooperativat bujqësore.

Në krahun tjetër, qeveria duke qene e paaftë të krijojë vende të reja pune në qytete dhe për të treguar se në Shqipëri të gjithë ishin të punësuar, miratonte ligje që aprovonin ligje që detyronin një pjesë të kosniderueshme të popullsisë në moshë pune të punoni në të ashtuquajturat “ndërmarrje bujqësore”, sidomos nëse kishin jetuar në qytete të vogla.

Duke e konsideruar bujqësinë si “çështje të gjithë popullit”, gati çdo të dielë, personat që punonin në degë të tjera, organizoheshin për të ndihmuar në bujqësi. Edhe nxënësit, studentët. Veçanërisht gjatë pushimeve të shkollës, punonin për një farë kohe në kooperativat apo ndërmarrjet bujqësore. Kështu, qëllimi ishte: askush nuk duhej të mbetej papunë, ciladio të ishte efikasiteti i tij. Kjo ishte arsyeja që megjithë që 55% e të punësuarve në bujqësi, nuk ishte e mundur të plotësoheshin kërkesat e vendit me produkte bujqësore dhe blegtorale.

Me ligjin “Mbi Tokën” Nr. 7501 të 1991 toka bujqësore e secilit fshat iu shpërnda familjeve që jetonin në fshat, sipas numrit të anëtarëve të familjes. Kështu, ndryshoi edhe pronësia mbi tokën dhe bashkë me të edhe mënyra e organizimit dhe kultivimit të saj. Toka ndahej në ngastra të vogla dhe kultivohej nga anëtarët e familjes.

Situata e ndryshme sipas rretheve dhe zonave të vendit, veçanërisht në zonën veriore të vendit, sipërfaqja e tokës së punësuar është e kufizuar duke influencuar punësimin tek popullsia në moshë pune, duke i detyruar ata të emigrojnë drejt qendrës apo bregdetit të vendit. Në anën tjetër, një sasi toke e konsiderueshme bujqësore rreth 150 mijë ha, që kultivohej para viteve 1990, refuzohet nga familjet në zonat rurale me pretendimin se janë toka jo produktive. Megjithëse sipas Ligjit mbi “Tokën dhe Privatizimin” familjet që banojnë në zonat rurale kanë tokë, në të vërtetë ato nuk e ndiejnë veten pronarë të saj dhe nuk investojnë, sepse pronarët e vjetër pretendojnë pronësinë. Pra një nga tiparet është edhe mungesa e investimeve, si dhe mundësitë e kufizuara të bankave për të dhënë kredi për investime.

Ka ndodhur gjithashtu një ndryshim edhe në strukturën e prodhimeve bujqësore që kultivohen: shumë prodhime si pambuku, duhani, kallam sheqeri, orizi, luledielli etj, që në 1990 kultivoheshin në 70 mijë hektarë, sot nuk kultivohen më. Deri në 90', prodhimi bujqësor ishte bazuar në aktivitetin e rreth 700 mijë kooperativave dhe ndërmarrjeve bujqësore. Në mbështetje të tyre u krijuan një numër ndërmarrjesh shtetërore si SMT, ndërmarrjet e ujrave etj. Sipas planit të shtetit, këto organizma ishin të detyruar të kultivonin një numër prodhimesh bujqësore, pavarisht kushteve klimaterike apo të tokës, përfitimit të traditës apo atij ekonomik.

Rënia e ekonomisë së centralizuar pas 90'u shoqërua edhe me rënien e shpejtë të prodhimit bujqësor me rreth 25-30%. Megjithëse ai pësoi rritje pas 92', ai është aktualisht nën nivelet e vitit 1989. Gjatë kësaj periudhe u prenë 6 milion pemë frutore, 2 milion rrënjë ullinj, 700 mijë pemë limoni/portokalle, si dhe u shkatërruan 13 mijë ha vreshta. Kjo ka shkaktuar rënien e prodhimit, si edhe importin e frutave thuajse gjatë gjithë periudhës së vitit. Në vitin 2000, prodhimi i grurit ishte 272 ton më pak se në 1989, i duhanit 8 ton më pak se në 1989, i lulediellit 21 ton, i kallam sheqerit 220 ton dhe i pambukut 14 ton. Ndërkohë, prodhimi i patateve, perimeve, qumështit dhe vezëve është rritur.



Që prej 1991 si rezultat i zbatimit të ligjit "Për Tokën", struktura e bujqësisë ka ndryshuar. Në vend të njësisve të mëdha të prodhimit bujqësor, tani karreth 400 mijë njësi ekonomike private bujqësore. Për të njohur më mirë gjendjen e bujqësisë në vitin 1998 INSTAT kreu regjistrimin e parë bujqësor në vend. Disa nga rezultatet në lidhje me këtë strukturë të njësisve ekonomike bujqësore janë si vijon:

-Ato kanë një madhësi të kufizuar rreth 1.2 ha. Në zonën verilindore të vendit, madhëia mesatare është 0.4-0.6 ha, ndërsa në zonën perëndimore është 2-3 herë më e lartë.

-Vetëm ½ e njësisve ekonomike prodhojnë gjithashtu për tregun, kryesisht perime, qumështi, vezët, por në sasi të kufizuara.

-Pjesa më e madhe e tyre kultivojnë 6-7 produkte si grurë, patate, perime etj. Kjo mund të shpjegohet me faktin se thuajse gjithë njësitë ekonomike përmbushin nevojat e tyre për prodhime bujqësore dhe blegtorale.

-Niveli i mekanizimit është i ulët. Thuajse në gjysmën e njësisve ekonomike bujqësore toka punohet me krahë apo me kafshë.

-Megjithëse sipërfaqja e tokës bujqësore është e kufizuar, njësia ekonomike ka 3-5 ngastra të ndryshme.

Njësitë ekonomike bujqësore veprojnë mbi bazë familjare dhe kanë si qëllim kryesorë konsumin vetjak të prodhimeve bujqësore e blegtorale.

Megjithëse në Shqipëri 50% e të punësuarve punojnë në bujqësi, kjo degë deri në vitin 2000 përbën vetëm 35% të GDP-së në shkallë kombëtare.

të vet, aktualisht vetëm meshkuj, meqë femrat të zëna me këto aktivitete mbetën konstante në numër, megjithatë më shumë se gjysma u dyfishuan në %.

Vendndodhja më e përhapur e këtyre aktiviteteve është e qartë kur zonat urbane të Tiranës, krahasohen me zona të tjera urbane dhe rurale (Tabela 3.12). Shërbimet mbizotërojnë në kontekstin urban ndërsa industria punëson një kuotë më të lartë (deri 30%) në qytete ndryshe nga kryeqyteti. Meqë ato përfshijnë disa ish qendra industriale si Durres, Vlore, Delvine, etj., mund të argumentojmë se ose ka mbetur një strukturë industriale, ose kanë filluar inisiativa të reja në manufakturë apo artizanat gjithashtu të bazuara mbi një mjedis ekzistues.

Dobësimi i strukturës industriale në vend konfirmohet edhe nga fakti se më pak se 5% e punonjësve janë të punësuar në degën e

"Prodhimit" (Tabela 3.13). Për çudi, ka një numër më të lartë për femrat se meshkujt në Tiranë dhe mjedise të tjera. Dega e ndërtimit mbizotëron mes fuqisë puntore të meshkujve në zonat urbane në ndryshim nga kryeqyteti, ku ndoshta po zhvillohet edhe procesi më intensiv i ndërtimit të shëpive, si pasojë e procesit të urbanizimit.

Në zonat urbane, përfshi Tiranën, rreth ¼ e fuqisë puntore është e punësuar në tregëtinë me shumicë dhe pakicë, duke zbuluar kështu si rolin që qytetet ende luajnë sa i takon zonave rurale fqinje dhe ndoshta – super dimensionimin e kësaj dege pas krizës industriale. Gjithashtu dega e "Transport, magazinim dhe komunikimit" punëson një kuotë të rëndësishme të fuqisë puntore të meshkujve rezidente në zonat urbane, ndërsa në po ato zona "Arsimi" dhe "Puna Shëndetsore e Sociale" punësojnë një kuotë

Tabela 3.12 - Të punësuarit sipas gjinisë, vendodhjes dhe aktivitetit ekonomik: 2001

Gjinia/Zona	Bujqësi	Industri	Shërbime	Gjithsej
Në mijë				
Meshkuj				
Tirana urbane	...	17	58	75
Të tjera urbane	5	56	127	188
Rurale	310	28	49	387
Vendi	315	101	234	650
Femra				
Tirana urbane	...	9	38	48
Të tjera urbane	3	28	78	109
Rurale	209	5	22	236
Vendi	212	42	138	392
Gjithsej				
Tirana urbane	...	26	96	122
Të tjera urbane	7	84	205	297
Rurale	519	32	71	623
Vendi	527	142	372	1,042
Në (%)				
Meshkuj				
Tirana urbane	0.2	22.4	77.4	100
Të tjera urbane	2.5	29.8	67.6	100
Rurale	80.2	7.2	12.7	100
Vendi	48.5	15.5	36	100
Femra				
Tirana urbane	0.1	19.5	80.4	100
Të tjera urbane	2.5	25.6	71.9	100
Rurale	88.7	2	9.3	100
Vendi	54	10.7	35.3	100
Gjithsej				
Tirana urbane	0.2	21.3	78.6	100
Të tjera urbane	2.5	28.3	69.2	100
Rurale	83.4	5.2	11.4	100
Vendi	50.6	13.7	35.7	100

Burimi: përpunimi i të dhënave të regjistrimit 2001.

... < 500 njësi

Tabela 3.13 - Të punësuarit sipas gjinisë, vendodhjes dhe aktivitetit kryesor ekonomik: 2001

Gjinia/Zona	gjuetia,	dhe	Prodhimi	elektrike,	Ndërtimi	me shumicë	dhe	magazini	Arsimi	dhe	shërbime	Gjithsej
Meshkuj												
Tirana urbane	0.2	0.18	10.7	1.84	9.7	29.37	9.39	12	3.84	2.05	20.73	100
Të tjera urbane	2.54	2.36	7.36	3.09	17.03	25.83	8.13	14.47	5.37	2.42	11.4	100
Rurale	80.18	0.73	1.86	1.23	3.33	3.25	0.96	2.98	1.88	0.37	3.23	100
Vendi	48.51	1.14	4.47	1.84	8.03	12.79	4	7.35	3.12	1.16	7.6	100
Femra												
Tirana urbane	0.1	0.09	14.46	1.16	3.79	22.46	8.92	8.29	11.08	9.39	20.26	100
Të tjera urbane	2.48	0.95	11.4	1.59	11.68	20.83	7.23	9.47	15.75	9.81	8.82	100
Rurale	88.67	0.07	1.02	0.09	0.84	1.96	0.69	0.79	3.53	1.66	0.68	100
Vendi	54.02	0.32	5.53	0.63	4.2	9.68	3.5	4.1	7.83	4.86	5.32	100
Gjithsej												
Tirana urbane	0.16	0.15	12.17	1.57	7.39	26.67	9.2	10.56	6.67	4.91	20.55	100
Të tjera urbane	2.52	1.84	8.84	2.54	15.07	24	7.8	12.64	9.17	5.12	10.45	100
Rurale	83.39	0.48	1.54	0.8	2.39	2.76	0.85	2.15	2.5	0.86	2.27	100
Vendi	50.58	0.83	4.87	1.39	6.59	11.62	3.81	6.13	4.89	2.55	6.74	100

Burimi: përpunimi i të dhënave të regjistrimit 2001.



të rëndësishme ët fuqisë punore femërore. Së fundi, përqindja e rëndësishme femërore e mashkullore e të punësuarve në “Shërbime të tjera” në Tiranë (rreth 20%) varet kryesisht nga numri i punonjësve të administratës publike në kryeqytet.

8. Papunësia sipas statusit

Situata dhe mënyrat në të cilat kryhet aktiviteti i punës janë të rëndësishme si nga pikëpamja ekonomike për shkak se dëshmojnë për kompleksitetin e strukturës ekonomike të vendit, si dhe për shkak të pikëpamjes së aktivitetit në perspektivë, meqë ata e vendosën angazhimin “për puntorët” mbi kativitetin e punës. Analiza e mëposhtme do të merret me shqyrtimin e statusit të punësimit dhe në një moment të dytë me gjendjen e punës të raportuar nga regjistrimi i vitit 2001. Shkalla përkatëse, përveç krahasimit të zakonshëm territorial, do të kontrollohet gjithmonë nga sektori ekonomik për shkak të strukturës shumë të ndryshme të fuqisë puntoare të angazhuar në tre sektorë të ndryshëm.

Sa i takon statusit të punësimit, duke ditur se në zonat rurale rreth 90% e personave të punësuar janë ose “Puntorë për llogari të tyre”, ose “Puntorë kontribues familjarë” (të fundit kryesisht gra) në zonat urbane statusi i strukturës së punësimit është gati “modern”, në qytetin e Tiranës me gati 2/3 e punëtorëve

Tabela 3.14 - Të punësuarit sipas gjinisë, vendodhjes dhe statusit: 2001


(% e statusit të punësimit)

Gjinia/Zona	Të punësuarit	Punëdhënës	Të vetpunësuar	Ndihmës në familje	Gjithsej
Meshkuj					
Tirana urbane	63.6	12.4	15.5	8.5	100
Të tjera urbane	57.1	13.7	18.3	11	100
Rurale	11.6	1.6	70.8	16	100
Vendi	30.7	6.3	49.2	13.7	100
Femra					
Tirana urbane	75.6	8.2	8.7	7.5	100
Të tjera urbane	67.8	9.7	12.6	9.8	100
Rurale	8	0.9	67.2	23.9	100
Vendi	32.8	4.2	45	18	100
Gjithsej					
Tirana urbane	68.3	10.8	12.8	8.1	100
Të tjera urbane	61	12.2	16.2	10.5	100
Rurale	10.2	1.3	69.4	19	100
Vendi	31.5	5.5	47.6	15.3	100


Burimi: përpunimi i të dhënave të regjistrimit 2001.

Grafiku 3.3 - Të punësuar sipas gjinisë, sektorit ekonomik dhe statusit të punës: Shqipëria 2001

Meshkuj



Femra



Burimi: Llogaritje në bazë të të dhënave të Regjistrimit të Popullsisë 2001

në vartësi dhe pak a shumë 10%, që raportuan se ishin punëmarrësit. Ndoshta, disa prej tyre ishin vetëm puntorë për llogari të vetën, nëse ka disa vartës të kontributorëve familjarë. Në fakt kuota e puntorëve për “llogari të tyre” duket të jetë më i vogël në ekonomitë pak të përhapura, që ende i mungojnë njësitë e mëdha prodhuese apo të shërbimit.

Kur e analiojmë sipas industrisë, (Grafiku 3.3), statusi i punës konfirmon organizimin e prapambetur të bujqësisë shqiptare, që është thuajse e gjitha e bazuar mbi punëtorët që punojnë për llogari të tyre dhe kontribuesit familjarë. Dy sektorët e tjerë tregojnë një shpërndarje të ngjashme ku mbizotërojnë punonjësit, megjithëse jo më jo më shumë se 2/3 e fuqisë puntore. Kjo nuk është shumë e ndryshme duke krahasuar meshkujt me feramat, nisur nga fakti që të parët e deklaruan veten si puntorë më vehte në një proporcion më të lartë kudo tjetër, ndërsa vërehej një kuotë më e lartë e puntorëve kontribues familjarë që punojnë në bujqësi.

9. Punësimi sipas kushteve të punës

9.1 Lloji i kontratës së punës

Dy të tretat e puntorëve raportuan se ata kishin një punë permanente, si meshkuj e femra gati njësoj. (Tabela 3.15). Vetëm në kontekstin rural kuota e punëve sezonale arriti ¼ e fuqisë puntore që punonte atje. Prania e punëve të rastit ishte ekufizuar dhe gati e njëjtë në kontekstin urban dhe rural. Mund të dyshojmë se punët e përkohshme të raportuara në qytetin e Tiranës dhe zonat e tjera urbane, veçanërisht për meshkujt, ishin punë të rastit, the të intervistuarit përgjigjeshin gjatë regjistrimit se nuk e kuptonin ndryshimin mes tyre.

Tabela 3.15 - Të punësuarit sipas gjinisë, vendodhjes dhe llojit të kontratës së punës: (% e ndarjes sipas kontratës së punës)

Gjinia/Zona	Punë e përhershme	Punë e përkoheshme	Punë sezonale	Punë e rastit	Gjithsej
Meshkuj					
Tirana urbane	70.8	18.1	6.1	5	100
Të tjera urbane	70.6	15.5	8.5	5.3	100
Rurale	61.1	8.8	25.8	4.2	100
Vendi	65	11.8	18.6	4.6	100
Femra					
Tirana urbane	78.1	14.3	4.9	2.7	100
Të tjera urbane	76.8	13.1	6.9	3.2	100
Rurale	61.6	7.5	26.9	4	100
Vendi	67.8	9.9	18.7	3.6	100
Gjithsej					
Tirana urbane	73.7	16.6	5.6	4.1	100
Të tjera urbane	72.9	14.6	7.9	4.6	100
Rurale	61.3	8.3	26.2	4.2	100
Vendi	66	11.1	18.6	4.3	100

Burimi: përpunimi i të dhënave të regjistrimit 2001.

Bujqësia punësonte 60% të puntëtorëve të vet dhe 30% në mënyrë sezonale. (Grafiku 3.4). Punët permanente ishin më të përhapura në manifakturë dhe madje më shumë në sektorin e shërbimeve, me puntoret femra në kuotën më të lartë – deri 80% në shërbime. Nëse këto do të ishin kushtet e vërteta të punës sipas llojit të kontratës së punës, ne mund të gjykonim për tranzicionin drejt një strukture moderne pune të plotë dhe konstante, të paktën në sektorë të ndryshëm nga bujqësia. Aktualisht, duke njohur ekonominë informale të përhapur gjerë në vend, mbeten dyshime për kuotat e larta të puntorëve që e raportuan aktivitetin e tyre si permanent. Një pjesë e tyre mund ta kishte përcaktuar pozicionin e vet duke iu referuar më shumë aktiviteti ekonomik (punuesit e metaleve, tregëtar, punëtor transporti, etj.) se punësimin të tyre aktual.


9.2 Lloji i vendit të punës

Të njëjtat shenja (si edhe dyshime) vijnë nga përgjigjet mbi vendin ku kryhej aktiviteti i punës (Tabela 3.16). Në zonat rurale, ndeshej shpesh ferma që ishte gjithashtu edhe shtëpi (70% e puntorëve ishin meshkuj dhe 76%




Grafiku 3.4 -Të punësuar sipas gjinisë, sektorit ekonomik dhe llojit të kontratës së punës: Shqipëria 2001

Meshkuj



Femra



Burimi: Llogaritje në bazë të të dhënave të Regjistrimit të Popullsisë 2001

femra), duke dhënë kështu një tjetër element për të përcaktuar shumë prej aktiveve në bujqësi si një ekonomi që mbijetonte. Në zonat urbane dhe veçanërisht në qytetin e Tiranës, puntorët punonin kryesisht jashtë shtëpisë, në zona të caktuara: deri në 90% të femrave që punonin në Tiranë dhe 80% e meshkujve.

Vendodhja fermë, mbizotëronte mes fuqisë puntore në bujqësi: më shumë se 80% si për meshkujt edhe për femrat (Grafiku 3.5). Në dy sektorët e tjerë, nisur nga fakti që meshkujt kryejnë aktivitetet pune në një vend jo të fiksuar, më shumë se femrat (psh., puntorët e transportit, tregëtarë, etj.), dallohet qartë mbizotërimi i zonave të caktuara të ndryshme nga shtëpitë. Ka diçka të çuditshme në kuotën e ulët të puntorëve (deri në 15% mes puntoreve femra në manifakturë) që deklaruan se e kryenin aktivitetin e tyre në fermën që ishte shtëpia e tyre: në fakt, në një fazë të hershme të industrializimit, aktivitetet ekonomike të ndryshme nga bujqësia (psh, transformimi i ushqimeve dhe prodhimi i tyre, tekstilet, etj.) mund të kryhen në shtëpi, sidomos nga femrat që banojnë në fshat, të cilat e ndajnë këtë pjesë të aktivitetit të punës me ato të fermës dhe detyrimeve familjare.

Tabela 3.16 - Të punësuarit sipas gjinisë, vendodhjes dhe vendit të punës: 2001
(% e ndarjes sipas vendit të punës)


Gjinia/Zona	Vend i caktuar jashtë shtëpisë	Shtëpia (jo fermë)	Fermë, që është shtëpi	Jo një vend fiks	Gjithsej
Meshkuj					
Tirana urbane	80.5	0.1	5.8	13.6	100
Të tjera urbane	71.2	0.1	17.6	11.2	100
Rurale	18.4	0.3	70.4	10.8	100
Vendi	40.8	0.2	47.7	11.3	100
Femra					
Tirana urbane	89.7	0.1	4.6	5.7	100
Të tjera urbane	77.3	0.1	16	6.6	100
Rurale	13.7	0.3	76.4	9.7	100
Vendi	40.5	0.2	50.9	8.3	100
Gjithsej					
Tirana urbane	84.1	0.1	5.3	10.5	100
Të tjera urbane	73.4	0.1	17	9.5	100
Rurale	16.6	0.3	72.7	10.4	100
Vendi	40.7	0.2	48.9	10.2	100

Burimi: përpunimi i të dhënave të regjistrimit 2001.

9.3 Orët standarte të punës

Angazhimi ndaj punës mund gjithashtu të vlerësohej përmes orëve të punës gjatë një jave. Gajtë regjistrimit të 2001, u pyetën si të

Grafiku 3.5 - Të punësuar sipas gjinisë, sektorit ekonomik dhe llojit të punës: Shqipëria 2001



Burimi: Llogaritje në bazë të të dhënave të Regjistrimit të Popullsisë 2001

punësuarit për orët e tyre të punës edhe cilido nga 1 vjeç e lart për orët që kishin punuar në punë të paguar në javën para se të fillonte vëzhgimi. Duke marrë në konsideratë vetëm të punësuarit, përdorëm përgjigjen e tyre të parë për t’i klasifikuar sipas kohëzgjatjes së orëve të punës. (ne përmirësuam vetëm përgjigjen e dytë në rast të mos përgjigjes, apo përgjigjes me zero për pyetjen e parë).

Duke ndjekur rekomandimet ndërkombëtare (ILO 1990, OECD 1997) ne përcaktuam aktivitetet e plota ato me 35 apo më shumë orë pune në javë, “pjeshme për kohë të gjatë” me orë pune nga 15 në 34 orë në javë dhe “të pjeshme për kohë të shkurtër” me kohë pune prej më pak se 15 orë në javë.

Në tabelën 3.17 vëmë re se vetëm pak më shumë se 1.5 persona ishin në punë të plotë, shifër pak më e lartë për meshkujt (54%) se femrat (50%). Vetëm në qytetin e Tiranës kishim shifra më të larta, sidomos për puntoret femra (69.5%). Në pjesën tjetër të vendit, një pjesë e madhe e të punësuarve deklaruan se një orë pune klasifikohet si pune e pjeshme e gjatë. Ky fakt mund të pranohej sa i takon

aktiviteteve rurale (Grafiku 3.6), si për angazhimet e zvogëluara që një bujqësi që mbijeton kërkon, edhe për stinën – Prill, pranvera e hershme, kur aktivitetet në fusha janë të kufizuara – kur u krye regjistrimi. Në fakt, puna e pjeshme e shkurtër, përdoret

Tabela 3.17 - Të punësuarit sipas gjinisë, vendodhjes dhe orëve të zakonshme të punës: 2001

(% e ndarjes sipas orëve të punës)

Gjinia/Zona	Kohë e plotë	Kohë e pjeshme e gjatë (a)	Kohë e pjeshme e shkurtër (b)	Gjithsej
Meshkuj				
Tirana urbane	66.6	32.7	0.7	100
Të tjera urbane	55.8	43.4	0.8	100
Rurale	50.6	41.6	7.9	100
Vendi	53.9	41.1	5	100
Femra				
Tirana urbane	69.5	29.8	0.7	100
Të tjera urbane	57.8	41.4	0.8	100
Rurale	42.2	48	9.8	100
Vendi	49.8	44	6.2	100
Gjithsej				
Tirana urbane	67.7	31.6	0.7	100
Të tjera urbane	56.5	42.7	0.8	100
Rurale	47.4	44	8.6	100
Vendi	52.4	42.2	5.5	100

Burimi: përpunimi i të dhënave të regjistrimit 2001.


(a) më pak se 15 orë në javë

(b) 15-34 orë në javë




Grafiku 3.6 - Të punësuar sipas gjinisë, sektorit ekonomik dhe orëve të zakonshme të punës: Shqipëria 2001

Meshkuj



Femra



(a) më pak se 15 orë në javë

(b) 15-34 orë në javë

Burimi: Llogaritje në bazë të të dhënave të Regjistrimit të Popullsisë 2001

gati gjithmonë nga puntoret femra në bujqësi. Për sektorët e tjerë, fakti se më shumë se 40% e punës së puntorit mes 15 dhe 34 orë në javë, dëshmon për shpejtësinë e kufizuar me të cilën po përparon ekonomia shqiptare, ende në mbijetesë.

10. Puna e dytë

Punët sekondare janë kryesisht të përhapura në ekonomi ku, duke qenë se punësimi kryesor i qendrueshëm është i pamjaftueshëm për nevojat apo dëshirat e punëtorëve, ai/a jo sakrifikon pjesë të kohës së tij/saj të lirë në kryerjen e një tjetër aktiviteti pune, që ka apo jo lidhje me atë kryesoren. Punët dytësore zakonisht kryhen në mënyra të parregullta apo ekonomi informale. Një tjetër tip pune dytësore, më e rregullt, mund të jetë e pranishme aty ku fuqia puntore për degët moderne vjen nga njerëzit që ende jetojnë në fshat. Ata shpesh përdorin kohën e tyre të lirë për të përmbushur aktivitete pune rurale në fermën ku ata jetojnë. Edhe në zonat urbane, punët e pjeshme mund të kryhen si punë

dytësore, veçanërisht në treëgti, rregullime të vogla, shërbime, të lidhura ose jo me punën kryesore.

Sipas të dhënave të studimit të MSJ të 2002, vetëm 5% të numri të përgjithshëm të popullsisë kryejnë një punë të dytë në Shqipëri. Për qindja është më e lartë mes meshkujve: 7% të meshkujve të punësuar kanë një punë të dytë, ndërsa vetëm 3% e femrave të punësuar janë në të njëjtën situatë. Analizat tregojnë se kur të punësuarit ishin edhe kryefamiljarë ata tentonin të kishin një punë të dytë më shumë se anëtarët e tjerë të famojes që janë të punësuar. Për qindja është gjithashtu më e lartë mes të punësuarve të moshës 40-44 vjeç dhe nes personave të punësuar që janë divorcuar/ndarë. Të punësuarit në zonat urbane kanë një punë të dytë vetëm në 3.1% të rasteve, ndërsa të punësuarit në zonat rurale në 6.4% të rasteve.

Një numër i tillë i ulët vjen pjesërisht si pasojë e shifrës së lartë të atyre që punojnë në bujqësi si puna bazë e shqiptarëve, sidomos në rastin e femrave: një bujqësi që mbijeton dhe një strukturë e vogël fermash që japin

pak hapsirë për punësimin paralel në një ambient i cili për më tepër është edhe i prapambetur. Shifra e lartë e papunësisë mund të jetë edhe një, meqë shumë persona nuk kanë as edhe një punë kryesore.


Të dhënat sipas statusit të punësimit në punën dytësore tregojnë se pjesa më e madhe e tyre, 78%, janë të vet punësuar apo puntorë të papaguar familjarë; puntorët përbëjnë vetëm 22 %. Pjesa më e madhe e tyre janë të angazhuar në aktivitetet bujqësore (Grafiku 3.7).

11. Konkluzione

Situata e tregut të punës së Shqipërisë përshkruar nga të dhënat e regjistrimit të vitit 2001 dhe studimit të MSJ 2002, është sinqerisht shqetësues: nga 2,170 mijë persona mbi 15 vjeç, vetëm 1,042 mijë ishin të punësuar (48%), me 306 mijë të papunë (14%) dhe atyre që kërkojnë punë, si dhe 823 mijë jo aktivë (38%), nga të cilët të paktën 250 mijë (11.5% nga 15+ vjeç e popullsisë) duhet konsideruar si potencial pune, këtu nuk përfshihen studentët e rritur, pensionistët dhe të paafëtët, si dhe shtëpiakët në moshë të madhe. Kështu, përballë një numri prej më shumë se 1,600 mijë puntorësh potencialë, të ndarë në mënyrë të barabartë sipas gjinisë, kërkesa për punë ia doli të punësonte vetëm 2/3 apo më saktësisht katër në pesë meshkuj kundrejt më pak se gjysmës së numrit të femrave. Struktura ekonomike këtij punësimi ishte plotësisht e prapambetur, me më shumë se gjysmën e të punësuarve në bujqësi, më pak se 15% në industri dhe rreth 35% në sektorin e shërbimeve.

Në fakt, edhe kjo pamje është optimiste, meqë përcaktimi i aktiviteteve të punës si kërkesë për punë në bujqësi është iluziv. Puntorët ruralë janë zakonisht më pak të paguar dhe janë ata që në shumicën e rasteve prodhojnë

Grafiku 3.7 - Të punësuar me një punë të dytë sipas degës ekonomike: Shqipëria ;2002



Burimi: Llogaritje në bazë të të dhënave të LSMS 2002

më shumë për mbijetesën e tyre se për tregun. Deri në një farë mase kjo është e vërtetë edhe për disa nga personat e zonave urbane që punojnë në sektorin e shërbimeve, në ndërtim, tregëti, transport dhe komunikim, sektorë ku ka punë të pasigurta të rastësishme apo me angazhim të pjesshëm.

Si rrjedhojë, zemra e fuqisë puntore të punësuar në Shqipëri në regjistrimin e vitit 2001 – dmth ata që punonin në mënyrë të përhershme dhe me kohë të plotë – llogariteshin në rreth 550-700 mijë puntorë, shumë më pak se gjysma e potencialit të punës. Kjo bërthamë e fuqisë puntore formohej nga 350-430 mijë meshkuj dhe 200-270 mijë femra. Struktura sipas sektorit ekonomik të kësaj bërthame ishte pak më shumë “moderne”; numri i puntorëve në bujqësi po zbriste në rreth 40% të totalit, ndërsa të punësuarit në manifakturë ishin rreth 20% dhe ata në sektorin e shërbimeve rreth 40%.

Duke e krahasuar situatën me atë të regjistrimit të vitit 1989, që ishte pak para ndryshimeve të mëdha në regjimin politik dhe



ekonomik, dikush mund t'ia vishte krizën e pamohueshme që ka përjetuar punësimi, këtyre ndryshimeve dhe ngjarjeve pasuese dramatike deri në fund të viteve 90 në Shqipëri. Humbja e rreth 400 mijë vendeve të punës, dyfishimi i atyre që kërkonin punë, migrimi i jashtëm që shkaktoi edhe një ulje të numrit të popullsisë së meshkujve në moshë pune, janë padyshim pasoja të asaj çka ndodhur. Megjithatë, gjendja e përshkruar nga regjistrimi i vitit 1989 ishte shume fallco dhe në ndonjë rast i paarritshëm për një kohë të gjatë, siç edhe është provuar nga lindja e një shifre të papunësisë jo më të mohueshme, si edhe nga një strukturë ekonomike thuajse plotësisht autarkike, kryesisht e bazuar në bujqësi.

Modernizimi i vendit dhe ekonomisë së tij, kishin nevojë për një përmbysje të tillë, dhe krizat e jetuara ishin ndoshta të pashmangshme. Problemi i vërtetë është se ky proces ka zgjatur për më shumë se 10 vjet dhe se gjendja e përshkruar nga regjistrimi i vitit 2001 dhe studimi i MSJ 2002, është larg nga kapërcimi i tranzicionit në një ekonomi moderne të regut të lirë. Për të ardhmen, mund të parashikojmë, një largim të mëtejshëm nga bujqësia me të paktën 250 mijë puntorë përballë modernizimit të këtij sektori dhe braktisjes së tokave jo produktive. A do të jetë në gjendje vendi dhe ekonomia e tij në rritje të përballën me këtë lëvizje që do t'i shtohet numrit të rëndësishëm të atyre puntorëve (më shumë se 150 mijë në zonat urbane) që ishin në kërkim të punës pasi e kishin humbur të parën, ndoshta për shkak të mbylljes së fabrikave shtetërore apo dështimit të përpjekjeve ekonomike të investitorëve vendas e të huaj në vitet 90? Kërkesa për punë duhet të jetë në gjendje të thithë më shumë se 66 mijë kërkuesve të punës së parë dhe për të ofruar punësim të qëndrueshëm për rreth 140 mijë persona që punojnë përkohësisht, në mënyrë sezonale, apo rastësore në sektorët e inustrisë apo shërbimeve.

Sfida mund të duket e pakapërcyeshme dhe është e lehtë të parashikosh kriza ndoshta më të rënda e të mëtejshme do t'i vihen përballë tregut të punës në Shqipëri. Megjithatë, gjendja tregon gjithashtu edhe mundësi interesante për një zhvillim ekonomik të shpejtë. Ato janë të lidhura kryesisht me potencialin shumë të madh të popullsisë së re të këtij vendi sa i takon formimit të një fuqie puntore fleksibël, e cila falë gjithashtu edhe nivelit mjaft të mirë të nivelit arsimor, është në gjendje të përshatet me ndryshimet e nevojshme të sjtriturës ekonomike dhe mënyrës së punës. Sfida kryesore do të jetë të arrijë ta përdorë këtë potencial dhe prezantimit të iniciativave (psh, favorizimi dhe financimi i ngrtjes së ndërmarrjeve të reja në degët e frontit), më shumë se në përpjekjet për të plotësuar kërkesën shumë të madhe të pakënaqur për punë ërmes zgjidhjeve tradicionale (psh, përmes rritjes së numrit të shërbimit civil): Suksesi i këtyre iniciativave duhet të sjellë eventualisht një cikël virtuoz, i cili mund të thithte edhe një pjesë të burimit më tradicional të punës që tani është jo aktiv.

Aneksi 3.1

Fuqia puntore, punësimi dhe papunësia në rrethet shqiptare

Në faqet në vijim ne do të pasqyrojmë grafikë të komentuar shkurt, mbi disa viarabla të shqyrtuar në Kapitullin III. Këtu ata janë llogaritur në shkallë rrethi. Duke ndjekur the metodën e pëdorur në kapitullin që krahasonte Tiranën urbane me zona të tjera urbane e rurale, analiza e këtushme konsideron më së shumti vendodhjen e rretheve të ndryshme në vend pa prezantuar një alokacion strikt të grupeve gjeografike apo dallim të qartë të zonave urbane/rurale për secilin rreth.


Për qëllime statistikore dhe komunikimi, ne preferojmë t'i paraqesim grafikët jo sipas rendit alfabetik, por duke ndjekur rënien e variablit të prezantuar (apo më i rëndësishmi).

Kjo mund ta bëjë kërkimin e një rrethi më specifik më të vështirë për lexuesin. Megjithatë, pozicionimi në masën përkatëse të rretheve të Shqipërisë është më i thjeshtë, dhe me këtë qëllim ne përfshimë në listë edhe mesataren e vendit.

Lexuesi, mund të gjejë gjithashtu edhe disa të dhëna mbi fuqinë puntore në shkallë rrethi, apo edhe në nivel komune/bashkie, në disa harta të veçanta të Atlasit. Këto janë komentuar pjesërisht në tekst.

Në lidhje me strukturën e brendshme të popullsisë në moshë pune, zvogëlimi i ndjeshëm i të rinjve për çdo puntor të mundshëm të rritur në shkallë vendi, reflektohet në nivel rrethi. Rënia është e lartë (të paktën 1.0) për shumicën e rretheve të jugut, më pak domethënëse për veriun e vendit (edhe më pak se 0.3 në Kukës dhe Has). Në regjistrimin e 2001, vlerat e rretheve janë më të larta se ato kombëtare në

Grafiku 3A.1 - Struktura e brendshme dhe kohorti i të ardhurave e popullsisë në moshë pune, sipas rretheve: 1989 dhe 2001





20 nga 36 raste, shumica e rretheve që ndodhen në veri të vendit dhe që përfaqsojnë më shumë zonat rurale. Në krahun tjetër, rrethet që përfshijnë qytetet kryesore apo që ndodheshin në jug të vendit me një popullësi më intensive me vlera aktuale plakjeje nën 1.5 apo edhe 1.0 (Delvinë).

Për atë që i referohet të ardhurave të grupit, ndryshimi është domethënës për gjithë Shqipërinë me 21 rrethe me rënie relativisht më të larta.


Pjesmarrja e fuqisë punëtore përgjithësisht ka rënë në mënyrë të ndjeshme, por me ndryshime të mëdha sipas gjinisë. Për meshkujt, rëniet e kufizuara duket se vijnë si pasojë e strukturës së përgjithshme të zhvillimit të popullsisë. Por ndryshimet më të mëdha negative në jug, (Vlore, Kolonje, Sarande dhe Delvine) dhe veri (Malesi e Madhe) kontrastojnë 11 ndryshime pozitive në rrethet e qendrës dhe veriut si Peqin dhe Bulqize, sipas rendit.

Në krahun tjetër, sa i takon femrave nuk ka asnjë rritje. Në rang vendi pjesëmarrja e fuqisë punëtore në tregun e punës, rënia nga viti 1989 në 2001 është e fuqishme kudo, në shumë raste rreth 50% të popullsisë në moshë pune (Mallakaster, Devoll, Delvine, Tepelene dhe Sarande në jug, dhe kryesisht Diber dhe Malesi e Madhe në veri). Sipas rënies së fortë në zonat rurale, në vitin 2001 nivelet e rretheve me qytetet kryesore janë më të larta sesa mesatarja në shkallë vendi.


Krahasuar me pjesmarrjen e fuqisë punëtore, ndryshimi i punësimit është më domethënës: kudo në vend ka një rënie si për meshkujt edhe për femrat, por më të forta për të dytat në linjë me tendencat e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore.

Ndërmjet meshkujve, rrethet Dibër, Kukës, Malesi e Madhe, Pogradec, Delvine dhe Sarande prezantojnë një rënie prej rreth 25% të punësimit për popullsinë nga 15+.

Grafiku 3A.2 - Koefficienti i pjesmarrjes në krahun e punës sipas gjinisë dhe rrethit : 1989 dhe 2001



Grafiku 3A.3 - Koefficienti bruto i punësimit sipas gjinisë dhe rrethit : 1989 dhe 2001



Për femrat, të njëjtat rrethe si dhe për rrethet Tropojë, Has, Shkodër, Kurbin, Vlorë, Tepelenë, Kolonjë dhe Devoll ka një rënie prej të paktën 50%.

Situata femërore heterogjene tregohet gjithashtu edhe në 2001, kur vlerat e meshkujve janë jashtëzakonisht të përqendruara rreth vlerës kombëtare, ndërsa ato të femrave lëvizin nga 24.8% (Malesi e Madhe) në 50.7 (Skrapar).

Në shkallë kombëtare personat që kërkonin punë në % të fuqisë puntore janë dyfishuar në periudhën mes dy regjistrimeve të popullsisë. Vlerat u rritën me të paktën 3 herë në Shkoder, Puke, Has, Kukes, Diber (veri) si edhe në Pogradec, Skrapar, Gramsh, Permet dhe Kolonje (juglindje), si për meshkujt dhe për femrat (deri në mbi 5 herë në Diber për meshkujt dhe rreth 6 herë në Kukes për femrat), në Sarandë, Fier dhe Gjirokaster për meshkujt dhe në Mirdite për femrat. Rritjet më


të kufizuara u regjistruan në Lezhe (për meshkujt), Mallakaster (për femrat), Peqin dhe Kruje.

Në 2001 ndryshimet sipas gjinisë janë më relevante në Vlore, Durres, Shkoder dhe Kuçove (psh. 4 më shumë rrethe urbane përjasht Tiranën), ndërsa janë më të vogla në rrethet kufizuese si Librazhd, Lushnje dhe Devoll. Megjithatë, papunësia e femrave është më e ulët vetëm në dy rrethe: Bulqize (21.4% kundrejt 24.2 për meshkujt) dhe Diber (23.8 kundrejt 28.6).

Të punësuarit që kanë punën e parë dhe atyre që kërkojnë punë të re kanë një dallim të vet konsiderueshëm. Në shkallë vendi ata janë rreth 26 dhe 17% respektivisht për meshkuj dhe femra. Në shkallë rrethe, analiza bazohet në vlerat e papunësisë sipas përbërjes treguar në Grafikon 3A.5 së pari nxjerr në pah një grup prej 9 rrethesh në veri lindje të vendit (Tropojë, Has, Pukë, Dibër, Mirditë, Bulqizë,




Grafiku 3A.4 - Koefficienti i papunësisë sipas gjinisë dhe rrethit : 1989 dhe 2001



Librazhd) si edhe Kavajë dhe Devoll ku të paktën 25% mes të papunësve janë duke



Grafiku 3A.5 - Koefficienti i papunësisë sipas gjinisë, rrethit dhe përbërjes : 2001



kërkuar një punë të parë për të dy gjinistë. Përveç kësaj, është e mundur të dallohet një grup i dytë që përfshin rrethet Kukës, Mat, Elbasan, Fier, Kuçovë, Berat, Gramsh, Tepelenë dhe Kolonjë, ku vetëm vetëm ata meshkuj që kërkojnë për herë të parë i kalojnë të njëjtin kufi. Shifra e atyre që kërkojnë punë për herë të parë shkon nga 1-3% (Delvinë, për meshkuj dhe femra respektivisht) deri në më shumë se 40% (Has and Bulqizë, me e lartë për meshkujt). Megjithatë ka disa përjashtime në jug dhe qytetet kryesore që iu vihen përballë veriut.

Sa i takon llojit të punës, në përgjithësi ekziston dallim mes veriut dhe jugut. Zonat urbane janë mjaft të përqendruara, veçanërisht për meshkujt) rreth mesatares së shpërndarjes kombëtare. Në një mënyrë të përgjithshme, ndryshimet vijnë falë peshës së punës sezonale më shumë në zonat bujqësore, ku të punësuarit deklaruan se punonin vetëm në disa periudha të vitit. Fenomeni shfaqet në Peqin (me ndryshime të vogla gjinie), Bulqizë (por vetëm për femrat: 61.9% kundrejt 29.9) dhe kryesisht në Librazhd (me rreth 60% kundrejt rreth 30 për të dyja gjinitë), një nga rrethet më pak të urbanizuara.

Grafiku 3A.6 - Të punësuarit sipas gjinisë, rrethit dhe llojit të punës : 2001






Ndryshime domethënëse sipas gjinisë regjistrohen në rrethe të ndryshme si Kolonjë, Pogradec, Tiranë, Malësi e Madhe, Shkodër, Tropojë, Pukë, Mirditë dhe sigurisht në kryesisht në Bulqizë. Gjithashtu, Tiranë, Durrës dhe Kurbin, por edhe rrethi rural i Matit tregojnë nivele më të larta (rreth 15%) të puntorëve të përkohshëm.

Sipas evidencave nga të dhënat përmbledhëse në Tabelën 3.16, rrethet më të urbanizuara regjistrojnë kryesisht femra e meshkuj që punojnë në godina të përqendruara jashtë shëpisë, ndërsa ferma

që është gjithashtu edhe shtëpi, mbizotëron mes puntorëve të zonave rurale. Si pasojë e përqendrimit të punësimit në sektorin primar, vetëm në 8 apo 10 rrethet në grafikun 3A.7 e mësipërme numri i punëtorëve në godina fikse jashtë shtëpisë, e kalon e numrin e atyre që punojnë në fermat që janë në shtëpi. Vendet e punës të përhershme janë mbizotëruese në rrethet më urbane (Tirana, Durrës, Kurbin, Vlore) dhe ku puntorët janë duke u larguar nga bujqësia (rrethet e jugut si Gjirokaster). Një numër më i madh personash që punojnë nuk janë të fiksuar në godina, (edhe më shumë se 20%, si për Kukësin për meshkujt

Grafiku 3A.7 - Të punësuarit sipas gjinisë, rrethit dhe vendit të punës: 2001




dhe Hasit për femrat) paraqiten sipas rretheve në verilindje të Shqipërisë. Rrethet Bulqize, Devoll, Kavaje, Pogradec, Puke, Korçë janë rrethet me ndryshimet më relevante në shpërndarjen mes dy gjinive.

Kryesisht, rrethet më urbane dhe jugu paraqiten në krye të dy grafiqeve të mësipërme, ku mbizotëron puna e plotë. Ekzistojnë megjithatë përjashtime domethënëse si Shkoder dhe Kuçovë (që janë mes rretheve më urbane por shfaqen në fund) apo Puka.

Pozicionet ekstreme në grafiqe japin të paktën 2/3 e puntorëve më kohë të plotë në Skrapar dhe Tirane si edhe Permet, Sarandë, Delvine, Tepelene, Gramsh dhe Kruje (vetëm për meshkujt) kundrejt 1/3 vetëm në Berat, Bulqize dhe Lezhe (dy të fundit vetëm për femrat).

Gjetjet kryesore

- Ndërmjet viteve 1989 dhe 2001, popullsia në moshë pune (15-64vjeç) ka rënë në numrin absolut, por përqindja e totalit të popullsisë është rritur me 1.5% pikë. Në zonat urbane,





- Përqindja është më e lartë se në ato rurale, veçanërisht në qytetin e Tiranës, ku rreth 2/3 e popullsisë është në moshë pune. Megjithatë, krahasimi me regjistrimin e vitit 1989 tregon se popullsia nga 15-64 vjeç ka rënë në zonat urbane, ndërsa në shkallë vendi pati një rritje të lehtë.
- Koeficienti i vartësisë së përgjithshme demografike ka rënë krahasuar me atë të regjistrimit të vitit 1989: Në 2001, kishte 0.58 persona jo në moshë pune për një person në moshë pune, ndërsa në 1989 kishte 0.63. Ky koeficient është 0.49 në qytetin e Tiranës dhe 0.63 në zonat rurale, po lla ndryshime përkatëse sipas rretheve.
- Struktura e brendshme moshore e popullsisë në moshë pune (15-39vj / 40-64vj) tregon se në shkallë vendi, koeficienti është 1.5 persona të rinj në moshë pune për çdo puntor të munshëm të rritur dhe se ai është më i lartë në zonat rurale (1.8) se në ato urbane (1.3), duke treguar kështu një rritje të shpejtë të procesit të plakjes së fuqisë puntore në krahasim me regjistrimin e vitit 1989.
- Të adhurit në grupin e popullsisë në moshë pune (15-19vj / 60-64vj) tregojnë se në 1989 Shqipëria kishte 4 persona të grup moshës 15-19 për një person të grup moshës 60-64 dhe në 2001 ky koeficient pësoi rënie.
- Në vitin 1989, 75% e popullsisë 15 vjeç e lart ishte aktive, ndërsa në vitin 2001 e njëjta kuotë është 62.1 dhe masa e femrave jo aktive ishte dyfishuar (50.3 vs. 25.0 në 1989).
- Më pak se gjysma e (48 percent) popullsisë 15 vjeç e lart ishte deklaruar si e punësuar në regjistrimin e vitit 2001. Në zonat rurale kjo shifër është më e lartë (51%) se në qytetin e Tiranës (46 përqind) dhe në zonat e tjera urbane (43%). Ai është rreth 60% për meshkujt thuajse kudo, ndërsa për femrat vlera bruto e punësimit është ndërmjet 30 dhe 40% me vlerat më të ulta në zonat urbane ndryshe nga Tirana.
- Mes viteve 1989 dhe 2001, personat që kërkonin pune u dyfishuan në numër dhe në përqindje të fuqisë punëtore.
- Në Shqipëri, gjysma e fuqisë punëtore (530 mijë puntorë) mbetet e angazhuar në bujqësi që ka gjithashtu një rënie të krahasuar me regjistrimin e vitit 1989. Kjo rënie ka prekur më shumë puntoret femra se ata meshkuj. Rënia më e madhe ka prekur fuqinë puntore në industri, ndërsa shërbimet mbizotërojnë në kontekstin urban.
- Në zonat rurale, rreth 90% të të punësuarve janë "të vetë punësuar" apo "puntorë kontribues familjarë", ndërsa në zonat urbane, veçanërisht në qytetin e Tiranës, shumë deklaruan se ishin punëdhënës. 66% e puntprëve deklaruan se kishin një punë të përhershme; vetëm në kontekstin rural, kuota e punëve sezonale arrin ¼ e fuqisë puntore. Punësohen 60% të puntorëve në mënyrë të përhershme dhe 30% në mënyrë sezonale.
- Në zonat rurale, rreth 48.9% (70% për meshkujt dhe 76% për femrat që punojnë) kryesisht punojnë në një fermë që është edhe shtëpia e tyre, ndërsa në zonat urbane puntorët punojnë jashtë shtëpisë në godina fikse. Vetëm pak më shumë se 1.5 e të punësuarve, punojnë me kohë të plotë (54% për meshkujt dhe 50% për femrat), Por në qytetin e Tiranës kemi shifra më të larta, sidomos për puntoret femra (69.5%). Në pjesën tjetër të vendit, të punësuarit e klasifikonin punën e tyre si të pjesshme por me kohë të gjatë.
- Sipas të dhënave të studimit të MSJ 2002, vetëm 5% e numrit të përgjithshëm të të punësuarve kanë një punë të dytë, ku përqindja është më e lartë për meshkujt (7%). Këta janë zakonisht kryetarët e familjeve me 40-44 vjeç dhe të vetëpunësuarit apo puntorët e papaguar familjarë (78%) dhe janë angazhuar në aktivitetet e bujqësisë.

4

Faktorët demografikë dhe social ekonomikë që ndikojnë pjesëmarrjen e fuqisë puntore, punësimin dhe papunësinë

1. Hyrje

Qëllimi i këtij kapitulli është të përshkruajë lidhjet e mundshme mes pjesëmarrjes së fuqisë puntore, punësimin apo papunësinë, apo tipareve të familjes që mund të ndikojnë tek zgjedhjet dhe sjelljet sa i takon punës, si dhe tek suksesi apo dështimi në tregun e punës. Ky qëllim mund të duket kryesisht teorik, por njohja e saktë e mënyrës sipas të cilës në të cilën ndikohen variablat e punës nga karakteristikat individuale dhe familjare është me interes të jashtëzakonshëm për parashikimin e tendencave të ardhshme dhe në planifikimin e ndërhyrjeve për një përdorim më të mirë të potencialit të punës.

Së pari studiohen parametrat e gjinisë dhe moshës, duke u përpjekur për të dhënë perspektivën e rrugës së jetës për punën, siç janë të dhënat e regjistrimit. Më pas analiza shqyrton disa tipare individuale demografike (gjendja civile, pozicioni në familje në lidhje me personin e referencës në regjistrim dhe, për femrat e reja, numri i fëmijëve që kanë) edhe social ekonomikë, ku niveli i arsimit përdoret për vlerën e vet, por edhe si një zëvendësues i variablave të tjerë social ekonomike si klasa shoqërore apo shëndetësia, që nuk mund të vëzhgohen gjatë regjistrimit. Do të hetohet edhe mbi eksperiencën e migracionit, kryesisht duke

përdorur rezultatet e studimit të MSJ së vitit 2002 (LSMS).

Meqë vendimet për pjesëmarrjen e punës merren kryesisht në kontekstin e shtëpisë apo familjes është e rëndësishme të analizojmë punësimin, papunësinë dhe inaktivitetin ekonomik gjithashtu nga perspektiva e familjes: Dimensioni dhe struktura e tij mund të kthehen në variabla interesante shpjegues për gjendjen ekonomike të anëtarëve të saj, ndërsa nga pikëpamja politike dhe administrative, numri i familjeve që nuk punojnë apo e atyre me të gjithë anëtarët e papunë mund të jetë indeks i rëndësishëm për të çuar drejt ndërhyrjeve të duhura për mirëqenien.

Për shkak të kompleksitetit të lidhjeve të analizuar ne preferojmë të përdorim grafikë për të ilustruar ndryshimet në sjelljen e punës e lidhur kjo me karakteristikat e studiuara. Gjinia dhe mosha do të përdoren shpesh në këtë studim si variable kontrolli.

2. Puna dhe jo-puna në dy perspektiva të ndryshme

Siç e përmendëm më parë (seksioni 4.2 në Kapitullin II), mosha është një variabël i

rëndësishëm në kontrollimin e pjesëmarrjes në tregun e punës, sidomos në mjedis jo rural dhe shoqëri ku shteti siguron edukimin e detyruar para se mosha e punës dhe skema e pensionit të vijnë pas saj.

Nëse iu hedhim një vështrim proceseve përkatëse sipas një perspektive të gjatë, mund të vëmë re:

- i) Një periudhë të formimit të kapitalit njerëzor, që mund të vazhdojë pjesërisht edhe gjatë periudhës së moshës së punës, për shkak të arsimit të lartë apo ndonjë kursi trajnimi që është ndërmarrë gjatë tij;
- ii) Për shumicën e meshkujve, një periudhë që i përkushtohet shërbimit të detyrueshëm ushtarak;
- iii) Një periudhë e mundshme kërkimi për punën e parë kur hyet në tregun e punës për herë të parë;
- iv) Periudha të aktivitetit ekonomik në varësi të një punëtori të pavarur, që mund të ndërpritet përkohësisht nga

v) Periudha papunësie, duke kërkuar një punë të re;

vi) Periudha të një distance të mundshme nga tregu i punës (psh, si shtëpiaket për femrat), që individualisht mund të zgjasin edhe për gjithë jetën;


vii) dhe, në fund të qënies në punë, periudha e pensionit.

2.1 Perspektiva ndër-seksionale

Ne shohim se gjithë këto kushte bashkëjetojnë në një popullsi të vëzhguar nga regjistrimi i popullsisë, duke patur brenda vetes studentë, ata që kërkojnë punë për herë të parë, të punësuar, persona jo aktivë dhe ndoshta, persona në pension të së njëjtës moshë. Nga një perspektivë ndër-seksionale si ajo e regjistrimit të popullsisë, vlerat specifike të moshës për secilin nga ato kushte na ofrojnë intensitetin e “pjesëmarrjes” të popullsisë që i takon asaj moshe, sipas gjinisë. Vlerat specifike të moshës, krahasuar me gjatësinë e moshës, vizatojnë një figurë të diferencialëve përkatës. Për shembull në Grafikon 4.1, ne raportojmë vlerat specifike të një grup moshë për pjesëmarrjen e fuqisë punëtore, punësimit dhe kërkuesve të rinj të punës.

Figura e vlerës (aktive) të pjesëmarrjes së fuqisë punëtore është mjaft normale për popullsinë e përbërë nga meshkuj, megjithëse e karakterizuar nga fillim i hershëm me një moshë prej 15 vjeç. Ajo ngjitet thujse rregullisht në formë S-je, deri në të 30-tat kur edhe arrin maksimumin me mbi 97%. Më pas, ajo mban vlera të larta deri në moshën 54 vjeç, ku procesi i daljes nga tregu i punës, zhvillohet në dy shkallë: menjëherë nga mosha 54 në 55 vjeç, humbet 14%, dhe më gradualisht duke ndjekur një formë S-je të përmbytur mes moshave 55 dhe 65 vjeç apo edhe më lart.

Grafiku 4.1 -Koefficienti i punësimit dhe pjesëmarrjes në krahun e punës sipas gjinisë i Single-age specific ;Shqipëria, 2001



Legjenda: M = Meshkuj; F = Femra; Empl./Em. =Të punësuar; KRP = Kërkues të rinj puneL

Burimi: Llogaritje në bazë të të dhënave të Regjistrimit të Popullsisë 2001

Mund të shikojmë në kurbën e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore tendencën në ndryshim për të punuar gjatë jetës, në konkurrim me angazhimet e tij/saj. (psh, studimi, shërbimi ushtarak etj) apo mundësia për të qënë “jo aktiv” (psh, pensioni, të qenët shtëpiak etj, etj.). Në krahun tjetër, përgjigja aktuale mbi kërkesën për punë mund të përfaqësohet nga vlerat e punësimit korrespondues.

Distanca e konsiderueshme mes dy kurbave të meshkujve (punësimi dhe aktiv) që vërejmë deri në moshën e mesme, dëshmon vështirësinë e moshës së re për të hyrë në mënyrë të suksesshme në tregun e punës. Është e vërtetë se të dhënat e regjistrimit paraqesin një rënie në moshën 20 vjeç kur bie shifra e punësimit dhe - thuajse habitshëm - kur rritet vlera e atyre që kërkojnë punë për herë të parë. (Aneksi 4.1, ku analizohet edhe veçantia e grupmoshës së femrave 46-54 vjeç).

Ndryshimet mes kurbës së pjesëmarrjes së fuqisë punëtore dhe asaj që mbledh përqindjen e të punësuarve dhe atyre që kërkojnë një punë të re, ndriçojnë faktin se “hyrjet e reja” në tregun e punës ndodhin deri në moshën 30 vjeç, si për meshkuj edhe për femra. Pas kësaj moshe, boshllëku që ekziston mes “furnizimit me punë” dhe “kërkesës për punë” vjen thuajse ekskluzivisht si pasojë e kërkuësve të një pune të re.

Nga forma e kurbave në figurë për femrat, përveç dy pikëve të veçanta analizuar në Aneksin 4.1, ne vëmë re vështirësinë e madhe për të gjetur punë dhe për ta mbajtur atë në kohën e regjistrimit të popullsisë në vitin 2001. Aktualisht ka gjithmonë 15-20% pikë diferencë mes vlerave të pjesëmarrjes së fuqisë punëtore dhe vlerave korresponduese të punësimit dhe, që prej moshës 20 vjeç, kjo diferencë – që përfaqëson papunësinë – vjen kryesisht prej atyre që kërkojnë një punë të re, femra që deklarorin se ato kishin punuar në të shkuarën, por në kohën e regjistrimit ato ishin duke kërkuar punë të re. Ky boshllëk

mbetet thuajse konstant deri në moshën 54 vjeç, kur dalja e femrave nga tregu i punës ndodh menjëherë.


Rënia e madhe në vlerën e punësimit nga viti 1989 deri në 2001 ndriçohet nga vlerat e punësimit për grupmoshën specifike pesë-vjeçare që tregohet në Grafikon 4.2. Meshkujt iu afrohen këtyre vlerave vetëm në një moshë më të madhe (40-49 dhe 50 e lart), femrat veprojnë kështu kur janë 50 vjeç e lart. Në një moshë më të re (15-19), vlerat e arritura nga meshkujt në 2001 janë më të larta kudo, ndërsa për femrat janë të tilla vetëm në kontekstin urban. Duke pasur gjithë ndryshimet dhe përkufizimet e vëzhgimet, punësimi më i lartë i të rinjve mund të dëshmojë një nevojë të hershme për të fituar përmes punës dhe, si pasojë, një tendencë më e ulët për të studiuar (apo mundësi).

Në regjistrimin e vitit 2001, ka pak ndryshime mes niveleve dhe formave sipas rezidencës, të përjashtuar nga punësimi i lartë femrat e grupmoshës 40-49 vjeç që jetojnë në zonat rurale dhe vlera të një punësimi më të lartë në moshën mesatare si për meshkujt edhe për femrat që jetojnë në Tiranë.


Për meshkujt, niveli i lartë i shifrave të papunësisë në moshën 20-24 vjeç i korrespondon futjes së vonë dhe të ngadaltë në punë, veçanërisht në Tiranë dhe zona e tjera urbane, ku 70-80% e fuqisë punëtore të përbërë nga meshkujt, ishin në kërkim të një pune në atë moshë (Grafiku 4.3). Papunësia tek femrat nuk arrin dot vlera kaq të larta, por, në Tiranë dhe zona të tjera urbane, ai mbetet i lartë deri në 40-60% të fuqisë punëtore përkatëse nga mosha 20-24 vjeç në 35-39 vjeç. Situata në zonat rurale është tërësisht e ndryshme, veçanërisht për femrat, megjithë që ¼ e punëtorëve femra nga 20-29 vjeç ishin duke kërkuar punë gjithashtu.

Grafiku 4.2 -Koefficienti i punësimit sipas vendbanimit, gjinisë dhe grupmoshës: 1989 dhe 2001


Meshkuj, Tirana urbane




Femra, Tirana urbane




Meshkuj, Të tjera zona urbane




Femra, Të tjera zona urbane



Meshkuj, Zona rurale



Femra, Zona rurale




Burimi: Llogaritje në bazë të të dhënave të Regjistrimit të Popullsisë të 1989 dhe 2001

2.2 Perspektiva e ciklit të jetës

Siç e thamë më lart, vlera specifike e një grup moshe përfaqëson kuotën e popullsisë përkatëse të angazhuar në një gjendje të

caktuar punësimi. Megjithatë, kur bëhet vlerësimi për një person të vetëm specifik, kjo vlerë mund të lexohet si statusi i atij viti që ai/ajo ka në atë moshë specifike. Nëse, në metodën e gjithë jetës ne mbledhim gjithë

Grafiku 4.3 - Koefficienti i papunësisë sipas gjinisë, vendbanimit dhe grupmoshës: 2001



Burimi: Llogaritje në bazë të të dhënave të Regjistrimit të Popullsisë të 1989 dhe 2001


vlerat homogjene nga moshë 15 vjeç në 64 vjeç (mosha e punës) në arrjmë kohën “teorike” (në vite dhe fraksione vitesh) një person mesatar shpenzon në secilën gjendje të moshës gjatë kurtit të tij/saj të jetës në punë. Rezultatet e të dhënave të regjistrimit të vitit 2001 janë në Grafikon 4.4, vetëm në shkallë vendi dhe duke vënë përkundrejt meshkujt me femrat.

Periudha e studimit pas moshës 15 vjeç është shumë e shkurtër (më pak se tre vjet), mbi mesataren, pak më e gjatë për femrat. Një vit shpenzohet nga femrat dhe 1.7 nga meshkujt për të kërkuar punën e parë. Koha e shpenzuar në punësim zgjat gjithsej 33.5 vjet për meshkujt dhe 19.7 për femrat. Ajo ndahet nga një apo më shumë periudha të shkurtra papunësie, duke kërkuar një punë të re, e cila si mesatare dhe në total zgjat 5.2 vjet për meshkujt dhe 6.2 vjet për femrat. Pas punës, por para moshës 65 vjeç, meshkujt gëzojnë 5.6 vjet në pension, si mesatare, ndërsa femrat 8.1 vjet. Mesatarja e gjendjeve të tjera mbi gratë, na lejon të themi se ato harxhojnë 11 vjet në gjatësinë e jetës nga 15-64 vjeç si shtëpiake. Si përfundim, gjatësia e kohës së punës, përdoret në 2/3 nga meshkujt shqiptarë dhe më pak se 2/5 nga femrat

shqiptare. Pika tejte që del në pah është mesatarja e fillimit të hershëm të punës (para moshës 20vjeç) për të dy dyja gjinitë, kryesisht për shkak të kohës së shkurtër që i është kushtuar arsimit. Në anën tjetër të distancës moshore, mund të llogaritim për meshkujt një mesatare moshe prej rreth 59-60 vjeç dhe dalja përfundimtare nga tregu i punës, ndërsa për femrat është rreth 57 vjeç.

Llogaritje më të sakta mbi mesataren, normën apo moshën përkatëse, hyrjes apo daljes nga tregu i punës apo punësimi, pengohen nga forma jo normale e kurbave përkatëse, si në fillim edhe në fund të jetëgjatësisë së punës. Vetëm për meshkujt, mosha mesatare e daljes nga tregu i punës mund të llogaritet në 59.6 vjeç, ndërsa norma e tyre e moshës në dalje (dmth mosha në të cilën vlera maksimale e moshës specifike është përgjysmuar) është 59.2 dhe mosha përkatëse (dmth. Mosha në të cilën ndodh numri maksimal i daljeve) është përgjatë mosës 59 vjeç. Vlerat për kurbën e punësimin janë thajse të ngjashme, mosha mesatare e daljes është 59.9 vjeç, mosha e mesme 59.2, dhe ajo rregulluese 59. Vlera e aktivitetit të meshkujve është gjithashtu thajse i rregullt në fazën e hyrjes në tregun e punës, kështu

Grafiku 4.4 – Vitet teorike të moshës së punës (15-64 vjeç) sipas gjinisë dhe statusit ekonomik: Shqipëria, 2001



Legend:

a = Student

b = I papunë, kërkues i punës së parë

c = I punësuar

d = I papunë, kërkues i një pune të re

e = I papunësuar, që s'kërkon i punë

f = Meshkuj në shërbimin e detyruar ushtarak/ Femra shtëpiake

g = Pensionistë

h = Të tjerë ekonomikisht joaktiv

Burimi: Llogaritje në bazë të të dhënave të Regjistrimit të Popullsisë 2001

që moshë mesatare e hyrjes në tregun e punës mund të llogaritet në 17.8 vjeç, ndërsa ajo e mesme apo rregulluese është teorikisht 15 vjeç për shkak të nivelit të lartë të pjesëmarrjes së fuqisë punëtore që në fillim të moshës së punës. Në këtë mënyrë, gjatësia mesatare e pranisë në tregun e punës mund të vlerësohet në 41.8 vjeç, që është e përafëruar me vlerat e llogaritura më lart kur ne mbledhim kohën e harxhuar në kërkimin e punës së parë, punësimitin dhe kërkimin e një pune të re. $(1.7 + 33.5 + 5.2 = 40.4)$. Në fakt, ne duhet të marrim në konsideratë se llogaritja e moshave mesatare të hyrjes dhe daljes zgjerohet në 15 vjeç e lart, ndërsa ajo e llogaritur nga periudha teorike kufizohet në periudhën e moshës nga 15-64 vjeç, dhe se popullsia e përbërë nga meshkujt merr pjesë në tregun e punës në vlerën 97.7% maksimalisht.

3. Tiparet demografikë

individualë

Domosdoshmëria e fitimit të të ardhurave jetike përmes punës është e përhapur në mënyrë universale. Kështu që, vlerat e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore pak varen nga variablat demografike dhe social-ekonomike. Aty ku është e mundur të ofrohen shanse mes punës dhe jo – punës, ia vlen të eksplorohej lidhjet që ekzistojnë mes karakteristikave individuale dhe pjesëmarrjes së fuqisë punëtore. Ky mund të jetë rasti në zonat urbane ku, është prezent shpërndarja më e madhe e njerëzve sipas statusit social-ekonomik dhe aktiviteti ekonomik duket se ndikohet fuqishëm nga variablat social-demografike.

Në krahun tjetër, faktorët e diferencuar që ndikojnë tek papunësia, mund të vlerësohen vetëm aty ku ekziston një treg pune real, sidomos aty ku ka mospërputhje cilësore mes

furizimit me punë dhe kërkesës për punë, së bashku me ato sasiore, në vijim të spektrit të gjerë dhe ndoshta të pabalancuar të aftësive të orfruara dhe të kërkuara. Këto rrethana ekzistojnë në radhë të parë në zonat urbane.

Në këtë seksion, ne kemi për qëllim të ndriçojmë lidhjet e mundshme mes disa faktorëve demografikësi dhe pjesmarrjes së fuqisë puntore e papunësisë. Do të merren në konsideratë variablat e mëposhtëm demografikë: gjendja civile, lidhja me kryetarin e familjes, numrin e fëmijëve, ky i fundit vetëm kur analizohet aktiviteti ekonomik i femrave të moshave ndërmjet 15 dhe 34 vjeç. Efekti i çdo variabli mbi punësimin bruto dhe vlerat e papunësisë do të përshkruhet duke krahasuar


nivelet sipas gjinisë dhe grup moshave prej pesë vjetësh.

3.1 Gjendja civile


Gjendja civile shpesh luan një rol të kundërt në vlerat e pjesamrjes së fuqisë punëtore të meshkujve dhe femrave, të paktën tek moshat e qendrës dhe ato më të vjetra. Personat jo të përshtatshëm për punë (të paafta apo personat e sëmurë permanentë, dembelët, etj) mund të gjenden më shpesh mes meshkujve të pa martuar ndonjëherë në shoqëri ku martesat është thujse një rregull. Vlera e aktivitetit të tyre është si pasojë më e

Grafiku 4.5 -Koefficienti i punësimit sipas gjinisë, statusit civil dhe grupmoshës: Shqipëria, 2001


Meshkuj, Zona rurale




Femra, Zona rurale



Meshkuj, Zona urbane



Femra, Zona urbane




Burimi: Llogaritje në bazë të të dhënave të Regjistrimit të Popullsisë 2001


Grafiku 4.6 -Koefficienti i papunësisë sipas gjinisë, statusit civil dhe grupmoshës: Shqipëria, 2001

(Përqindja e totalit të grupit)


Zona rurale, Të pamartuar




Zona rurale, Të pamartuara



Meshkuj, Zona urbane



Femra, Zona urbane




Burimi: Llogaritje në bazë të të dhënave të Regjistrimit të Popullsisë 2001

ulët se ajo e atyre që janë të martuar. Në kontrast me këtë fakt, vlera e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore e femrave të rritura dhe asnjëherë të martuara, është shpesh më e lartë si për shkak të angazhimeve të tyre më të pakta në shtëpi e me fëmijët, ashtu edhe për shkak të nevojës së tyre të fortë për të fituar jetesën përmes punës. Një selektim pozitiv sipas arsimit apo jetesës moderne mund t'i shtojë këtij fakti, siç edhe ndodh ndoshta për femrat e divorcuara. Vlerat e ulëta për personat e rinj të pamartuar të të dy gjinive, justifikohen nga lidhja e qartë mes vazhdimit të studimeve të larta dhe shtyrjes së formimit të familjes dhe hyrjes në tregun e punës.

Të dhënat për zonat urbane në vitin 2001 i konfirmojnë këto ndryshime me një kurbë moshore më të ulët për meshkujt që nuk janë martuar asnjëherë dhe vlera më të larta punësimi për femrat e pamartuara (asnjëherë të martuara, divorcuara apo të veja) kur krahasohen me kurbën mjaft më të ulët të femrave aktualisht të martuara. (Grafiku 4.5).

Më shumë se 65% e femrave asnjëherë të martuara, janë të punësuar nga moshja 24-29 vjeç në moshën 50-54 vjeç. Femrat aktualisht të martuara duket se hyjnë në tregun e punës (ndoshta ri hyjnë) pas moshës 45 vjeç, por veçantia mes 46 dhe 54 vjeç, që

Grafiku 4.7 - Koefficienti i punësimit sipas gjinisë, marëdhënieve familjare të personit të referuar dhe grupmoshës: Shqipëria, 2001



N.B.: Koefficientët janë llogaritur për grupe të popullsisë ekonomikisht aktive më të mëdha se 100*
 *Grupi pëcaktohet sipas llojit të lidhjes
 Burimi: Llogaritje në bazë të të dhënave të Regjistrimit të Popullsisë 2001

analizohet në Aneksin 4.1, duhet të qëndrojnë vetëm për to.

referencës”, ai me të cilin të gjithë komponentët e tjerë do të kishin lidhje gjaku apo jo.

Meshkujt asnjëherë të martuar, vuajnë nga vlera papunësie më të larta se statuset e tjera civile, ndërsa e kundërta ndodh me femrat e pamartuara asnjëherë, deri në moshë të madhe (Grafiku 4.6). Në fakt, femrat aktualisht të martuara, përjetojnë vlera të larta papunësie sidomos në zonat urbane, duke dëshmuar kështu domosdoshmërinë e madhe të çiftit të cilit i përkasin për të kërkuar fitime të dyfishta, por edhe vështirësinë e vazhdueshme në plotësimin e kësaj nevojë

Shkalla më e lartë e punësimit e personit të referencës tregohet qartë si për meshkujt edhe për femrat në grafikun 4.7. Vlerat e tyre të punësimit janë më të larta në të gjitha moshat, përveç se për grup moshat më të vjetra të femrave, ku efektet e deformimeve mund të ndikojnë kryesisht tek bashkëshortet.


3.2 Lidhja e gjakut me kryetarin e familjes

Roli qendror i “atij që fiton bukën” në shtëpi, dëshmohet nga niveli i ulët i shkallës së papunësisë së personave të referencës, si meshkuj ashtu edhe femra (Grafiku 4.8). Ata përjetojnë një shkallë papunësie më të lartë se 10% (5% për femrat), ndërsa gjithë komponentët e tjerë në shtëpi, kur janë prezent në tregun e punës, arrijnë nivele papunësie nga 30-40% gjatë periudhës së moshës 20-39 vjeç, 15-20%, por për një periudhë më të gjatë kohe në rast se janë femra.

Konsideratat e mësipërme konfirmohen nga thyerja e vlerave të punësimit nga lidhja me kryetarin e familjes. Aktualisht, regjistrimi pyeti përmes pyetësorit për identifikimin e personit në çdo familje që do të konsiderohej “personi i

Grafiku 4.8 - Koefficienti i papunësisë sipas gjinisë, marëdhënieve familjare të personit të referuar dhe grupmoshës: Shqipëria, 2001

(Përqindja e totalit të grupit)




N.B.: Koefficientët janë llogaritur për grupe të popullsisë ekonomisht aktive më të mëdha se 100

*Grupi pëcaktohet sipas llojit të lidhjes

Burimi: Llogaritje në bazë të të dhënave të Regjistrimit të Popullsisë 2001

Grafiku 4.9 - Koefficienti i pjesëmarrjes në krahun e punës dhe koefficienti bruto i punësimit të grave sipas numrit të fëmijëve gjallë dhe single age: Shqipëria, 2001, 15-34 vjeç



N.B.: Koefficientët janë llogaritur për grupe të femrave më të mëdha se 100

*Grupi pëcaktohet sipas llojit të lidhjes

Burimi: Llogaritje në bazë të të dhënave të Regjistrimit të Popullsisë 2001

3.3 Numri i fëmijëve

Kompeticioni ndërmjet punës së femrave dhe riprodhimit të fëmijëve është një temë debati në vendet në zhvillim: vështirësitë e shtohen mundësive racionale të çiftit dhe sjelljes së masës për të ulur fertilitetin tek femrat, shpesh duke shtyrë riprodhimin në mosha më të mëdha. Kjo mund të jetë pjesërisht e njëjtë veçanërisht në zonat urbane të vendeve në tranzicion.

Të dhënat e regjistrimit të vitit 2001 japin mundësinë e njohjes së numri të fëmijëve që ka lindur çdo grua: demografët e quajnë këtë numër *paritet*. Ne e përdorëm paritetin për të kontrolluar pjesëmarrjen e fuqisë punëtore dhe punësimin në regjistrimin për femrat e moshës 15-34 vjeç. Ne e zgjedhim këtë kufi moshe më të lartë me qëllimin për të konsideruar vetëm fëmijët që aktualisht mund të jenë pengesë për aktivitetin e punës së nënave të tyre.

Shkalla e pjesëmarrjes së femrave në fuqinë punëtore nuk duket të jetë shumë e ndikuar nga numri i fëmijëve (Grafiku 4.9). Femrat pa fëmijë aktualisht hyjnë në tregun e punës në një numër të madh, veçanërisht pas shkollës së mesme dhe moshës së universitetit, por femrat që kanë një apo edhe më shumë fëmijë duan të kenë një punë një masë të konsiderueshme, deri në 70-85%. Kurbat e shkallës së punësimin veçanërisht tregojnë efektet e rënies 19-20 vjeç që në vumë në dukje më lart dhe që do të analizohet në Shtesën 4.1: Shkalla e lartë e papunësisë gjithashtu e nënave nga 15-19 vjeç, me një apo dy fëmijë për të rritur na bën të dyshojmë se mund të ketë ndodhur ndonjë gabim apo moskorrektësi gjatë regjistrimit lidhur me aktivitetin e punës së adoleshentëve.

Ndryshime të rëndësishme shfaqen në nivele të shifrave të punësimin bruto sipas numrit të

fëmijëve. Femrat që nuk kanë fëmijë, tregojnë vlera shumë më të mëdha se femrat e së njëjtës moshë që kanë fëmijë, nivelet e punësimin të të cilave, për më tepër, janë të lidhura në të kundërt me numrin e tyre. Gjithashtu ia vlen të dimë se të gjitha kurbat, veçanërisht ato që lidhen me nënat, vijnë e rriten me moshën. Ka shumë shpjegime për këtë. Së pari, ekziston ende një kufi moshe hyrëse në atë që ne konsideruam. Pastaj, të dhënat ndërseksionale mund të kenë regjistruar disa efekte të mundshme grupi për femrat në moshë të punësuar në aktivitete të mëparshme, të cilat mund të kenë pasur sukses në mbajtjen e tyre kundrejt grupeve më të reja hyrëse. Ka gjithashtu një efekt selektiv, që i bën femrat më pak të arsimuara të kalojnë tranzit në nivele pariteti më të larta, duke lënë në nivelet më të ulëta të paritetit ato femra që ishin më të motivuara në punë. E fundit, por jo më pak e rëndësishmja, ne duhet të dyshojmë për një proces të lëshimit progresiv, në mënyrë që ndërkohë që fëmijët rriten, nënat të mund të punojnë përsëri.

4. Tiparet individuale social-ekonomike

Tiparet individuale social-ekonomike lidhen me statusin e punës në një mënyrë të dyfishtë. Ata janë shpesh një komponent i rëndësishëm në arritjen e suksesit apo edhe të dështimit të punëtorit në tregun e punës. Në krahun tjetër, ky sukses apo dështim, bëhet komponenti kryesor i statusit social-ekonomik të punëtorit dhe familjes apo shtëpisë së tij/saj.

Këtu do të shqyrtojmë vetëm llojin e parë të këtyre marrëdhënieve, duke u përpjekur të nxjerrim pjesëmarrjen e fuqisë punëtore, punësimin dhe papunësisë, si dhe karakteristikat e punës së kryer, nga "kapitali njerëzor" një punëtor mund t'i ofrojë tregut të

punës. Regjistrimi i popullsisë së vitit 2001 në Shqipëri, ofroi dy variabla kryesore, të cilët japin disa sugjerime mbi kapitalin njerëzor: Arsimi dhe eksperiencia migratore. Për këtë të fundit, megjithatë, ne preferuam të përdorim të dhënat e studimit të MSJ të vitit 2002, që janë të sakta dhe të plota.


4.1 Arsimi

Arsimi është një variabël jetik në modelimin e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore dhe punësimit, ky i fundit gjithashtu nga pikëpamja cilësore, dmth sipas statusit, llojit dhe vendit të punës, degës së industrisë, orëve të punës.


Duke përdorur rezultatet e regjistrimit të vitit 2001, për pyetjen rreth diplomës së universitetit që individët kishin, ne do të përpiqemi të kontrollojmë ndryshimet që ekzistojnë në fuqinë punëtore dhe punësimitin në lidhje me matjen e arsimimit. Në fakt, arsimi nuk matet vetëm përmes diplomës që kanë marrë individët: Numri i viteve të shkollës së përfunduar ishte një alternativë e ofruar nga regjistrimi i vitit 2001. Edhe kurset e trajnimit mund të ndiqen gjatë kursit të jetës, duke rritur dhe specializuar kapitalin njerëzor. Megjithatë, ne preferuam të përdornim variablin e diplomave të marra për shkak se diplomat njihen formalisht në tregun shqiptar të punës.

Grafiku 4.10 - Koeficienti i punësimit sipas gjinisë, nivelit të arsimimit dhe grupmoshës: Shqipëria, 2001
(Përqindja e totalit të grupit)


Meshkuj, Zona rurale




Femra, Zona rurale



Meshkuj, Zona urbane



Femra, Zona urbane




Burimi: Llogaritje në bazë të të dhënave të Regjistrimit të Popullsisë 2001


Grafiku 4.11 - Koeficienti i papunësisë sipas gjinisë, nivelit të arsimit dhe grupmoshës: Shqipëria, 2001

(Përqindja e totalit të grupit)


Meshkuj, Zona rurale




Femra, Zona rurale



Meshkuj, Zona urbane



Femra, Zona urbane




Burimi: Llogaritje në bazë të të dhënave të Regjistrimit të Popullsisë 2001

Nga grafiku 4.10 ne kuptojmë rëndësinë e efektit diferencial mbi punësimin, sidomos për femrat në zonat urbane. Për shkak të shpërndarjes së gjerë afat – gjatë të arsimit të detyruar në Shqipëri, njerëzit pa diplomë janë ndoshta të paafët, që nuk punojnë apo hasin vështirësi serioze në gjetjen e një pune. Në mes të jetë, shkalla e vlerave të punësimit sipas nivelit të arsimit në vend është evidente për meshkujt. Për femrat, ekziston një boshllëk mes arsimit universitar dhe gjithë niveleve të tjera. Gjithashtu vëmë re se rritja e fundit e çuditshme e vlerave të punësimit prek më shumë femrat pak të arsimuara sesa ato më një diplomë të shkollës së mesme apo të universitetit.

Në zonat urbane, diferencuesit sipas nivelit të arsimit janë edhe më të mprehta. Për femrat në veçanti, ndryshimet sipas nivelit të arsimit janë më të qarta në kontekstin urban, me femra që duke pasur një diplomë të mesme punësohen progresivisht më rritjen e moshës. Ndoshta, efekti i grupit është arsyeja kryesore për këtë, duke dëshmuar për vështirësitë në rritje në gjetjen e një pune për të gjitha femrat e reja, por dhe për ato me diplomë universiteti.

Për shkak të rritjes së kufizuar të punësimit bashkë me plakjen, për femrat me arsim më të ulët, rënia e shkallës së tyre të punësimit

Grafiku 4.12 - Të papunë sipas gjinisë, nivelit të arsimit dhe përbërjes: Shqipëria, 2001 (pjesa në %)



Burimi: Llogaritje në bazë të të dhënave të Regjistrimit të Popullsisë 2001

me moshën, mund të interpretohet si dalja e tyre nga tregu i punës si “persona të papunë të dekurajuar”.


Vështirësitë e ndryshme në gjetjen e punës konfirmohen nga shkalla e papunësisë sipas nivelit arsimor (Grafiku 4.11). Vetëm femrat me një nivel universitar (që ishin rreth 55 mijë në vend) duken se kanë probleme të kufizuara në gjetjen e një punësimi. Gjithë nivelet e tjera

të grupeve të femrave dhe meshkujve sipas nivelit arsimor paguajnë për nivelet e larta të përkohshme apo që zgjasin të papunësisë.

Por papunësia në Shqipëri formohet kryesisht nga ata që kërkojnë punë të re (dhe jo nga ata që kërkojnë punë për herë të parë) në gjithë nivelet e arsimit (Grafiku 4.12). Nëse ky është produkti i humbjes së punësimin të mëparshëm anuluar ky si pasojë e krizës ekonomike, apo për nivele më të larta arsimore, efekti i periudhave të punës gjatë kohës së studimit është më pak se 1/3 e meshkujve të papunë dhe më pak se 1/4 e femrave të papuna që janë në kërkim të punës së tyre të parë në çdo nivel arsimor që ato janë.

Grafiku 4.13 - Popullsia në moshë madhore ekonomikisht joaktive sipas gjinisë dhe nivelit të arsimit: Shqipëria, 2001

(% e grupit të popullsisë 15 vjeç e lart)



Burimi: Llogaritje në bazë të të dhënave të Regjistrimit të Popullsisë 2001

Nga një pikëpamje e kundërt, ne mund të vlerësojmë lidhjet mes nivelit arsimor dhe inaktivitetit në popullsinë 15 vjeç e lart (Grafiku 4.13). Këtu, gjithashtu është prezent efekti i grupit, meqë grupet më të vjetra ka më shumë mundësi të jenë pak të arsimuar, ndërsa janë gjithashtu në pension në një numër të madh. Sidoqoftë, lidhja e kundërt ndërmjet nivelit arsimor dhe inaktivitetit të të rriturve, është mjaft e qartë për femrat, më pak e qartë për meshkujt që nëse nuk kanë ndonjë sëmundje


fizike apo mendore, të gjithë përpiqen të punojnë, cilado qoftë diploma e shkollës që kanë.

Siç edhe e nënvizuar më lart, niveli arsimor bën dallimin e punësimit dhe karakteristikave të tij – le të themi mënyrës apo zonës ku ai kryhet. Për shembull, vetëm 60% e meshkujve të punësuar pa diplomë apo me një diplomë deri të nivelit sekondar, kanë një punë të përhershme, ndërsa kjo kuotë është pranë 70% për nivelin e lartë sekondar dhe 85% për meshkujt me një diplomë universitare (Grafiku 4.14). E njëjta gjë ndodh për femrat, por me një ndarje më të mprehtë sa i takon nivelit universitar.

Shpërndarja e punëve sezonale, të përkohshme dhe rastësore mes niveleve të ulëta të arsimimit, i korrespondon statusit të punëtorëve për llogari të tyre apo kontribuesve familjarë (sidomos femra), që mbizotërojnë gjerësisht mes meshkujve (Grafiku 4.15). Vetëm për meshkujt e punësuar në nivel universitar dhe femrat e punësuar me një diplomë të lartë sekondare apo universitare, gjendja e të punësuarit është prezent për më shumë se 50% duke arritur në 88% për femrat me nivel universitar. Statusi i punëdhënësit, megjithëse më i pranishëm tek meshkujt me diplomë të lartë sekondare apo universitare, janë të shpërndarë në numër të vogël në të gjitha nivelet arsimore, duke treguar ndoshta pjesërisht vetë klasifikimin e gabuar të personave që ishin me të vërtetë për llogari të tyre.


Siç edhe e diskutuam në kapitullin III, puna e pjesshme është majft e përhapur në aktivitetin e punës në Shqipëri si për shkak të një bujqësie kryesisht mbijetuese që zor se kërkon punësim të plotë, edhe pranisë së shumë punëve rastësore dhe me kohë të shkurtër apo në sektorin e shërbimeve apo në punën e dorës. Edhe gjinia ka një zë në këtë proces, por arsimimi duket se është

Grafiku 4.14 - Të punësuar sipas gjinisë, nivelit të arsimimit dhe llojit të punës: Shqipëria, 2001 (pjesa në %)



variabli real përcaktues në dallimin mes punëtorëve me kohë të plotë dhe të pjesshme (Grafiku 4.16). Më shumë se gjysma e të punësuarve që kanë një nivel arsimor më të ulët se diploma e nivelit sekondar të lartë, punonin me kohë të pjesshme, si meshkujt edhe femrat. Veçanërisht femrat e punësuar që kanë një diplomë të ulët sekondare, punonin në një masë të madhe në fermë apo tregti me pakicë, ose ndonjë lloj shërbimi.

Grafiku 4.15 - Të punësuar sipas gjinisë, nivelit të arsimit dhe statusit të punës: Shqipëria, 2001 (pjesa në %)



Burimi: Llogaritje në bazë të të dhënave të Regjistrimit të Popullsisë 2001

Ndarja arsimore e ushtron kuptimin e vet të plotë kur ne bëjmë thyerjen e personave të punësuar me sketorin e aktivitetit ekonomik (Grafiku 4.17). Ne shohim personat e punësuar me një nivel arsimor më të ulët që punojnë kryesisht në sektorin e bujqësisë, ndërsa personat e punësuar me një gradë universitare në shumicën e rasteve punojnë në sektorin e shërbimeve. Prania e kufizuar e industrisë është thujse e shpërndarë në mënyrë të barabartë me niveleve të arsimit,

me vetëm një prani më të lartë në diplomat e larta sekondare. Një e treta e meshkujve pa diplomë dhe një e kartërta e femrave gjithashtu pa diplomë punësuar në sektorin e shërbimeve ndoshta përfaqësojnë numrin e nivelit të ulët të shërbimeve publike ose private, që janë të përhapura kryesisht në kontekstin urban. (psh, pastruesit e rrugëve, rojet, shërbyesit, etj.).


Një analizë më e kujdesshme e personave të punësuar në degët kryesore të aktivitetit ekonomik sipas nivelit të tyre të arsimit tregon se një prani më e madhe e gradave universitare gjendet – siç mund të pritet – mes puntorëve të degëve të “Arsimit” dhe “Shërbimeve të tjera”, të cilat përfshijnë administratën publike (Grafiku 4.18). Për meshkujt shohim se punëtorët me një gradë universitare gjenden gjithashtu në “Punët sociale dhe shëndetësi”, ndoshta si mjekë. Në të njëjtën degë, shumica e punëtoreve femra kanë një diplomë sekondare të lartë, ndoshta si infermiere.

Niveli sekondar i ulët, që i korrespondon arsimit aktual të detyrueshëm, mbizotëron vetëm në bujqësi (ku shihen edhe nivelet primare, ndërsa gradat universitare thujse mungojnë), dhe pjesërisht, në ndërtim.

4.2 Eksperiencia migratore

Migrimi shpesh ka qenë specifikuar si pasojë e papunësisë së fuqisë punëtore apo shkurtimit të vendeve të punës. Këtu do të përpiqemi të lidhim eksperiencën migratore me sjelljen në tregun e punës disa karakteristika të aktivitetit të punës së kryer. Për këtë ne do të përdorim të dhënat e studimit të MSJ për vitin 2002 LSMS, të dhëna të cilat më mirë se ato të regjistrimit të vitit 2001, të nxjerrim eksperiencën migratore të të intervistuarve.

Grafiku 4.16 - Të punësuar sipas gjinisë, nivelit të arsimit dhe orëve* të zakonshme të punës: Shqipëria, 2001 (pjesa në %)



^(a) Orët e zakonshme të punës gjatë javës ose orët e punës të paguara gjatë javës para regjistrimit nëse nuk kishte orë të zakonshme pune.


Burimi: Llogaritje në bazë të të dhënave të Regjistrimit të Popullsisë 2001

Duhet të jemi të qartë se në Shqipëri para 1990, lëvizja e brendshme nga njëra zonë në tjetrën të vendit ishte jashtëzakonisht e kufizuar. Migrimi shumë i madh ndërkombëtar pas vitit 1990 ishte gjithashtu i lidhur me lëvizjet e brendshme të personave. Kështu, personat që jetojnë në një zonë specifike mund të shkallëzohen si “jo-migrantë” apo migruan para Janarit të vitit 1990” dhe “migrantë pas Janarit 1990”: për hir të të qenit konciz ne do t'i quajmë të parët “qëndrues”, dhe të fundit “lëvizës”.

Ndërsa për meshkujt, shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore nuk tregon ndryshime të mëdha mes “lëvizësve” dhe “qëndruese”, për femrat, ka një pjesëmarrje qartësisht më të ulët nga “lëvizësit” (Grafiku 4.19). Papunësia, në të kundërt, është gjithashtu më e lartë për meshkujt e rinj “lëvizës”, duke dëshmuar kështu vështirësitë në gjetjen e një pune për personat që kanë imigruar.

Ne tashmë i kemi vënë në pah disa arsye pse imigrimi i femrave në zonat urbane mund të hasin vështirësi në gjetjen e punës, ose edhe

Grafiku 4.17 - Të punësuar sipas gjinisë, nivelit të arsimit dhe sektorit ekonomik: Shqipëria, 2001 (pjesa në %)



Burimi: Llogaritje në bazë të të dhënave të Regjistrimit të Popullsisë 2001

qëndrimin e klasës së mesme, bashkë me ato vështirësi, që mund t'i shkëpusin shtëpiaket nga tregu i punës. Në fakt, mes emigrantëve e afërt që kanë migruar gjatë dy viteve paraprirëse të studimit të MSJ të vitit 2002, të rinjtë do të merrnin pjesë në tregun e punës në një shifër më të lartë se femrat e tjera (Grafiku 4.20), por ato arrinin shifër më të lartë papunësie gjithashtu (deri në 100 për qind për vajzat e vogla). Gjithë femrat e moshës mesatare “lëvizëset”, kurdo që të ketë ndodhur migrimi, tregojnë një shkallë pjesëmarrjeje të fuqisë punëtore më të ulët sesa “qëndruesit”, dmth. Femrat jo migruese si dhe ato që kishin ardhur në zonat urbane para vitit

1990. Veçanërisht migruesit e moshës mesatare që migruan 2-6 vjet para studimit, kanë vlera pjesëmarrjeje të ulëta gjithashtu në moshat e tyre të mëdha që janë jashtë tregut të punës me më shumë se 1.5 në secilin prej grupmoshave.


Është gjithashtu me interes të shohim pjesën që u takon të punësuarve sipas eksperiencës së tyre migratore (Grafiku 4.21). Për meshkujt, çiftet që migronin, kryesisht linin bujqësinë për të shkuar në “shërbime të tjera” (që përfshijnë edhe administratën publike), “tregtinë me shumicë e pakicë”, por edhe kryesisht në “shërbime”, të ndryshme duke ruajtur në këtë mënyrë një prani të ulët në industri. Për femrat, largimi nga bujqësia është thujse inekzistent dhe sidoqoftë ndodh në favor të “prodhimit”, “arsimit”, “shëndetisë dhe punës sociale”, dhe “tregtisë”.

5. Tiparet e familjes


Familja në përgjithësi në Shqipëri karakterizohet nga një numër i madh anëtarësh, mesatarisht 4.2 anëtarësh, gati 2/3 e 727 mijë familjeve me katër apo më shumë anëtarë dhe, një e katërta e përqendruar në madhësinë prej 4 anëtarë. Përveç familjeve me 1-3 anëtarë, ku adultët dhe më të rriturit janë më të shumtë në numër, familjet duket të jenë ekuilibruar në strukturën e tyre të brendshme nga numri i madh i grupmoshave të cilave u përkasin anëtarët e tyre (Grafiku 4.22): rreth një e treta janë nën 15 vjeç. Moshë e punës (15-64 vjeç) është e pranishme në rreth 60% e numrit të përgjithshëm të anëtarëve (65.9% në familjet me 4 anëtarë, ndërsa anëtarët e moshuar përbëjnë 4-8% (2.8 në familjet me 4 anëtarë). Gati gjysma e familjeve me një person, formohen nga persona të moshuar dhe rreth një e pesta e familjeve me dy persona ndodhen në të njëjtën gjendje.

Grafiku 4.18 - Të punësuar sipas gjinisë, degës kryesore industrisë dhe nivelit të arsimimit : Shqipëria, 2001 (pjesa në %)

Të punësuar meshkuj



Të punësuar femra




Burimi: Llogaritje në bazë të të dhënave të Regjistrimit të Popullsisë 2001

Nga këto të dhëna mund të shikojmë përbërjen e brendshme të familjeve në lidhje me praninë e anëtarëve në një grup që ne e identifikuam si moshë e punës – 15-64 vjeç (Grafiku 4.23). Vetëm më pak se 5% e numrit të përgjithshëm të familjeve nuk kanë asnjë anëtar në moshë pune, gjysma e tyre duke qenë një familje me një anëtar dhe me dy anëtarë e gjysmë, sigurisht të formuara nga persona të moshuar. Në ekstremin tjetër kemi pak më pak se ¼ e familjeve të formuara nga

anëtarë në moshë pune, të cilët, sigurisht që ishin më të përqendruar familjejt e vogla.


E njëjta gjë ndodh me familjet ku vetëm një anëtar është në moshë pune (7.8% e numrit të përgjithshëm të familjeve). Më shumë se 1/5 e familjeve më të përhapura, dmth ato me 4 persona, formohen nga anëtarë prej 15-64 vjeç, ndërsa prania e vetëm një anëtarë në moshë pune është e kufizuar me 1.6%.

Grafiku 4.19 - Koefficienti i pjesëmarrjes në krahun e punës dhe koefficienti i papunësisë sipas gjinisë, grupmoshës dhe përvojës migratore: Shqipëria, 2002



N.B.: Migrantë= Persona që migruan gjatë ose pas 1990
 Jomigrantë= Persona që nuk migruan gjatë ose pas 1990;
 Burimi: Llogaritje në bazë të të dhënave të LSMS 2002

Grafiku 4.20 - Koefficienti i pjesëmarrjes në krahun e punës sipas gjinisë, grupmoshës dhe përvojës migratore: femra në zona urbane 2002




Burimi: Llogaritje në bazë të të dhënave të LSMS 2002

Ne, gjithashtu mund të llogaritim edhe raportin demografik të vartësisë, duke i konsideruar të gjitha familjet (raporti krudo) apo duke i përjashtuar familjet me asnjë anëtar në moshë pune (raporti neto) (Tabela 4.1, dy kolonat e para).


Raporti mesatar neto i anëtarëve 0.56% të moshës më pak se 15 vjeç, apo 65 vjeç e lart për çdo anëtar të moshës 15-64 vjeç është më i ulët në familjet që kanë 2-3 anëtarë dhe bëhet më i rëndë për familjet e mëdha, që ndoshta përshkruhen si familje të gjera, formuar nga më shumë se një bërthamë familjare dhe ku njerëzit që u përkasin brezave të ndryshëm jetojnë së bashku.

Grafiku 4.21 – Të punësuarit sipas gjiinisë, degës kryesore të aktivitetit ekonomik dhe eksperiencës migratore:
Shqipëria, 2002 (% share)

Të punësuar Meshkuj




Të punësuar Femra



Burimi: Llogaritje në bazë të të dhënave të LSMS 2002


Një moment tjetër i rëndësishëm është të shqyrtojmë sa anëtarë të familjes ishin në tregun e punës, si të punësuar aktualisht edhe si kërkues të punës (për herë të parë apo sepse e kishin humbur punën e tyre të mëparshme). Në vështrimin makro – ekonomik, këto përfaqësojnë ofertën e familjeve ndaj tregut të punës. Sipas metodës më mikro, ajo dëshmon nevojën e familjeve për të fituar të ardhurat e tyre përmes punës.

Grafiku 4.22 - Popullsia sipas madhësisë së familjes dhe grupmoshës: Shqipëria, 2001



Burimi: Llogaritje në bazë të të dhënave të Regjistrimit të Popullsisë 2001

Grafiku 4.23 - Familjet sipas numrit të anëtarëve në moshë pune (15-64 vjeç); Shqipëria, 2001



Burimi: Llogaritje në bazë të të dhënave të Regjistrimit të Popullsisë 2001

Tabela 4.1 - Popullsia në moshë pune sipas madhësisë së familjes: 2001

Madhësia e familjes	Koeficienti varësisë		Koeficienti bruto i varësisë		Koeficienti neto i varësisë	
	bruto (a)	neto (b)	bruto (a)	neto (c)	bruto (a)	neto (d)
1	0.96	-	2.28	-	2.45	-
2	0.49	0.19	1.65	0.41	2.06	0.48
3	0.32	0.31	0.89	0.76	1.42	1.05
4	0.52	0.52	1.08	1.05	1.66	1.51
5	0.65	0.65	1.35	1.31	2.03	1.84
6	0.74	0.74	1.52	1.49	2.32	2.07
7	0.72	0.72	1.51	1.48	2.38	2.15
8	0.66	0.66	1.42	1.39	2.37	2.19
9	0.66	0.66	1.38	1.36	2.44	2.24
10	0.68	0.68	1.33	1.32	2.5	2.3
11+	0.84	0.84	1.44	1.43	2.72	2.49
Gjithsej	0.58	0.56	1.28	1.28	1.94	1.94

Burimi: përpunimi i të dhënave të regjistrimit 2001

Legjenda

(a) Gjithsej familje

(b) Familje me asnjë anëtar në fuqinë punëtore të excluded

(c) Households with no member in the labour force excluded


(d) Households with no member employed excluded

Grafiku 4.24 tregon sa e fortë ishte kjo domosdoshmëri, sa kohë që në gjejmë familje me asnjë anëtar fuqi punëtore në vetëm 11% të totalit, thuhet të gjithë të përqendruar në familje me një apo dy persona. Por është me interes të shikojmë se dy të tretat e familjeve me tre apo më shumë anëtarë, kishin më shumë se një anëtar si fuqi punëtore dhe rreth 5% i kishin gjithë anëtar në këtë situatë. Familjet me vetëm një nga dy apo më shumë anëtarë në tregun e punës nuk janë pak, megjithatë, numërohen rreth 230 mijë apo një e treta e familjeve me dy apo më shumë anëtarë. Ata janë rreth 28% në familjet më të përhapura me 4 anëtarë.

Ngjashmërisht me shkallën demografike të vartësisë, në gjithashtu mund të llogaritim shkallën e vartësisë, duke pjesëtuar numrin anëtarëve jo aktivë të familjes me atë të atyre aktivë. Përsëri, kemi raporte bruto e neto, nëse përfshijmë apo jo familjet me asnjë anëtar si fuqi punëtore. Nga tabela 4.1, grupi i dytë i kolonave, kufiri mesatar i 1.28 anëtarëve jo aktivë shkon në rreth 1.5 (raporti neto) në familjet me 6 anëtarë, ndërsa ai është më i ulët sesa mesterja vetëm në familjet më të vogla se 5 anëtarë.

Në gjithashtu mund të vlerësojmë mospërputhjet në shkallën e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore sipas madhësisë së familjes. Në llogaritëm shkallën e aktivitetit si përsa i takon popullsisë në moshë pune (15-64-vjeç) apo duke konsideruar se një fuqi punëtore dekorative shkon përtej moshës 65 vjeç, sa i takon popullsisë prej 15 vjeç e lart, që përfshin gjithashtu një numër të personave të dalë në pension, që nuk kanë mundësi apo dëshirë të punojnë. Përveç familjeve të vogla (një apo dy anëtarë), ku shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore ulet nga prania e të moshuarve ndoshta gjithashtu sipas metodës 15-64-vjeç, pjesëmarrja në tregun e punës është thuhet konstant sa i takon madhësisë së familjes, me vetëm familjet shumë të mëdha (11 apo më shumë anëtarë) duke

Grafiku 4.24 - Familjet sipas numrit të anëtarëve në krah pune; Shqipëria, 2001



Burimi: Llogaritje në bazë të të dhënave të Regjistrimit të Popullsisë 2001

treguar një shifër shumë më të lartë se mesatarja. (Tabela 4.2, dy kolonat e para).

Kur konsiderojmë vetëm ata që “fitojnë bukën”, dmth anëtarët e familjes që aktualisht paguhen, gjendja përkeqësohet shumë. Familjet me vetëm një anëtar që punon e fiton janë 43% të familjeve kur ne përjashtojmë familjet me një anëtar. Ato familje me asnjë anëtar të punësuar përbëjnë 16% të numrit të përgjithshëm të familjeve, duke qenë 15% në ato me tre anëtarë dhe 5-7% në familjet më të


mëdha. (Grafiku 4.25). Në regjistrimin e vitit 2001, kishim rreth 47 mijë familje me asnjë anëtar, kur ne përjashtojmë familjet me një apo dy anëtarë ndoshta formuar nga persona të moshuar/në pension, si edhe, përveç familjeve me një person, ne kishim më shumë se 295 mijë familje (44% të familjeve me dy apo më shumë anëtarë) me vetëm një anëtar që punon, sukcesi apo dështimi i të cilëve në tregun e punës mund të shkaktonin suksesin apo dështimin e familjeve të tyre.

Tabela 4.2 – Pjesmarrja e fuqisë puntore, vlerat bruto të punësimit dhe papunësisë sipas madhësisë së familjes: Shqipëria, 2001

Madhësia e familjes	Shkalla e pjesmarrjes së fuqisë puntore		Vlera bruto e punësimit		Vlera e papunësisë
	% 15-64	% 15+	% 15-64	% 15+	% aktive
1	59.7	30.6	56.8	29.2	4.8
2	56.2	38.6	48.7	33.3	13.5
3	69.6	63.6	54.5	49.8	21.6
4	72.9	69.9	57.1	54.8	21.6
5	70.2	64.6	54.3	49.9	22.7
6	69	60.4	52.3	45.8	24.2
7	68.5	60.8	50.8	45	25.8
8	68.7	62.7	49.2	44.9	28.3
9	69.7	64.1	48.2	44.3	30.8
10	71.9	65.2	47.9	43.4	33.7
11+	75.6	64.1	49.6	42	36.4
Totali	69.5	62.1	53.8	48	22.7

Burimi: përpunimi i të dhënave të regjistrimit të popullsisë të vitit 2001.

Grafiku 4.25 - Familjet sipas numrit të anëtarëve të punësuar; Shqipëria, 2001




Burimi: Llogaritje në bazë të të dhënave të Regjistrimit të Popullsisë 2001

parasysh familjet me asnjë anëtar të punësuar, raporti i vartësisë lidhet pozitivisht me madhësinë e familjes, që shkon nga më pak se 0.5 në familje me dy persona, në rreth 2.5 tek familjet e mëdha.

Vlera e punësimit bruto është e lidhur në mënyrë më pak të qartë me madhësinë e familjes (Tabela 4.2, grupi i dytë i kolonave), me beqarët që ishin të detyruar të fitonin jetesën e tyre duke punuar, nëse nuk janë shumë të moshuar për të fituar një pension, ndërsa çiftet mund ta përballojnë jetesën me vetëm një që punon si dhe familjet me tre apo më shumë anëtarë me një vlerë bruto punësimi ndërmjet 48 në 57%. Vlerat më të larta i gjejmë te familjet me katër anëtarë, ndërsa vlera më e ulët te familjet me dhjetë persona që janë të pakta.

Grafiku 4.26 - Familjet sipas numrit të anëtarëve të papunë; Shqipëria, 2001



Burimi: Llogaritje në bazë të të dhënave të Regjistrimit të Popullsisë 2001

Në regjistrimin e popullsisë të vitit 2001, një e treta e popullsisë shqiptare përjetoj papunësinë tek një apo më shumë anëtarë të familjes kur përjashtojmë familjet e formuara nga persona vetëm të moshuar. Kjo kuotë lidhet qartësisht me madhësinë e familjes, që është më e ulët në familjet e vogla me një (3%) apo dy (12%) anëtarë, rreth një e treta e familjeve më të përhapura me 3-5 anëtarë, dhe deri në 2/3 në familjet e mëdha (Grafiku 4.26). Fatmirësisht, numri i familjeve me të gjithë anëtarët e tyre të papunë ishte i vogël (787), por kishte më shumë se 55 mijë familje me më shumë se një nga anëtarët e tyre që kërkojnë punë.

Shkalla e papunësisë, si përqindja e anëtarëve të papunë dalë nga totali i i anëtarëve aktivë, ndjek të njëjtin plan sipas madhësisë së familjes. (Tabela 4.2, kolona e fundit). Ai është nga 20 në 35% për familjet me 3 deri në 6 anëtarë, arrin në 36% për familjet e mëdha, ndërsa është dukshëm më e ulët se mesatarja 22.7 në familjet me një anëtar, që mezi arrijnë të mbijetojnë në rastin e papunësisë së gjatë të anëtarit të saj. Familjet me dy anëtarë përjetojnë një vlerë papunësie të menjëhershme prej 13.5%.

Nga këto të dhëna ne vlerësojmë gjithashtu edhe raportin ekonomik të vartësisë dmth. numrin e anëtarëve jo aktivë për çdo anëtar të punësuar, si në gjithë familjet duke u klasifikuar sipas numrit, apo edhe duke përjashtuar ato familje me asnjë anëtar të punësuar (Tabela 4.1, grupi i tretë i kolonave). Si mesatare, kishim gati dy anëtarë jo aktivë për çdo anëtar të punësuar. Kur nuk marrim

Kur bëjmë një përmbledhje të studimit lidhur me rezultatet e arritura nga përpunimi i aktivitetit të punës sipas madhësisë së familjes, vëmë re dy dukuri kryesore. Nga njëra anë, ato dëshmojnë vështirësitë që po kalojnë familjet shqiptare, nga ana tjetër, ato tregojnë sesi familjet e mëdha shqiptare shpesh ia dalin të zbusin vështirësitë në fjalë.

Nga pikëpamja e parë, në Tabelën 4.3 vëmë re se kur përjashtojmë numrin prej rreth 35 mijë familjesh (5% e totalit) formuar nga persona të moshuar, kemi 6.7% (rreth 82 mijë) të familjeve të mbetura me asnjë anëtar ekonomikisht aktivë dhe 12% (rreth 118 mijë) me asnjë anëtar të punësuar. Megjithëse përqendruar në familjet e vogla, kushti i mungesës së të ardhurave familjare nga puna, është i pranishëm në të gjitha llojet e familjeve, në minimum tek 5.3% i familjeve më të përhapura me 4 persona. Mundësia e pensionit para moshës 65 vjeç apo – ndoshta – të ardhurave nga familjarët e tyre që kanë emigruar jashtë mund të kenë lehtësuar kushtet për disa nga ato familje që deklaruan gjatë regjistrimit të 2001 se nuk kishin asnjë pjesëtar të familjes që punonte në shtëpi.

Edhe papunësia ishte mjaft e përhapur. 1/3 e familjeve me një apo më shumë në moshë pune e përjetonin këtë gjendje, që megjithatë ishte prezent në më pak se 3% e familjeve me 1 person dhe ngjitej progresivisht në më shumë se 66% tek familjet më të mëdha. Kjo gjendje e papunësisë vërtet kritike, ishte e kufizuar ndoshta tek 36% e familjeve (5.0%) ku anëtarët ekonomikisht aktivë ishin të gjithë në kërkim të punës. Në të gjitha rastet e tjera, megjithëse mjaft e përhapur tek familjet, papunësia mund të zbutet nga punësimi i anëtarëve të tjerë të familjes.

Siç edhe e vumë re më lart, kishte 305 mijë familje apo 44% të numrit të përgjithshëm të tyre, me të paktën 1 anëtar në moshë pune, që mund të mbështetej tek vetëm 1 anëtar që punonte, dhe që ishin vazhdimisht në risk të rënies në situata kritike që ne i përshkruam më lart, nëse i vetmi anëtar i tyre i punësuar pësonte ndonjë kthim pas në aktivitetin e tij/saj të punës. Kjo strukturë ekonomike familjare ishte gjerësisht e përhapur në të gjitha madhësitë e familjeve deri në ato me 5 anëtarë: është e qartë që ajo bie në familjet e mëdha sipas numrit të anëtarëve, megjithëse

Tabela 4.3 – Familjet sipas numrit dhe kushteve të punës: Shqipëria, 2001

Madhësia e Familjes	No i anëtarëve 15-64-vj (a)	Anëtarë jo aktivë(b)	Anëtarë të papunë (b)	1/ më shumë anëtarë të papunë(s) (b)	Vetëm 1 anëtar i punësuar (b)	2/më shumë anëtarë të punësuar (c)
1	49	40.3	43.2	2.9	56.8	-
2	19.9	33.6	39.5	12.4	39.5	31.1
3	0.3	6.8	14.8	31.4	50.9	37.8
4	0	1.8	5.3	35.3	49.5	45.9
5	0	1.5	6.3	36.4	43.4	50.7
6	0	1.2	7.5	39.1	37.5	55.2
7	0	1	6.9	43.5	31.3	62
8	0	0.9	5.6	50	26.8	67.7
9	0	0.9	5.7	56.2	22.5	71.9
10	0	0.4	5.8	63.6	18.7	75.5
11+	0	0.4	6.1	66.9	16.1	77.9
Totali	4.9	6.7	12	33.3	44.1	47.8

Legjenda:

(a) Nga totali i familjeve

(b) Nga totali i familjeve me anëtarë 15-64 vjeç

(c) Nga familjet me 2/më shumë anëtarë 15-64 vjeç

Burimi: përpunimi i të dhënave të regjistrimit të vitit 2001.

mbetet po aq e përhapur sa 1 në 7, edhe në familjet më të mëdha.

Gjejmë të njëjtën situatë të 2 apo më shumë anëtarëve të punësuar në gati të njëjtin numër familjesh (304 mijë), apo 48% të familjeve me të paktën 2 nga anëtarët e tyre në moshë pune. Kjo kuotë është e lidhur pozitivisht me madhësinë e familjes, ndoshta çiftet me të ardhura të përbashkëta që numërohen në 15 mijë. Në fakt, duke komentuar këtë gjendje në dukje më të sigurtë, duhet të kuptojmë se numri i familjeve të angazhuara tërësisht në punët e fermës, dhe kështu aktiviteti i tyre i punës është i lidhur me një burim unik pune dhe të ardhurash, dështimi i të cilit mund të shkaktojë probleme të njëjta apo edhe më të vështira për papunësinë urbane.

6. Konkluzione

Në ndjekje të qëllimeve të dyfishta të këtij kapitulli, së pari mund të shohim nëse analizat që kryem mbi pjesëmarrjen e fuqisë punëtore, punësimit dhe papunësinë sipas variablave demografikë dhe social-ekonomikë, e bënë gjendjen e tregut të punës në Shqipëri më të qartë. Së dyti, a është e mundur të japim ndonjë sugjerim për këto analiza për të ndihmuar bërësit e politikave dhe administratorët në planifikimin e ndërhyrjeve të tyre për të përmirësuar këtë situatë?

Megjithëse e shtrembëruar nga disa keq raportime, kryesisht për shkak të rregullave specifike aktivitetin e punës së rinjve, apo skemave për pensionistët, norma e punës së pjesëmarrjes së punës dhe punësimit, ndriçohet nga prania e një strukture tradicionale të dyfishtë tregu, me një bërthamë të fuqisë punëtore, kryesisht formuar nga meshkujt në moshë mesatare dhe një "periferike" që mbledh shumicën e femrave dhe meshkujve më të rinj se 30 vjeç apo më të mëdhenj se 55 vjeç. Ky është rezultat i

procesit të tkurrjes që preku sistemin prodhues shqiptar në lidhje me demokratizimin e vendit, ngjarjeve pasuese kaotike, tranzicionit në ekonominë e tregut, por simptomat e të cilit ishin thellësisht të rrënjësura në ekonominë autarkike dhe të prapambetur të regjimit të kaluar. Nevojat e familjeve mund të kenë favorizuar mashkullin në moshë mesatare që punonte, të ruante vendin e punës apo të gjente një të re. Kjo ndodhi kundrejt punësimit të femrave dhe të të rinjve, siç edhe tregohet nga vlerat e larta përkatëse të papunësisë dhe madje nga shifra e ulët e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore të femrave në çdo moshë, që ndoshta hoqën dorë nga tregu i punës për shkak të situatës së tij dekurajuese.

Ajo që po ndodh është humbja e një potenciali të madh forcash pune, kryesisht formuar nga të rinj, pritja e të cilëve për të hyrë në punë në një mënyrë të kënaqshme zgjat shumë gjatë, duke nxitur motivacionet e tyre për të emigruar jashtë. Ndoshta mund të jetë fakti që pajisja me punë dhe kërkesa nuk përputhen në ato moshë për shkak të ndryshimeve në cilësinë e ofruar dhe pyetur, si dhe dëshirat e kultivuara nga të rinjtë. Mësuesit dhe bërësit e politikave duhet të pyesin veten nëse arsimit i ofruar nga sistemi shkollor i përgjigjet me të vërtetë kërkesës prezente të tregut të punës dhe nëse ai është aq sa duhet i përditësuar lidhur me inovacionet e ardhshme në proceset prodhuese.

Në fakt, niveli i arsimit, doli të ishte një variabël jetik sa i takon punësimit dhe pjesëmarrjes së fuqisë punëtore, sidomos për femrat. Pasja e një grade universitare duket të jetë një avantazh në gjetjen dhe ruajtjen e punës në Shqipëri. Me këtë, duhet të kuptojmë se, megjithë rritjen e kufizuar të popullsisë një vend i pavarur ka nevojë të ketë strukturat e veta administrative dhe inteligjencës së vet. Personat me një gradë universitare ishin më pak se 150 mijë (80 mijë meshkuj dhe 55 mijë femra) sipas regjistrimit

të vitit 2001: më shumë se 70% e tyre ishin të punësuar, si meshkuj dhe femra. Personat me një diplomë të lartë sekondare ishin rreth 600 mijë, thuajse të ekuilibruar sipas gjinisë, por vlera e tyre e punësimit ishte pak më e lartë se mesataret respektive për meshkujt dhe femrat. Grada universitare dhe diplomat e larta sekondare, garantojnë megjithatë status pune, lloj pune, vend pune dhe orë pune më të qëndrueshme.

Problemi është se grupi i të rinjve duket se ka nivele më të ulëta të gradave universitare dhe diploma të larta sekondare. Duke qenë ky efekti i migracionit selektiv jashtë vendit, apo mundësisë së zvogëluar për të vazhduar studimet, ky përbën një bazë negative për zhvillimet e ardhshme ekonomike të vendit.

Ajo që gjetëm rreth lidhjeve mes punës dhe varibalave demografikë është krejtësisht normale, por ata duken të agravohen nga hapi i vështirë me të cilin ekonomia shqiptare po përballet. Siç edhe e përmendëm më lart, tkurrja e kërkesës për punë ka inkurajuar privilegjimin e punëtorëve, kështu që kryetarët e familjeve, si meshkuj edhe femra, të punësohen më shumë dhe të vuajnë nga papunësia shumë më pak se anëtarët e tjerë. E njëjta gjë ndodh me meshkujt e sapo martuar, dhe femrat e pa martuara. Femrat pa fëmijë e fitojnë vendin e punës të paktën tre herë më shumë se të tjerat.

Këto fakte, mund të interpretohen si reagim natyral i shoqërisë për të shpërndarë kërkesën e zvogëluar të punës tek popullsia përmes familjeve dhe rrjetit të familjes. Në fakt, ne gjetëm një situatë thuajse të ekuilibruar në familje sa i takonte punësimit dhe papunësisë. Dimensioi ende i madh i familjeve shqiptare ndoshta po ndihmon në zbutjen e mungesës së vendeve të punës, fakt nga i cili po vuan vendi. Megjithatë, ky aspekt pozitiv, po kundërpeshohet nga qëndrimi për një kohë të gjatë nga ana e shumë anëtarëve të varur nga familjet, që mbeten në kërkim të

punës, apo edhe nuk hyjnë në tregun e punës.

Megjithëse është e rrezikshme të preken ekuilibra të tillë, bërësit e politikave duhet të pyesin veten nëse është koha të favorizojnë (gjithashtu) punësimin e grupeve të reja, ndoshta në degët e reja të aktivitetit dhe mënyrat e punës. Kjo dë të modernizonte si strukturën ekonomike dhe rrjetin e familjes në vend, ashtu edhe atë pjesë të shoqërisë, e cila ka ende vështirësi në pranimin e ndryshimeve të ndodhura.

Aneksi 4.1

Veçantia e vlerave në grupmoshën specifike

Këto vlera të raportuara nga Grafiku 4.1 tregojnë të paktën dy pika veçantie, të cilat kërkojnë një analizë të mëtejshme dhe shpjegime të mundshme.

E para shfaqet nga mosha 19 në 20 vjeç dhe prek vlerat e punësimit me një rënie të menjëhershme (Tabela 4A.1.). Është mjaft e qartë në kurbën e grupit të meshkujve, por

të shpjegojë dot këto shifra të larta. Ushtarët e rekrutuar ishin vetëm 2,700 në moshën 19 vjeç dhe 1,850 në moshën 20 vjeç. Edhe “dalja” nga gjendja e studentit është veçanërisht e rëndësishme në atë moshë (rreth 500, si për meshkujt edhe për femrat), e cila sidoqoftë duhet të rrisë numrin e atyre që kërkojnë punë për herë të parë, jo të atyre që kërkojnë një punë të re.

Në fakt, ne duhet të hetojmë mbi arsyet e mundshme të shkallës së lartë të punësimit nga grup moshën 15-19 vjeç, arsye që duket se zhduken nga mosha 20 vjeç e lart. Procesi i hyrjes së re në punë aktualisht fillon gati rregullisht që në këtë moshë, por shumë larg nga procesi paralel i hyrjes në tregun e punës

Tabela 4A.1 - Ndryshimet e vlerave specifike të një grup moshe nga 18 në 22 vjeç, sipas gjinisë dhe situatës: Shqipëria, 2001 (ndryshimet në % të dala nga popullsia përkatëse sipas gjinisë)

Moshë (vite)	Meshkuj			Femra		
	Kërkojnë punë për herë të parë	Të punësuar	Kërkojnë punë të re	Kërkojnë punë për herë të parë	Të punësuar	Kërkojnë punë të re
Nga 18 në 19	-0.5	1.2	-0.1	0.6	4	0
Nga 19 në 20	-0.2	-32.8	37.2	-0.6	-9.4	9.5
Nga 20 në 21	-0.5	3.7	1.3	-0.6	0.3	1.6
Nga 21 në 22	-0.2	3	1.1	-0.4	0	2.6

Burimi: përpunimi i të dhënave të regjistrimit të vitit 2001.

është gjithashtu e pranishme edhe në atë të femrave. Vlera e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore nuk ndjek këtë rrugë: veçanërisht për meshkujt, ajo ngjitet ashtu siç pritet në këtë moshë hyrëse në tregun e punës.

Megjithëse të dhënat ndërseksionale nuk mund të lexohen në një perspektivë grupi, duhet të pyesim se çfarë ndodh mes moshave 19 dhe 20 vjeç për të justifikuar “pushimin” e rreth 9 mijë meshkujve të punësuar dhe rreth 3 mijë femrave të punësuar, të cilat në mënyrë të vazhdueshme janë mes atyre që kërkojnë punë të re, ndërsa ata që kërkojnë punë për herë të parë bien lehtë në numër. Ndërhyrja për meshkujt, e shërbimit të detyrueshëm ushtarak (që në Shqipëri zgjat 12 muaj dhe zakonisht ndodh në moshën 18 vjeç) nuk arrin

që fillon shumë më herët.

Karakteristikat e personave të punësuar që u përkasin grup moshave 15-19 dhe 20-24 janë krahasuar në tabelën 4A.2, duke treguar ndryshimet e rëndësishme në modelet përkatëse.

“Rëniet” më të mëdha janë raportuar mes rezidentëve në zonat rurale, që punojnë në bujqësi, si punëtorët për llogari të tyre dhe në punë të pjesshme më orë të gjata (15-34 orë në javë). Këto karakteristika janë më të dallueshme për femrat të cilat, gjatë kalimit nga mosha 15-19 dhe 20-24 vjeç, humbin aktivitetin e punës që është sezonal në fermën që është edhe shtëpia e tyre. Duke krahasuar ndryshimet mes këtyre dy grupmoshave sa i

Tabela 4A.2 - Disa karakteristika të të puntorëve të rinj sipas gjinisë dhe grup moshës: Shqipëria, 2001 (% e dalë nga popullsia përkatëse e punësuar)

Karakteristika	Meshkuj		Femra	
	15-19	20-24	15-19	20-24
Rezidenca: rurale	71.6	80	69.7	65
Sektori i aktivitetit: bujqësi	65.4	66.3	65.3	58.8
Statusi i punës: puntor	15.9	17.7	17.5	27.8
Statusi i punës: kontribues familjar	28.1	15.4	26.8	19.2
Vendi i punës: fiks, jashtë shtëpisë	23.5	23.8	25.3	34.1
Vendi i punës: ferma shtëpi	61	67.2	63	58.4
Lloji i punës: punë e përhershme	58.1	61.4	58.4	63.2
Lloji i punës: punë rastësore	6.7	3.6	5.4	3.2
Koha e punës: e plot (35 orë/më shumë)	42.1	51.2	39	44
Koha e punës: e pjesshme e shkurtër (më pak se 15 orë)	4.3	9.1	6.8	8.1

Burimi: përpunimi i të dhënave të regjistrimit të vitit 2001.

takon humbjes së punës së meshkujve e femrave respektive të punësuar, ne gjithashtu kuptojmë një raport zbritës më të lartë mes meshkujve që jetojnë në zonat urbane dhe punojnë në sektorin e shërbimeve, kryesisht në një vend pune jo fiks, në punë rastësore dhe punë të pjesshme të gjata.

Nga kjo pamje, është e qartë se nga grup moshë 15-19 vjeç, regjistrimi i vitit 2001 ka mbledhur një numër djemsh e vajzash jo plotësisht të punësuar në bujqësi apo shërbime. Për disa arsye që duhen hetuar më tej, ky lloj punësimi nuk konsiderohej plotësisht pas moshës 20 vjeç, duke prodhuar kështu një rënie të menjëhershme të shkallës së papunësisë, kryesisht për shkak të atyre që kërkojnë punë të re dhe që vijnë nga punë të mëparshme jo të sigurta.

Veçantia e dytë ndodh nga moshë 46 në 54 vjeç dhe duket se prek vetëm vlerat tek femrat (Tabela 4A.3). Aktualisht, edhe vlera e punësimit të meshkujve rritet lehtë herë këtu e herë atje gjatë këtij kufiri kohor, kur ne në fakt duhet të prisnim fillimin e daljeve të shpejta nga tregu i punës (disa, ndodhin vërtet nëse shikojmë shifrat e aktivitetit). Por kërcimi i vërtetë ndeshet nga moshë 45 në 46 vjeç për femrat, shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore të të cilave dhe shifra e punësimit rriten respektivisht me 23 dhe 24% pikë. Kjo

nënkupton – nëse i përdorim të dhënat ndër seksionale në metodën e grupeve – të shtojmë rreth 4 mijë punëtore femra, kur dimensionin e grupeve bie me 1 mijë dhe numri i punëkërkuësve mbetet gati konstant në më shumë se 3 mijë. Në fakt, rritja e punësimit të femrave nuk e zvogëlon papunësinë korresponduese. Punëtoret e “reja” femra duket se vijnë direkt nga grupi i femrave jo aktive në moshat e mëparshme, që zvogëlohet me rreth 5 mijë gjatë kalimit nga 45 në 46 vjeç.

Ekzistojnë shkaqe të ndryshme që mund të

Tabela 4A.3 - Ndryshimet e grup moshës nga 18 në 22 vjeç, sipas gjinisë dhe gjendjes: Shqipëria, 2001 (ndryshimet në % të dala nga popullsia përkatëse sipas gjinisë)

Moshë (vjeç)	Meshkuj		Femra	
	Pjesëmarrja e fuqisë punëtore	Punësimi	Pjesëmarrja e fuqisë punëtore	Punësimi
44 në 45	-0.2	0	0.4	1
45 në 46	-0.1	0.5	22.7	23.8
46 në 47	-0.3	0	-0.3	0.6
47 në 48	0	0.3	-0.6	-0.5
48 në 49	-0.5	-0.5	-1.3	-0.8
49 në 50	0.1	0.5	0.5	1.3
50 në 51	-0.3	-0.3	-0.5	1.4
51 në 52	-0.4	-0.2	0	1.6
52 në 53	-0.1	0.3	-0.4	1
53 në 54	-0.6	-0.7	0.7	2.5
54 në 55	-14.1	-14.1	-56.9	-52.7
55 në 56	-2.7	-2.6	-6.4	-4.8

Burimi: përpunimi i të dhënave të regjistrimit të vitit 2001.

çojnë drejt këtij rezultati, nisur nga fakti se regjistrimi ka qenë korrekt. Pika e fundit duket se konfirmohet nga zgjerimi i fenomenit në vend, me ndryshime të mëdha ndërmjet grup moshave 40-45 vjeç dhe 46-49 vjeç në rrethet rurale. Megjithatë, nga rezultatet e regjistrimit ne vetëm mund të konfirmojmë se femrat e moshës 46-54 vjeç, deklaruan se ato ishin të punësuar në kohën e regjistrimit në shifra më të larta se ato të grupmoshave më poshtë dhe më lart nga ato: nuk kemi asnjë mënyrë për të kontrolluar vërtetësinë e deklaratave të tyre, as arsyet e ndryshimeve që ekzistojnë.

Në teori, fenomeni mund të vijë nga “efekti i grupit”, femrat e moshës 46 vjeç e lart të qena në të 30 – në mes të jetës së tyre në punë – në kohën kur punësimi i femrave ishte shumë i përhapur: nëse ne pranojmë se ato ia arrijnë ta ruajnë aktivitetin e tyre të punës, shkalla e punësimit të re mund të jetë më e lartë sa i takon grupit ndjekës, që kanë gjetur një situatë shumë më të keqe në përballjen me tregun e punës në tranzicion. “Efekti moshë” gjithashtu mund të propozohet, për shkak të liritimit të zakonshëm nga shumë angazhime penguese familjare, apo për shkak të një përzgjedhjeje që favorizon femrat punëtore me eksperiencë (dhe në moshë) tek investitorët e huaj në vend për fabrikat e tyre. Sidoqoftë, asnjë arsye nuk mund të shpjegojë

kapërcimin e menjëhershëm të pjesëmarrjes së fuqisë puntore dhe shifrave të punësimit nga moshë 45 në 46 vjeç, dhe as rënies së mprehtë korresponduese në moshën 54 vjeç, kur aktualisht ndodh dalja masive në pension e femrave, sipas rregullave aktuale të daljes në pension.

Edhe në këtë rast, krahasimi i karakteristikave në grupmoshat e afërta mund të na ndihmojnë të nxjerrin grupin e femrave që duket se patën një punë kaq vonë në jetën e tyre. Megjithatë, sa kohë që “kapërcimi” ndodh në moshën 46 vjeç, ne preferuam të formojmë një grup-moshë 46-49 vjeç, krahasuar me atë 40-45 vjeç dhe pasuesen 50-54 vjeç, duke ndriçuar kështu ndryshimet e moshave përkatëse në karakteristikat për moshat më të interesuara për fenomenin. (Tabela 4A.4).

Duket mjaft qartë se femrat e “sapo punësuar” jetonin kryesisht në zonat rurale, ku ato të sapomartuarat kishin nivel të ulët arsimit. Nga pikëpamja e aktivitetit të punës që ato pretendonin të kryenin duket se mbizotërojnë apo janë ekskluzivisht në bujqësi, kryesisht në fermë që ishte shtëpia e tyre apo pa ndonjë vend fiks, si punëtorë për llogari të tyre apo kontribues familjarë. Gjithashtu mënyrat sesi kryhej aktiviteti sugjeronin një angazhim të kufizuar nga ata:

Tabela 4A.4 - Disa karakteristika të femrave të punësuar të moshës 40-59 vjeç, sipas grup moshës: Shqipëria 2001 (% e dalë nga numri i femrave të punësuar)

Karakteristikat e grave apo punës	40-45	46-49	50-54	55-59
Rezidenca: Rurale	48.2	57.8	62.9	88.8
Giendia civile: Aktualisht të martuar	88.3	90.7	89.9	93.5
Niveli i arsimit: Diplomë sekondare apo më e ulët	45.9	56.9	72.9	91.6
Sektori i aktivitetit: Bujqësia	41.5	52.2	60.9	87.5
Statusi i punës: Puntor	45.1	38	26.7	8.2
Statusi i punës: Kontribues familjar	10.2	18.1	24.7	32.1
Vendi i punës: fiks, jashtë shtëpisë	53.7	45.5	35	15.3
Vendi i punës: ferma shtëpi	41.9	44.4	50.7	66.5
Lloji i punës: punë e përhershme	76	71.5	64.4	57.7
Lloji i punës: punë rastësore	1.5	4.1	6.2	7.4
Koha e punës: e plot (35 orë/më shumë)	58.9	57.2	48.8	47.7
Koha e punës: e pjesshme e shkurtër (më pak se 15 orë)	6.7	3.9	2.8	4.3

Burimi: përpunimi i të dhënave të regjistrimit të vitit 2001.

Gjetjet kryesore

- Distanca e konsiderueshme ndërmjet kurbave të punësimit dhe të meshkujve aktivë, dëshmon vështirësinë për meshkujt e moshës së re në hyrjen me sukses në tregun e punës.
- Forma e kurbave të femrave tregon vështirësinë që kishin ato në gjetjen apo ruajtjen e një vendi pune në kohën e regjistrimit të vitit 2001.
- “Hyrjet e reja” në tregun e punës ndodhin deri në moshën 30 vjeç, si për meshkujt edhe për femrat: pas kësaj moshe, boshllëku mes “pajisjes me punë” dhe “kërkesës për punë” është thujse ekskluzivisht falë kërkuesve të një pune të re.
- Rënia e madhe e punësimit ka ndodhur nga vitit 1989 në 2001: meshkujt në moshën më të madhe (40-49; më shumë se 50) dhe femrat me shumë se 50 ruajtën vlerat e mëparshme të punësimit, ndërsa në nivelin e moshës më të re, (15-19) punësimi i meshkujve është rritur kudo, ndërsa ai i femrave vetëm në kontekstin urban.
- Rreth 70-80% e meshkujve të fuqisë punëtore të moshës 20-24 vjeç kërkonin punë në zonat urbane, ndërsa papunësia tek femrat ishte rreth 40-60.
- Moshë më e vogël e meshkujve që hyjnë në tregun e punës është 17.8 vjeç, ndërsa ajo e moshës së mesme dhe modale është nominalisht 15. Mesatarja e meshkujve për të dalë nga tregu i punës është 59.6 vjeç, ndërsa ajo mesatare dhe modale në daljen nga ky treg është respektivisht 59.2 dhe 59.5; mesatarja e kohëzgjatjes së pranisë në tregun e punës mund të vlerësohet në 41.8 vjet.
- Meshkujt që nuk janë martuar asnjëherë përjetojnë vlera më të larta papunësie (persona të papërshtatshëm për punë gjenden më shpesh mes meshkujve që nuk janë martuar asnjëherë), ndërsa e kundërta ndodh me femrat asnjëherë të martuara deri në moshë të vjetër (më pak angazhime në familje dhe me fëmijët e ruajnë nevojën e tyre të fortë për të fituar jetësën përmes punës); femrat aktualisht të martuara vuajnë shifra të larta papunësie, sidomos në zonat urbane.
- Roli qendror i personit të referencës në familje ndriçohet nga niveli i tij/i saj i ulët i papunësisë
- Mesatarja e numrit të anëtarëve të familjes është 4.2: rreth 33% janë nën 15 vjeç; moshë e punës 15-64 është e pranishme në rreth 60% dhe anëtarët e moshuar janë 4-8%
- Shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore nuk duket të preket shumë nga numri i fëmijëve, por shifra bruto e punësimit është më e lartë për femrat pa fëmijë.
- Personat pa diplomë hasin vështirësi serioze në gjetjen e një punë; 60% të femrave dhe meshkujve të punësuarpa diplomë ose me diploma deri të nivelit të ulët sekondar kanë një punë të përhershme, ndërsa kjo kuotë është gati 70% për ata me diplomë të nivelit të lartë sekondar dhe 85% për meshkujt me një gradë universitare.
- Personat e punësuar me nivel të ulët arsimimi janë kryesisht të punësuar në sektorin bujqësor, ndërsa punëtorët me një gradë universitare punojnë në sektorin e shërbimeve. Një e treta e meshkujve pa diplomë dhe një e katërta e femrave pa diplomë punojnë në sektorin e shërbimeve (psh, pastrues rrugësh, roje, shërbyes, etj.). Punëtorët me një gradë universitare, janë gjerësisht të pranishëm në degët kryesore të industrisë, në shërbimet e arsimit, në administratën publike, në shëndetësi dhe në punët sociale
- Duke krahasuar shifrat e pjesëmarrjes së

fuqisë punëtore të personave të emigruar pas Janarit 1990 me ata të emigruar para vitit 1990 (apo që nuk kanë migruar asnjëherë) duket qartë se nuk ka ndryshime të mëdha të raportuara rreth pjesëmarrjes së meshkujve, ndërsa ekziston një pjesëmarrje e konsiderueshme e ulët e fuqisë punëtore për femrat që kishin migruar pas Janarit të vitit 1990.

- Madhësia mesatare e familjeve shqiptare është 4.2 anëtarë. Familjet duket se janë mjaft të ekuilibruara sa i takon strukturës së tyre të brendshme; rreth 1/3 janë nën 15 vjeç, moshë e punës (15-64 vjeç) është e pranishme në 60% të numrit të përgjithshëm të anëtarëve dhe atyre të moshuar, thuajse gjysma e familjeve me 1 anëtar formohen nga të moshuar, dhe 1/5 e familjeve me 2 persona janë në të njëjtën situatë.

- Përbërja e familjeve sa i takon praninë të anëtarëve në moshë pune (15-64) vjeç karakterizohet nga këto fakte: më pak se 5% e numrit të përgjithshëm të familjeve nuk kanë asnjë anëtar në moshë pune (gjysma e familjeve me 1 anëtar dhe gjysma me 2 anëtarë) dhe formohen nga anëtarë të moshuar; më pak se ¼ e numrit të përgjithshëm të familjeve e përbërë vetëm nga anëtarë në moshë pune, që janë të përqendruar më shumë në familjet e vogla.

- Përveç familjeve më të vogla (1 apo 2 anëtarë) ku numri ulet nga prania e anëtarëve të moshuar, shifra e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore sipas madhësisë së familjes tregon se pjesëmarrja në tregun e punës është thuajse konstante sa i takon madhësisë së familjes, me vetëm familjet e mëdha (11 apo më shumë anëtarë) që kanë një vlerë më të lartë se mesatarja.

- Në regjistrimin e vitit 2001, kishim 47 mijë familje me asnjë anëtar të punësuar dhe 295 mijë familje me vetëm një të punësuar, që ishte në rrezik të rënies në situatë kritike nëse

i vetmi anëtar i punësuar në familje pësonte ndonjë kthim pas në aktivitetin e tij/saj të punës. Ato ishin 43% e familjeve kur përjashtonim familjet me 1 anëtar.

- Papunësia ishte mjaft e përhapur. 1/3 e familjeve me një apo më shumë në moshë pune e përjetonin këtë gjendje, që megjithatë ishte prezent në më pak se 3% e familjeve me 1 person dhe ngjitej progresivisht në më shumë se 66% tek familjet më të mëdha. Numri i familjeve me gjithë anëtarët e punësuar ishte shumë i vogël 787, teksa kishte 56 mijë familje (7.7%) me më shumë se 1 anëtar të papunë, si dhe më shumë se 36 mijë familje (5.0%) ku anëtarët ekonomikisht aktivë ishin të gjithë në kërkim të punës.

5

***Komente përfundimtare
dhe propozimet e
politikave*****1. Hyrje**

Në këtë kapitull përfundimtar, në vend të nxjerrim gjetjet kryesore që arritëm përmes përpunimit të të dhënave të regjistrimeve të popullsisë 2001 dhe 1989 dhe studimit të LSMS të vitit 2002, është e preferueshme të japim disa komente të përgjithshme të cilat janë të dobishme për të kuptuar situatën aktuale të tregut të punës në Shqipëri, si edhe për planifikimin e ndërhyrjeve për trajtimin e problemeve përkatëse.

**2. Popullsia e re përkundrejt
punëtorëve të moshuar**

Më shumë se gjysma e popullsisë është nën 29 vjeç: popullsia 0-14 vjeç përbën 29% të numrit të përgjithshëm të popullsisë, ndërsa popullsia 15-29 vjeç përbën 24%. Popullsia e moshuar, 65 vjeç e lart, është ende pakicë: 7.5%. Për rrjedhojë, sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2001, çdo personi në moshë pune i përkiste 0.58 persona jashtë intervalit të moshës së punës, dmth. një raport i favorshëm vartësie që normalisht nuk do të ndryshojë në mënyrë domethënëse në vitet e ardhshme. Madje raporti mund të bjerë për

shkak të uljes të niveleve të lindshmërisë. Ky fakt konsiderohet i favorshëm nga raporti mbi « Gjendjen e popullsisë botërore për vitin 2003 » i UNFPA, që pretendon se « një dritare demografike » hapet kur proporcionet e popullsisë në moshë pune (15-60 vjeç) rriten relativisht në krahasim me atë të « moshave në vartësi » (0-15 vjeç dhe 60 vjeç e lart) « me investimet e duhura në shëndetësi dhe arsim, si dhe politika ekonomike dhe qeverisje të favorshme, vendet mund të mobilizojnë potencialin e tyre rinor dhe të nisin një transformim social ekonomik. Dritarja demografike do të mbyllet kur moshja e popullsisë dhe vartësia rriten përsëri ». (UNFPA, 2003.5)

Në grupmoshën e punës nga 15-64 vjeç, çdo të rrituri i cili është në gjendje të punojë (40-64 vjeç) i përket 1.5 të rinj në moshë pune (15-39 vjeç). Ky raport ka mundësi të ulet shpejt në vitet e ardhshme për shkak të hyrjes së të rinjve në moshën e punës dhe kalimit të më të mëdhenjve në grup moshën 40-64 vjeç, duke shkaktuar kështu plakjen e potencialit të punës. Megjithatë, ne nuk mund të marrim me mend efektin e emigracionit aktual e atë të ardhshëm mbi këto priroje.

Megjithë “defiçitet” e mëdha të krijuara gjatë dekadës së fundit të emigracionit të fuqisë punëtore dhe plakjes së vazhdueshme saj



potenciale, Shqipëria ende ka një potencial të ri demografik për t'u mbështetur në vitet e ardhshme për zhvillimin e saj ekonomik.

Kjo strukturë kaq e re e popullsisë nuk pasqyrohet plotësisht tek fuqia punëtore në vend dhe sidomos në popullsinë e punësuar që kontribuon në prodhimin kombëtar dhe që siguron përmes aktivitetit të saj ekonomik mirëqënien për të gjithë popullatën. Në Tabelën 5.1, moshën mesatare të popullsisë së punësuar është më e lartë se moshën mesatare të popullsisë, të cilës i referohet tabela, por me përjashtim të grupit moshës 15 vjeç e lart. Kur kufizojmë periudhën e moshës sipas kushteve reale të tregut të punës (20-59 vjeç për meshkujt dhe 20-54 vjeç për femrat) dhe nuk marrim në konsideratë gjendjen e paqartë të punës së shumë adoleshentëve, mund të kuptojmë plotësisht zhvendosjen e moshës që fuqia punëtore e punësuar përjeton në lidhje me popullsinë së cilës i përket.

Sic e vumë re në Kapitullin IV, kjo ndoshta është rrjedhojë e efektit të brezave (kohort) që i mban si të punësuar punëtorët e brezave më të vjetër, që ruajtën vendin e punës në një treg pune që tkurrej kundrejt hyrjes së brezave të rinj. Për më tepër, megjithëse jo hapur, meshkujt e brezave më të vjetër që punonin, mund të jenë favorizuar kur punësoheshin, siç edhe konfirmohet indirekt nga dalja e madhe e femrave nga puna, për të mbetur ekonomikisht jo aktive ose të papuna (vëreni moshën mesatare të lartë të femrave që kërkojnë punë të re). Një arsye e tretë për plakjen e popullsisë së punësuar gjendet edhe tek struktura e prapambetur e

ekonomisë shqiptare, ku mbizotërojnë gjerësisht ferma të mbijetesës, duke konsideruar si të punësuar personat e moshuar që ende nuk mund të gëzojnë pension për kategorinë e tyre.

Këto zgjedhje, së bashku me emigracionin, i mundësuan mbijetesën familjeve shqiptare. Por problemi qëndron në mosshfrytëzimin e një pjese të madhe të potencialit të punës, kryesisht ndër të rinjtë, që presin për kohë të gjatë për një punë të kënaqshme, duke përforcuar kështu iniciativën për emigracion të mëtejshëm.

Duke qenë se kjo prirje ka zgjatur për më shumë se 10 vjet, një numër i rëndësishëm personash të punësuar jo plotësisht, të papunë apo edhe jashtë tregut të punës, është grumbulluar në brezat e rinj, që për këtë arsye mund ta kenë të vështirë të bëhen të pavarur dhe të formojnë bërthamën e tyre familjare. Ndoshta ka ardhur koha të tërheqim vëmendjen e politikave ndaj këtyre brezave, përndryshe Shqipëria rrezikon të ketë "një brez të humbur" të ekonomisë së saj, kryesisht e përbërë nga persona të lindur në vitet 70'.

Për shkak të ndryshimeve të thella të nevojshme në strukturën prodhuese, politika të tilla nuk mund të arrihen duke favorizuar të ardhurat ndërmjet brezave më të rinj dhe të vjetër në punë ekzistuese. Novacionet në degët e ekonomisë, mallrat e proceset, duhet të ndiqen duke mbështetur iniciativat e reja vendase dhe të huaja që mund të përfshijnë brezat e rinj, madje edhe më të rinjtë që shfaqen tani në tregun e punës.

Tabela 5.1 - Moshën mesatare të popullsisë së punësuar sipas gjendjes së punës: Shqipëria, 2001

Gjendja e punës	Meshkuj			Femra			Totali		
	15+	15-64	20-59	15+	15-64	20-54	15+	15-64	20-59/20-54
Të punësuar	37.9	37.8	40	35.6	35.5	37.7	37.1	36.9	39.2
Punë kërkuar i ri	27.8	27.8	27.8	35.4	35.4	35.2	31.9	31.9	31.8
Punë kërkuar	21.3	21.3	24.7	21.1	21.1	24.2	21.2	21.2	24.5
Totali i popullsisë	39.7	36	37.7	39.6	35.4	35.4	39.7	35.7	36.6

Burimi: përpunimi i të dhënave të regjistrimit të vitit 2001.

3. Një kapital njerëzor i pashfrytëzuar dhe i përkeqësuar

Shqipëria gëzon një nivel të mirë arsimor të popullsisë së vet. Një e treta e popullsisë mbi 14 vjeç, dmth moshë aktuale e mbarimit të arsimit të detyruar ka një diplomë të arsimit të lartë ose të atij të mesëm. (Tabela 5.2). Kjo kuotë shkon në mbi 5-% ndër meshkujt e lindur në vitet 50' dhe arrin 45% ndër femrat e lindura në fillim të viteve 70'. Në zonat urbane ky raport është rreth 2/3 në shumicën e brezave të lindur ndërmjet viteve 50' dhe 75', si për meshkuj edhe për femra, duke siguruar kështu një ofertë të një niveli potencialisht të lartë në tregun lokal të punës. Raporti pak më i ulët i meshkujve të lindur në fund të viteve 60' dhe fillim të viteve 70' vjen ndoshta nga procesi i migracionit të viteve 90'.

Siç e vumë re në Kapitullin IV, paisja me një diplomë universitare u garanton meshkujve edhe femrave gjetjen e një pune, ndërsa diplomat shkollës së mesme japin më shumë mundësi në gjetjen e një pune në krahasim me nivelet më të ulëta të arsimit. Gjithashtu, vihet re se ka një diferencë midis llojit, cilësisë së diplomave dhe kërkesës aktuale për punë. Disa kualifikime të vjetëruara kryesisht të lidhura me strukturat politike apo/edhe prodhuese të regjimit të mëparshëm, mund të kthehen në pengesa në kryerjen e punëve për arsye të papërshtatshme të njohurive teknike.

Megjithatë, një potencial i madh i kapitalit njerëzor mbetet i pashfrytëzuar, sepse ka më shumë se 200 mijë persona, apo një e treta e atyre që kanë një nivel të lartë arsimit (universiteti apo shkolle të mesme), që janë të pa punësuar apo jashtë tregut të punës, megjithëse janë në moshë pune. Kjo kuotë është më e lartë për brezat e rinj për të dyja gjinitë dhe e kapërcen 50% për femrat e lindura që në 1965.

Tabela 5.2 - Diplomat universitare dhe dëftesat e shkollës së mesme sipas gjinisë, vendodhjes dhe grupmoshës: 2001

(% sipas popullsisë përkatëse)

Grup-Moshë	Vendi			Zonat Urbane		
	Meshkuj	Femrat	Gjithsej	Meshkuj	Femrat	Gjithsej
15-19	13.5	14.7	14.1	20.2	25.1	22.7
20-24	32	35.7	33.9	52.1	60.8	56.8
25-29	42.9	45.5	44.2	60.6	68	64.7
30-34	46.5	43.9	45.2	64.2	68.1	66.3
35-39	49.1	42.2	45.6	66.3	66.9	66.6
40-44	52.3	42.5	47.4	69.5	67.5	68.5
45-49	53.1	40.9	47.1	71.7	63.6	67.7
50-54	46.2	27.5	37.1	67.1	49.2	58.4
55-59	33.9	15.7	25.1	56.5	31.5	44.2
60 vjeç e lart	22.9	7.1	14.7	42.1	14.9	28
më pak se 15 vjeç	37.2	30.1	33.6	55.3	49.6	52.4

Burimi: përpunimi i të dhënave të regjistrimit 2001.

Për më tepër, nga tabela 5.2 kuptojmë se grup moshë 25-29 vjeç në regjistrimin e vitit 2001 duket se ka arritur një nivel arsimit më të lartë në krahasim me grup moshën 20-24 (rreth 10 % si për meshkujt ashtu edhe për femrat). Ngjarjet e viteve 90', ndikuan negativisht në arsimimin e tyre. Edhe çrregullimi i tregut të punës mund të ketë stimuluar që personat të gjenin punë menjëherë, në vend që të përkushtoheshin ndaj studimit. Së fundmi, nevojat familjare mund të kenë kërkuar një fitim më të shpejtë të kontributeve të të ardhurave edhe nga anëtarët e tyre të rinj, duke kufizuar kështu shanset e tyre për të ndjekur studimet.

Brezat që kanë lindur në fund të viteve 70' dhe më pas rrezikojnë të kenë nivel më të ulët arsimor të fuqisë punëtore. Kjo i bën ata të papërshtatshëm përballë sfidave që do të krijohen në tregun e punës. Do të ishte me vend që hartuesit e politikave, organizatat ndërkombëtare në vend, OJF-të dhe punëdhënësit vendas dhe të huaj, të investonin para në fusha caktuar për këto grupe me qëllim që t'u japin atyre një përgatitje të dobishme për t'u punësuar në degët e industrisë. Rishikime duhen bërë edhe në kurrikulat për të përgatitur brezat e ardhshëm që të përballojnë më mirë nevojat e tregut në transformim të punës.



4. Një strukturë prodhuese që duhet modernizuar

Gjysma e fuqisë punëtore në vend punon ende në bujqësi, që është e organizuar kryesisht në ferma të vogla. Një e shtata (e papërfillshme) e fuqisë punëtore është në sektorin e industrisë, gjerësisht në ndërtim apo në aktivitete industriale, që i mbijetuan krizës ekonomike. Më shumë se një e treta është në sektorin e shërbimeve, që përmbledh shërbime të nivelit të lartë dhe modern, si edhe aktivitete të veçanta të nivelit të prapambetur. Sektori informal mendohet të jetë rreth 1/3 e shifrës së përgjithshme të punësimit, megjithëse nuk ka studime të veçanta në këtë fushë.

Nëse përpiqemi të krahasojmë gjendjen aktuale të strukturës së ekonomisë shqiptare të konturuar nga konfiguracioni i punësimit të vendeve të Evropës Lindore, duhet të kthehemi pas në vitet 50' për të gjetur një prani kaq të madhe në bujqësi, ndërsa kuota e popullsisë të punësuar në shërbime është thuajse si ajo e regjistruar në fillim të viteve 90'.

Procesi i modernizimit që do të prek Shqipërinë në vitet vijuese duhet të përgjysmojë punësimin në bujqësi, të dyfishojë punësimin në industri dhe t'a

zgjerojë sektorin e shërbimeve inflacion. Me këto ndryshime, struktura prodhuese shqiptare do t'i afrohej strukturës mesatare të vendeve të Evropës Lindore në 1980, por me një zhvendosje prej një të shtatës të fuqisë punëtore nga sektori i industrisë në atë të shërbimeve.

Megjithatë, nëse struktura e ardhshme ekonomike e vendit do të bazohet kryesisht në aktivitetin e grupeve të reja, ajo që lexuam në Tabelën 5.3 e errëson perspektivën. Brezat e rinj rezultojnë se janë të punësuar në bujqësi, në një përqindje më të lartë se sa brezat parardhës. Ata janë të pranishëm në të dy sektorët "modernë" në një përqindje më të ulët, duke dëshmuar kështu një proces regresiv i njëjtë me atë që ndodhi në vitet 90'. Punësimi i tyre në bujqësi, sektor ky që mundëson punësim të pjesshëm më shumë se sektorët e tjerë, kompenson mungesën e vendeve të punës që ka karakterizuar tranzicionin ekonomik.

Ky fakt kufizon ndjeshëm shpresat për një ndryshim strukturor të shpejtë të sistemit prodhues shqiptar. Kjo grup moshë përfaqson kandidatët më të mirë për emigrimin masiv jashtë vendit pasi vazhdon të punojë për një kohë të pjeshme në bujqësi dhe është e përgatitur psikologjikisht të zhvendoset në aktivitete të tjera.

Tabela 5.3 - Të punësuarit sipas gjinisë, grup-moshës dhe aktivitetit ekonomik: 2001

(% e të punësuarve sipas gjinisë dhe grup moshës)

Grup-moshat	Meshkuj			Femra			Gjithsej		
	Bujqësi	Industri	Shërbime	Bujqësit.	Industri	Shërbime	Bujqësi	Industri	Shërbime
15-19	65.4	10	24.6	65.3	11.4	23.3	65.4	10.6	24
20-24	66.3	10.9	22.8	58.8	12.2	29	62.2	11.6	26.2
25-29	55.5	13	31.5	48.8	11.3	39.9	52.7	12.3	34.9
30-34	48.2	14.9	37	46	12.2	41.7	47.4	14	38.6
35-39	44.7	16.7	38.6	45.2	13	41.8	44.9	15.5	39.6
40-44	41.3	18.2	40.6	41.5	12.6	45.9	41.4	16.4	42.2
45-49	38.9	19	42.1	52.2	8.2	39.7	44.1	14.8	41.1
50-54	41.1	17.3	41.7	60.9	7.9	31.2	49.4	13.3	37.3
55-59	49.3	15.4	35.4	87.5	2.1	10.4	56	13	30.9
60-64	63.3	10.4	26.2	92.1	1.6	6.3	72.7	7.6	19.7
65+ years	68.2	8.3	23.5	69.5	8.3	22.2	68.6	8.3	23.1
15+ years	48.5	15.5	36	54	10.7	35.3	50.6	13.7	35.7

Burimi: përpunimi i të dhënave të regjistrimit 2001.

Edhe njëherë, shqetësimet specifike dhe ndërhyrjet duhen rezervuar për ata të rinj që planifikohen të ndjekin programme punësimi emigrator. Në këtë kontekst duhen nënshkruar marrëveshje me vendet pritëse të emigrantëve.

5. Shqetësimet dhe shpresat për të ardhmen

Analiza e perspektivës së brezave hodhi dritë mbi krizën e thellë të përjetuar nga gjeneratat e reja shqiptare për sa i takon punësimi dhe aktivitetit të tyre ekonomik.

Siç edhe e vumë re në Kapitullin III, popullsia në moshë pune do të rritet. Kjo do të ndodhë gjatë dhjetë viteve të ardhshme për shkak të hyrjes së grupeve relativisht massive, lindur në 1980, dhe mbetjes së grupeve të mëdha të lindura pas Luftës së Dytë Botërore. Procesi i plakjes do të ndodhë si për popullsinë në përgjithësi ashtu edhe për atë në moshë pune. Politikat e mirëqënies do të marrin në konsideratë problemet e qëndrueshmërisë së skemave të pensionit ndërsa qëndrimi i brezave të vjetër në vendet e lakmueshme të punës do të pengojë përfshirjen e brezave të rinj në to.

“Bonusi demografik” që krijoi tranzicionin e menjëhershëm në moshë pune të një brezi përbërë nga shumë persona rrezikon të të shumfishojë problemet e tyre të punësimit, në vend që ta inkurajonin ekonominë shqiptare drejt modernizimit dhe zhvillimit të saj. Vetëm inisiativat shumë dimensionale në degët intensive të punës, mund t’i lehtësojnë këto probleme.

Sidoqoftë, këto probleme nuk rrjedhin vetëm nga proceset demografike. Kur marrim në konsideratë se tregu i punës në Shqipëri duhet të punësojë rreth 300 mijë punëtorë dhe ndoshta edhe 100 mijë punëtorë potencialë

dhe se bujqësia duhet të largojë nga sektori i saj të paktën 250 mijë punëtorë, e kuptojmë se duhet ngritur një treg i ri pune, që të jetë i aftë të krijojë 500-700 mijë vende pune, dmth. gati të dyfishojë kërkesën aktuale për punë. Kjo sfida mund të duket e pakapërcyeshme dhe ajo mund të jetë e tillë vërtet nëse i lihet vetëm forcave të tregut të lirë. Gjithashtu duhet të konsiderojmë dhe faktin se forca e re e punës e gatshme për të hyrë në tregun e punës po përkeqëson cilësisinë e vet si nga pikëpamja e eksperiencës së punës ashtu edhe të nivelit arsimor. Joshja e investitorëve të huaj për ta transferuar inisiativën e tyre ekonomike në Shqipëri mund të qëndrojë në faktin e kostos së ulët të fuqisë punëtore mund të dekurajohet nga cilësia e papërshtatshme e fuqisë punëtore dhe mungesa e infrastrukturës në vend.

Sidoqoftë, gjendja nuk mund të zgjasë edhe për shumë kohë dhe nevojiten të ndërmerren ndryshime të rëndësishme në tregun e punës. Kjo kërkon një monitorim të kujdesshëm të gjendjes edhe nga pikëpamja statistikore. Kryerja e përvitshme e vrojtimit të fuqisë punëtore, është e domosdoshme për ndjekjen e ndryshimeve dhe menaxhimin e politikave të përshtatshme të punësimit.



Përkufizime

Popullsia ekonomikisht aktive i referohet numrit të të gjithë personave të punësuar apo të papunë (përfshi këtu edhe ata që kërkojnë punë për herë të parë). Mbulon punëdhënësit, të vetëpunësuarit, punëtorët me pagesë, punëtorët e papaguar që ndihmojnë familjen, aktiviteti i fermës apo biznesit, anëtarët e kooperativave prodhuese, si dhe pjesëtarët e forcave të armatosura. Popullsia ekonomikisht aktive quhet edhe fuqi punëtore.

Popullsia jo aktive përfshin të rinjtë ende me studime, të moshuarit që janë larguar me pension nga aktiviteti i tyre ekonomik, shtëpiaket, personat në shërbimin e detyrueshëm ushtarak, personat që nuk janë në punë dhe ata që nuk janë në kërkim të një pune dhe të paafët. Popullsia jo aktive janë edhe të gjithë personat që nuk janë pjese e fuqisë punëtore.

Fuqia punëtore përfshin personat që punojnë aktualisht dhe ata që kërkojnë punë për herë të parë apo sepse e kishin humbur atë, pra gjithë personat e klasifikuar si të punësuar apo të papunë.

Të punësuar quhen personat që bejnë çdo punë për të marrë një pagë apo përfitim, apo që kanë një punë dhe mungojnë për ndonjë arsye. Përfshin punëtorët dhe të vetëpunësuarit, si edhe anëtarët e familjes që punojnë në biznesin e familjes.

Të papunët janë persona që janë pa punë dhe janë të gatshëm të punojnë dhe po kërkojnë një punë të re për herë të parë.

Shkalla e punësimit përfaqëson numrin e personave të punësuar si % e popullsisë përkatëse, dmth, sipas gjinisë dhe grup moshës.

Shkalla e papunësisë përfaqëson numrin e të papunëve si përqindja e fuqisë punëtore përkatëse, dmth sipas gjinisë dhe grup moshës.

Shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore përfaqëson popullsinë aktive (të punësuarit dhe të papunët) si përqindja e popullsisë përkatëse, dmth sipas gjinisë dhe grup moshës.

Shkalla e punësimit bruto nënkupton numrin e personave të punësuar si pjesa e popullsisë nga 15 vjeç e lart.

Raporti i vartësisë (ekonomike) bruto: numri i popullsisë jo aktive i dalë nga totali i popullsisë aktive (fuqi puntore = popullsia e punësuar dhe e papunë).

Raporti i vartësisë (ekonomike) neto: numri i popullsisë së papunë dalë nga totali i popullsisë së punësuar.



Raporti i punësimit periferik i qendrës është numri i personave të punësuar nga moshë 50 vjeç e lart nga numri i personave të punësuar të moshës 25-49 vjeç.

Raporti i vartësisë së të rinjve është numri i personave të moshës 0 në 14 vjeç për 100 persona të moshës nga 15 në 64 vjeç.

Raporti i vartësisë së të moshuarve është numri i personave të moshës 65 vjeç dhe më shumë për 100 persona të moshës nga 15 në 64 vjeç.

Raporti i përgjithshëm i vartësisë (demografik) është numri i personave nën 15 vjeç duke përfshirë personat e moshës 65 vjeç dhe më shumë për 100 persona të moshës nga 15 në 64 vjeç. Ai është shuma e raportit të vartësisë së të rinjve dhe atij të vartësisë së të moshuarve.

Orët e plota të punës. Orët standart të punës janë 35 apo më shumë në javë.

Orët e punës së pjeshme të gjatë: orë standarte pune ndërmjet 15 dhe 34 orë në javë.

Orët e punës së pjeshme të shkurtër: janë orë të zakonshme pune jo më pak se 15 orë në javë.



Bibliografi

- Cespi (2002). **Nga Shqipëria në Itali**. F. Piperno. Romë
- Këshilli i Ministrave (2001) i Republikës së Shqipërisë. « **Strategjia Kombëtare për zhvillimin social – ekonomik** »
- Komisioni Evropian (2003). **Shqipëria, Raporti i Stabilizim – Asociimit. Materiali i stafit të Komisionit, Com (2003)139 Bruksel**.
- Gerxhani Klarira-Schram Artur (2000). « **Ekonomia politike shqiptare : Konsekuencat e një kulture klanore** » Materiali i diskutimit të LICOS n.92/2000. K.U. Leuven
- Hashi Iraj dhe Xhillari Lindita (1997). **Privatizimi dhe Tranzicioni në Shqipëri. Leksione nga Universiteti i Staffordshire, Shkolla e Biznesit 97.6**.
- Zyra Ndërkombëtare e Punës (1990). **Studime të popullsisë ekonomikisht aktive, punësimit, papunësisë dhe punës jo me kohë të plotë: Manuali i ILO-s mbi konceptet dhe metodat**. Gjenevë: ILO.
- Zyra Ndërkombëtare e Punës (1996). **Burime dhe Metoda: Statistikat e punës, Volumi 5, Popullsia e përgjithshme dhe ekonomikisht aktive, punësimi dhe papunësia (regjistrimet e popullsisë), botimi i dytë**. Gjenevë: ILO.
- INSTAT (2002). **Popullsia në Shqipëri në 2001. Rezultatet kryesore të regjistrimit të popullsisë dhe familjes**. Tirana: INSTAT.
- Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (1998). **Situata e popullsisë në botë 1998. Gjeneratat e reja**. New York: UNFPA.
- UNECE (Komisioni Ekonomik për Evropën i Kombeve të Bashkuara) dhe Eurostat (Zyra e Statistikave të Komuniteteve Evropiane). **Rekomandime për regjistrimet e popullsisë dhe familjeve të vitit 2000 në rajonin e ECE. Standarte dhe studime statistikore No. 49. Kombet e Bashkuara. New York dhe Gjenevë. 1998**.
- UNSD (Kombet e Bashkuara, Departamenti Ekonomik dhe Çështjeve Sociale, Drejtoria e Statistikave). **Parime dhe rekomandime për regjistrimet e popullsisë dhe familjes, Rishikim 1. Materiale statistikore M No. 67/ Rev. 1. 1998**.
- Zyra Ndërkombëtare e Punës (1999). **Punësimi dhe politikat e tregut të punës në ekonomitë në tranzicion**. Gjenevë ILO.
- INSTAT (2001). **Rezultatet e studimit të kushteve të jetesës në familje, Tetor 1998**.



Tiranë: INSTAT

INSTAT (2003). **Migrimi i brendshëm dhe i jashtëm në Shqipëri.** Tirana: INSTAT

Nesporova, Alena (1999). **Zyra Ndërkombëtare e Punës. "Politikat e tregut të punës dhe punësimit në ekonomitë në tranzicion".** Dega e politikave të punësimit dhe tregut të punës, Gjenevë.

OECD (1997). **Përkufizimi i punës së pjesshme për qëllime të krahasimeve ndërkombëtare.** Bastelaer A, Lemaitre G. Marianna P., **Tregu i Punës dhe Politikat Sociale, Materiale – nr.22/1997.** OECD

UNEE (Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën) (1998) **Rekomandime për Regjistrimet e Popullsisë dhe Banesave në rajonin e ECE. Standartet statistikore dhe Studime Nr.9.** Kombet e Bashkuara. New York dhe Gjenevë.

UNFPA (Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë) (1998). **Gjendja e popullsisë botërore 1998.** New York.

UNFPA (Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë) (2003). **Gjendja e popullsisë botërore 2003.** New York.

UNSD (1998) **Parime dhe rekomandime për regjistrimet e popullsisë dhe banesave, Rishikim I, Materiale Statistikore të Serisë M Nr.67/Rev.1, 1998.** Kombet e Bashkuara, Departamenti i Çështjeve Sociale, Drejtoria e Statistikave.

Banka Botërore (2002). **Varfëria në Shqipëri, vlerësim cilësor. Materialin n.520/2002**

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Instituti i Statistikës
People & work in Albania = Njerëzit dhe puna në Shqipëri/
Instituti i Statistikës. – Tiranë : INSTAT, 2004.
60 f; 21m x 29.7cm.
ISBN 99927-973-6-3

331(496.5) "1989/2001" :311.312
311.312 : 331(496.5) "1989/2001"